Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Gllogocit
Drejtoria për Shërbime
Publike dhe Emergjencë

# *VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT: 2026-2029*

# Përmbajtja

THEMELIMI I GRUPIT PUNUES ........ 7
**HYRJE** ........ 9
**KREU I-rë** ........ 10
**1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE, KLIMATIKE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT** ........ 10
**1.1. Karakteristikat Gjeografike-klimatike të komunës së Gllogocit** ........ 10
**1.2 ZONA E PËRGJEGJËSISË PËRKUFIZIMI HAPËSINOR** ........ 12
**1.3. HIDROGRAFIA -LUMENJTË DHE LIQENET** ........ 13
**2. DEMOGRAFIA** ........ 14
**2.1. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim** ........ 16
**2.2. Dendësia e popullsisë** ........ 17
**2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në teritorin e Komunës së Gllogocit** ........ 18
**2.2.2. Të punësuarit, të papunët dhe pensionistët** ........ 18
**Kreu i III-të** ........ 29
**3. Të mirat materiale, kulturore dhe të mjedisit** ........ 29
**3.1. Objektet kulturore** ........ 29
**3.2. Parqet nacionale** ........ 33
**3.3. Bujqësia** ........ 36
**3.3.2. Kultivimi i bimëve një vjeçare** ........ 38
**3.5.Objektet** ........ 44
**Kreu IV** ........ 51
**4. Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut** ........ 51
**4.1. Rrjeti rrugor në Gllogoc** ........ 51
**4.2. Siguria në trafik** ........ 52
**4.3. Transporti Hekurudhor** ........ 53
**4.4.Transporti Ajror/ Aeroportet** ........ 53
**4.5.Sistemi energjetikë ( objektet dhe sistemet)** ........ 54
***4.6. Sistemet e tele-komunikimit*** ........ 56
***4.7.Sistemet hidro-teknike*** ........ 56
***4.7.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije*** ........ 58
**4.8. Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës** ........ 64
***KREU i V-të*** ........ 66
***5.Objektet e rëndësisë së veçantë*** ........ 66
**1. Objektet e sigurisë në Komunën e Gllogocit** ........ 66

*3. Institucionet dhe shërbimet financiare* ........ 67
*4. Objektet shkollore në komunën e Gllogocit* ........ 67
*KREU VI-të* ........ 68
*5. LLOJET E FATKEQËSIVE* ........ 68
**6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive natyrore** ........ 69
**6.2. Prioritizimi i fatkeqësive natyrore bazuar në matricën e rreziqeve** ........ 69
**6.3. Matrica e gjasave** ........ 70
**◆ 1. Rrezikshmëria** ........ 72
**◆ 2. Ekspozimi** ........ 72
**◆ 3. Ndjeshmëria** ........ 72
***6.5. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore*** ........ 72
***6.5.1. Vërshimet*** ........ 73
***6.5.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;*** ........ 73
***6.5.3.Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshimeve*** ........ 74
***6.5.4.Historiku i vërshimeve ( koha, hot-spotet/pikat e nxehta)*** ........ 74
**6.5.5. Vendet (vendbanimet) më të atakuara nga vërshimet /pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve** ........ 75
**6.5.6. Kushtet hidro-meteorologjike** ........ 76
***6.5.7. Treguesit hidrologjik*** ........ 77
**Skenari 1: Vërshimet** ........ 79
Skenari 2- Vërshimet ........ 94
**Skenari 3 - Vërshimet** ........ 108
**6.5.** ........ 125
**ZJARRET** ........ 125
**6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve,** ........ 125
**6.5.2. Kushtet klimatike** ........ 127
**6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike** ........ 127
**6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohëzgjatja** ........ 129
**6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga Zjarri** ........ 132
**6.5.6.Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit** ........ 133
**Skenari 1 – Zjarret fushore dhe Malore** ........ 135
**6.5.8.Zjarret në Objektet Industriale dhe objektet prodhuese,** ........ 147
**6.5.9.Mbrojtja nga zjarri në sektorin e Industrial dhe Objekte prodhuese** ........ 151

Skenari 2 – Zjarret në objektet industriale dhe ato prodhuese ..... 152
Skenari 3 – Zjarret në pompat e derivateve të naftës dhe Gasit ..... 164
6.6 TËRMETET ..... 173
6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik ..... 173
6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara , numri dhe struktura e banorëve ..... 173
6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara ..... 173
6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve) ..... 173
*6.6.5.* Pasojat e tërmeteve ..... 174
6.7. RRËSHQITJET DHE PËRMBYTJEET ..... 177
6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe përmbytjeve ..... 177
6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes; ..... 177
6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe përmbytjet, numri i banorëve, objekteve, lloji i tyre, pasqyra e lokacioneve kritike; ..... 177
6.7.4. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive); ..... 177
6.7.5. Sipërfaqet e përfshira; ..... 177
6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet; ..... 177
6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT; ..... 178
6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave; ..... 178
6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme; ..... 178
6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica ..... 179
6.9. BRESHËRI ..... 180
6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri; ..... 180
6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik; ..... 180
6.9.3. Pasojat nga breshëri; ..... 180
6.10. ORTEKËT ..... 181
6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga ortekët; ..... 181
6.10.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;. ..... 181
6.10.3. Treguesit statistikor të pasojave nga smetet e borës; ..... 181
6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË ..... 182
6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale; ..... 182
6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve; ..... 183
6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë ; ..... 183
6.12. THATËSIRAT ..... 184
6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike; ..... 184

6.12.2. Dëmet dhe pasojat; 184
6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve; 184
6.12.4.Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore) 184
6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË 186
6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale; 186
6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve; 186
6.13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë; 187
6.13.4. Sëmundjet ngjitëse; 187
6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ; 187
6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë/vlerësimet e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente; 187
6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese; 187
Skenari 1 – Epidemitë dhe Pandemitë 188
7. FATKEQËSITË TJERA 198
7.1. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror; 198
7.2.VLERËSIMI PËR PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE 200
7.3. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË /SMSHN 202
7.3.1. Kategorizimi i SMSHN-ve, 202
8. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE 203
8.1. Vlerësimet përfundimtare; 204
8.1.1. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent 205
8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT; 207
8.2.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT; 207
8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike; 207
8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional; 207
8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre; 208
8.2.5.Hartimi i skenarit dhe ushtrimi; 208
9. Rekomandime 208
10. Dispozitat përfundimtare 209

## PARATHËNIE

Dokumenti i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Komunën e Gllogocit, bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

Me këtë dokument identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në Komunën e Gllogocit si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë. Bazuar në këtë vlerësim, identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin (zbutjen) e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Ky vlerësim shërben si bazament për hartimin e Planit Lokal të Reagimit Emergjent(PLRE) si dhe planeve tjera lokale, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve, të mirave materiale, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore në Komunën e Gllogocit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

## THEMELIMI I GRUPIT PUNUES

Kryetari i Komunës së Gllogocit, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, nxjerrë vendimin për themelimin e Grupit Punues, për hartimin /rishikimin e dokumenteve të vlerësimit të rrezikshmërisë.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
***Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)***
***Zyra e Kryetarit***
01 Nr 400/01-45885 Dt. 18/09/2024

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, pika 1 dhe pika 3 të nenit 44, si dhe pika 2 e nenit 46 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenit 72, pika 72.1, nën (h) të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenit 1 të Rregullores (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Kryetari i Komunës mori këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e Grupit Punues për hartimin e dokumentit për Vlerësimin e Rrezikut dhe Planit për Reagim Emergjent Lokal, për territorin e komunës së Drenasit**

I. Grupi punues në përbërje prej:

1. Nexhmedin Gruda, Drejtor i DShPE-së - Koordinator i grupit;
2. Afrim Prokshi , DShPE – Zëvendës koordinator i grupit;
3. Afrim Gjeli, Koordinator i NJPZSH – Udhëheqës i grupit;
4. Lumturije Kiqina, Drejtoria e Shëndetësisë - anëtare;
5. Laura Vrellaku, Drejtoria e Arsimit - anëtare;
6. Besart Bajrami, Drejtoria e Planifikimit Urban - anëtar;
7. Fadil Tahiraj, Drejtoria e Gjeodezisë Kadastër dhe Pronë - anëtar;
8. Granit Karaqica, Drejtoria e Infrastrukturës - anëtar;
9. Kajtaz Kastrati, Drejtoria e Kulturës - anëtar;
10. Shukrie Azizi, Drejtoria e Inspekcionit - anëtare;
11. Arianit Balaj, Drejtoria e Financave - anëtar;
12. Zyrafete Nishori, Drejtoria e Ekonomisë - anëtare;

13. Ilir Berisha, Drejtoria e Bujqësisë - anëtar;
14. Afije Veseli, Zyra për Komunitete dhe Kthim-anëtare;
15. Ibrahim Hajdari, Zyra për integrime Evropiane - anëtar;
16. Ramadan Elshani, KEDS - anëtar bashkëpunues;
17. Kastriot Berisha, KRM- Pastrimi - anëtar bashkëpunues;
18. Egzon Morina, Kryqi i Kuq - anëtar bashkëpunues;
19. Mehmet Cakiqi, Policia Drenas - anëtar bashkëpunues;
20. Amir Morina, Hekurudha - anëtar bashkëpunues;
21. Ismet Balia, KRU- Ujësjellësi – anëtar bashkëpunues;
22. Shaban Mehmeti, Veteriner – anëtar bashkëpunues;
23. Arben Nika, OJQ - CEDE – anëtar bashkëpunues;
24. ________________, - FSK anëtar bashkëpunues;
25. ________________, - AME anëtar bashkëpunues.

II. Detyra e grupit punues është hartimi i dokumenteve për Vlerësimin e Rrezikut dhe Planin për Reagim Emergjent Lokal për territorin e komunës së Drenasit, duke u bazuar në rekomandimet dhe mbështetjen e AME-së.

III. Pas hartimit të dokumenteve për Vlerësimin e Rrezikut dhe Planin për Reagim Emergjent Lokal për territorin e komunës së Drenasit, dhe pasi të jetë marrë pëlqimi nga MPB dhe AME, grupi punues i propozon Kryetarit miratimin e tyre në Kuvendin Komunal.

IV. Vlefshmëria e këtyre dokumenteve është 5 vjet.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën kur nënshkruhet nga Kryetari i Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Kryetari i Komunës:

Ramiz Lladrovci

Vendimi i dërgohet:

- *Zyrës së Kryetarit të Komunës;*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë;*
- *Anëtareve të grupit punues;*
- *Arkivit të Komunës së Drenasit.*

# HYRJE

Përgjatë gjithë historisë së ekzistimit të saj, planeti Tokë është goditur shumë herë nga fatkeqësi natyrore të përmasave të katastrofës. Planeti ynë ka përjetuar shumë katastrofa që kanë rezultuar me humbje të mëdha të jetëve të njerëzve, dëme ekonomike, shkatërrime dhe shembje të objekteve. Fatkeqësitë implikojnë incidentet kryesore duke kërkuar mobilizim të shërbimeve emergjente, si dhe krijojnë stres të përgjithshëm shoqëror. Pra, ato shkaktojnë çrregullim serioz të funksionimit të shoqërisë, duke shkaktuar dëme të mëdha njerëzore, materiale dhe të ambientit, që i tejkalojnë aftësitë e njerëzve të goditur për përballimin e tyre të përdorin mjetet që i kanë në zotërim. Fatkeqësitë klasifikohen në bazë të shkakut të tyre, si: **natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga (pakujdesia) faktorit njëri.**

Procesi i vlerësimit të rreziqeve, është mjaft kompleks, prandaj për ta kuptuar atë, është e nevojshme të rritet niveli i njohurive të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë për zyrtarët lokal në të gjitha nivelet, shoqërinë civile, komunitete dhe vullnetarë, si dhe sektorin privat, përmes shkëmbimit të përvojave, mësimeve të fituara, praktikave të mira, trajnimit dhe edukimit mbi zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duke përfshirë përdorimin e mekanizmave ekzistues të trajnimit, edukimit dhe mësimit të ndërsjellë.

Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera -FNFT, shërben si udhëzues për identifikimin e shkallës së rrezikshmërisë nga faktorët potencialë, qëllimi i vlerësimit të rreziqeve ka të bëjë edhe me zbulimin e dobësive të komunitetit karshi rreziqeve në menyrë që të bëhet planifikimi i masave parandaluese për pengimin dhe zvogëlimin e dëmeve në raste të fatkeqësive eventuale, përfshirjen dhe trajnimin e të gjitha strukturave dhe shërbimeve gjegjëse komunale, këto bëhet me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste të fatkeqësive, katastrofave si dhe angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim me qëllim të ndihmës, vetëndihmës, shpëtimit, evakuimit dhe strehimit të të rrezikuarve dhe zvogëlimin e dëmeve materialo-teknike, sigurimin e kushteve për institucionet komunale dhe atyre të cilat veprojnë në territorin e komunës për veprimtari ekonomike, për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente.

Duke pasur parasysh këtë dhe në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga fatkeqësitë, ekziston nevoja për adresimin e sfidave ekzistuese dhe përgatitjes për sfidat në të ardhmen, duke u fokusuar në monitorimin, vlerësimin dhe të kuptuarit e rrezikut nga fatkeqësitë dhe shkëmbimin e informacioneve të tilla dhe mbi atë se si është krijuar fuqizimi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe koordinimi i të gjitha institucioneve dhe sektorëve përkatës dhe pjesëmarrja e plotë dhe kuptimplotë e akterëve në nivelet e duhura.

**Fusha e përgjegjësisë së bartësit e planifikimit**

Bartës i përgjegjësive për plotësim ndryshimin e draft dokumentit për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit e Tjera-VRRFNFT, për Komunën e Gllogocit është Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emërgjencë, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e emërgjencave të nivelit lokal, vënien e standardeve të kryerjes së punëve lidhur me Gatishmërinë Civile dhe Reagimit Emergjent në territorin e vet dhe koordinimin e të gjitha subjekteve relevante për reagim në situata emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë. Ky Drejtorat planifikon që të marrë masa të nevojshme për parandalimin nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, si dhe përcjell aktivitetet e subjekteve

relevante dhe involvuese në rast të fatkeqësive e të cilët do të mbështesin shërbimet emergjente në rast të fatkeqësive.

## MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është Vlerësimi, Planifikimi dhe Programimi i veprimit të menduar për menaxhim emergjent, me udhëzime të qarta dhe veprime emergjente të nevojshme dhe me kohë.

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

a. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera përkatëse sipas legjislacioneve në fuqi;
b. Profilizimit dhe standardizimit të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
c. Caktimit të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimit të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente si dhe koordinimit të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente;

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, vlerësimit dhe konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe strategjive afatshkurtra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente me të cilat mund të përballet komuna.

**KREU I-rë**

# 1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE, KLIMATIKE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT

## 1.1. Karakteristikat Gjeografike-klimatike të komunës së Gllogocit

Në Komunën e Gllogocit dominojnë terrenet kodrinore malore si dhe terrenet e rrafshëta. Gjeografikisht përfshinë pjesën qendrore te Kosovës (Luginën e Drenicës) dhe kufizohet me vargmalet e Drenicës, Kosmaqin, Qyqavicen, Goleshin dhe Lipovicen.

Klima është e mesme kontinentale dhe mesatarja e temperaturave vjetore sillet rreth 11.8 $^{0}$C. Muaji me i nxehte ka qënë Gushti me temperatur maximale që ka arritë deri në 33.0 $^{0}$C, ndërsa muaji me i ftohte është muaji Janar, por sipas të dhënave të marrura nga Instituti Hidrometeorologjik në vitin 2018 temperatura minimale ishte në muajn Mars në -16.2 $^{0}$C.

Gjerësia gjeografike 42 (shkallë) 32”

Gjatësia gjeografike 20 (shkallë) 64”

Lartësia Mbidetare 575 – 1072 m.

Pjerrtësia e terrenit 10 – 35 %

*Tabela 1 Të dhënat meteorologjike për temperaturat*

| **Muajt** | Temperaturat mesatare | Maksimumi absolut | Minimumi absolut |
|---|---|---|---|
| Janar | 1.3 | 12.9 | -13.7 |
| Shkurt | 2.0 | 12.8 | -11.5 |
| Mars | 6.3 | 21.8 | -16.2 |
| Prill | 15.6 | 28.9 | 2.1 |
| Maj | 17.9 | 29.6 | 8.0 |
| Qershor | 19.4 | 31.2 | 6.8 |
| Korrik | 20.7 | 31.9 | 10.5 |
| Gusht | 21.7 | 33.0 | 10.7 |
| Shtator | 17.2 | 30.2 | -0.7 |
| Tetor | 13.1 | 25.4 | -0.7 |
| Nëntor | 6.5 | 25.5 | -9.0 |
| Dhjetor | 0.1 | 15.2 | -9.0 |
| **Pranverë** | 16.1 | 23.1 | 9.6 |
| **Verë** | 20.3 | 27.6 | 13.9 |
| **Vjeshtë** | 8.0 | 15.1 | 2.8 |
| **Dimër** | 2.8 | 7.7 | -0.9 |
| Përgjithshme vjetore | 11.8 | 24.9 | -1.9 |

*Tabela 2 Të dhënat meteorologjike për lagështinë*

| Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | **Vjetor** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 86 | 81 | 76 | 59 | 68 | 73 | 75 | 69 | 64 | 69 | 80 | 88 | **74** |

## 1.2 ZONA E PËRGJEGJËSISË PËRKUFIZIMI HAPËSINOR

Komuna e Gllogocit ka një sipërfaqe prej 275,63 km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë. Gllogoci shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, dhe bënë pjesë në grupin e komunave të mesme të vendit.

Komuna e Gllogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj , shtrihet në mes të rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit që është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Territori i Komunës së Gllogocit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së Lumit Drenica.

Në vitin 1981 vendbanimi i Gllogocit shpallët qytet, e me këtë edhe qendra kryesore administrative, kulturore, sociale dhe ekonomike e Komunës.

*Figura 1: Pozita gjeografike e komunës së Gllogocit në Kosovë*



Ndërsa me rregulloren për “Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Gllogoc” nr. 12-15-17684/2012, është bërë rregullimi dhe ndarja e vendbanimeve të komunës si në vijim:

*Tabela 3: Lagjet Urbane dhe Fshatrat e Komunës së Gllogocit*

| Lagjet urbane në qytetin e Gllogocit | |
|---|---|
| Gllogoci I | Gllogoci III |
| Gllogoci II | Lagjja e Feronikelit |
| | |
| Fshatrat e komunës së Gllogocit | |
| Komoran | Korroticë e Eperme |
| Tërstenik | Krajkovë |
| Llapushnik | Tërdec |
| Arllat | Shtrubullovë |
| Nekoc | Zabel i Ulët |
| Baicë | Fushticë e Ulët |
| Çikatovë e Re | Polluzhë |
| Poklek | Fushticë e Epërme |
| Abri e Eperme | Korroticë e Ulët |
| Gllanasellë | Shtuticë |
| Negroc | Gradicë |
| Gllobar | Domanek |
| Kishnarekë | Vasilevë |
| Dobroshec | Likoshan |
| Sankoc | Zabel i Epërm |
| Çikatovë e Vjetër | Vuçak |
| Vërboc | Godanc |

## 1.3. HIDROGRAFIA -LUMENJTË DHE LIQENET

Një ndër Lumenjtë kryesor që e karakterizon territorin e komunës së Gllogocit është lumi Drenica i cili shtrihet në vijat: Nekoc-Gllogoc, Polluzhë-Gllogoc dhe Gllogoc -Dobroshec, gjatësia e të ciles arrin 30 km. Në përiudhat e nxehta të verës disa degë të tijë shterrën, deri në periudhat me lagështi. Ndërsa në fshatin Vasilevë gjinden liqej arficial të cilët janë krijuar nga nxjerrjet e thengjillit nga KEK-u, të cilët në përiudhat me shi kanë sasi më të madhe të ujit, ndërsa në ato më thatësi kanë sasi me të vogël.

*Figura 2: Rrjeti i Lumenjve dhe Liqejve në Komunën e Gllogocit*




## 2. DEMOGRAFIA

Numri i popullsisë dhe vendbanimet janë një indikator i rëndësishëm për demografinë. Për të identifikuar numrin e popullsisë kemi shfrytëzuar të dhënat e regjistrimeve të popullsisë nga Agjencija e Statistikave të Kosoves (ASK) ndër vite. Në Kosovë regjistrimet zyrtare të popullsisë pas luftës së fundit, janë bërë në vitin në vitin/2024. Pasqyrën e popullsisë së Komunës, vendbanimet, aspektet gjinore dhe variablat krahasimore si dhe diagramet sipas trendeve dhe zhvillimeve të Komunës së Gllogocit do ti paraqesim në tabeloret dhe diagramet e mëposhtme ndë vite (1981-2024):

*Tabela 4: Popullsia e Komunës së Gllogocit sipas gjinisë dhe etnive 2024*

| Gjithsej | Gjinia | | Etnia | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Gllogocit | Meshkuj | Femra | Shqiptarë | Serbë | Turq | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptas | Goran | Të tjerë | Preferon te mos të përgjigjen |
| **48079** | 24134 | 23945 | 48036 | 0 | 3 | 13 | 0 | 1 | 0 | 0 | 15 | 11 |

*Tabela 5: Numri i popullsisë dhe ekonomive familjare ndër vite*

| Viti | Popullsia | | Ekonimitë Familjare(EF) | |
|---|---|---|---|---|
| | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti |
| **1981** | 39141 | 2440 | 4138 | 318 |
| **1991** | 53618 | 4499 | 5906 | 560 |
| **2021** | 58531 | 6143 | 8786 | 1047 |

*Tabela 6: Gjithsej popullsia e Komunës së Gllogocit e vlerësuar për vitin 2024*

| Komuna e Gllogocit Sipërfaqja në km² | Popullsia e vlerësuar 2024 | Shtimi natyror | Bilanci i migrimeve (2024) | Rritja e Përgjithshme (shtimi natyror dhe migrimi) për vitin 2024 | Popullsia e vlerësuar/ 2024 | Numri i banorëve në 1 km² |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 276 | 48079 | 514 | 10452 | | 48079 | 174.20 |

*Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK); Data e botimit: Dhjetor 2024*

*Diagrami 1 Krahasimi i numrit të popullsisë ndër vite*



*Diagrami 2 Krahasimi i numrit të ekonomive familjare ndër vite*




## 2.1. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim

- Nënat me fëmijë
- Fëmijë 0 deri në 14 vjeç, janë 12707 banorë (ASK 2024)
- Të moshuarit mbi 70 vjeç, janë 2807 banorë (ASK 2024)
- Personat me nevoja të veçanta 538 banorë.

*Tabela 7: Popullsia e Komunës së Gllogocit sipas gjinisë dhe grup-moshave 2024*

| Komuna e Gllogocit | | Gjithsej | Grup-mosha | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **0-4** | **5-9** | **10-14** | **15-19** | **20-24** | **25-29** | **30-34** |
| | Gjithsej | 48079 | 3580 | 4000 | 4223 | 3959 | 4096 | 3363 | 3275 |
| | Meshkuj | 24134 | 1889 | 2082 | 2170 | 2044 | 2050 | 1668 | 1670 |
| | Femra | 23945 | 1691 | 1918 | 2053 | 1915 | 2046 | 1695 | 1605 |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| **35-39** | **40-44** | **45-49** | **50-54** | **55-59** | **60-64** | **65-69** | **70-74** | **75-79** | **80+** |
| 3350 | 3157 | 3111 | 2771 | 2487 | 2141 | 1759 | 1264 | 825 | 718 |
| 1712 | 1601 | 1487 | 1363 | 1188 | 1009 | 838 | 625 | 405 | 333 |
| 1638 | 1556 | 1624 | 1408 | 1299 | 1132 | 921 | 639 | 420 | 385 |

*Tabela 8: Numri i Pensionistëve*

| Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Gllogocit | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pensionetet | Pensione bazë | Pens. e Personave me Aftësi të Kufizuar | FSK | Pens. Invalidor i Punës | Trepça | TMK | Pen. Paraplegjik e Tetraplegjik | Pensione familjare | Kompensime monetare | Arsimi | Totali |
| **** | **3216** | **476** | **70** | **3** | **2** | **104** | **105** | **86** | **** | **** | |

*Tabela 9: Asistenca sociale*

| Nacionaliteti | Nr. i familjeve | Nr. antarëve familjës |
|---|---|---|
| Shqiptar | 741 | 3,318 |
| **Gjithsej** | **741** | **3,318** |

*Tabela 10: Personat me nevoja të veçanta*

| | Mosha nën 18 Vjeç | Mosha 18-70 vjeç | Totali |
|---|---|---|---|
| Numri | 107 | 431 | 538 |

## 2.2. Dendësia e popullsisë

Komuna e Gllogocit me dendësi mesatare rreth 174.2 banor/km², që është mbi mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Nga harta vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Gllogocit ku mesatarisht jetojnë rreth 1651 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Shtrubullovë (395 b/km²), Komoran (389.5 b/km²), Çikatovë e Re (363.1 b/km²), Nekoc (301.3 b/km²), Gllabar (300.4 b/km²),etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Vasilevë (65.7 b/km²), Gradicë (68.7 b/km²), Vuçak (80.6 b/km²), Godanc (96.5 b/km²), etj.

*Figura 3: Harta e Dendësisë së Popullsisë sipas Gridit (km²)*




## 2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në teritorin e Komunës së Gllogocit

Komuna e Gllogocit është e banuar ekskluzivisht vetëm nga shqiptarët.

### 2.2.2. Të punësuarit, të papunët dhe pensionistët

Komuna e Gllogocit ka një bashkëpunim të mirë me Zyrën komunale për punësim dhe Qendrën për punë sociale, prandaj të dhënat e marrura nga këto dy qendra do ti paraqesim në formë tabelare. Paraqitja e numrit të punësuarve në komunën e Gllogocit

Numri i përgjithëshëm i përsonave të pa punë dhe punëkërkuesve në Zyrën për Punësim në Gllogoc, deri më datën 17.10.2022, është 6688 persona, ku prej tyre aktiv janë: 3110 përsona ndërsa pasiv janë 3578 persona.

*Tabela 11: Numri i të punësuarve*

| Nr: | Institucionet | Numri i të punësuarve |
|---|---|---|
| 1 | Arsim | 963 |
| 2 | Shëndetësi | 200 |
| 3 | Administratë | 142 |
| 4 | Gjykatë | 22 |
| 5 | Kryqi i kuq | 3 |
| 6 | Zyra për punësim | 5 |
|  | Gjithësej: | 1335 |

*Tabela 12: Numri i të punësuarve sipas sektorëve*

| Nr: | Sektoret | Numri i të punësuarve |
|---|---|---|
| 1 | Sektori shoqëror | 1335 |
| | Sektori privat | 5446 |
| | Gjithësej: | 6781 |

*Tabela 13: Numri i pensionistëve në Komunën e Gllogocit*

| Nr: | Pensionistë | Numri i pesionisteve |
|---|---|---|
| 1 | Numri i pënsionistëve | 4570 |
| | Gjithësej: | 4570 |

*Tabela 14: Numri i të punësuarve, punëkërkuesve dhe pasiv*

| Nr: | Të papunësuar | Punëkërkues | Pasiv |
|---|---|---|---|
| 1 | 6688 | 3110 | 3578 |
| | **Gjithësej:** | | 13376 |

**2.3 Arsimimi**

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Gllogocit zhvillohet në gjithsej 33 institucione edukative-arsimore publike parauniversitare. Këto përfshijnë: një (1) institucion parashkollor (niveli arsimor 0 – parauniversitar), tridhjetë (30) institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (nivel arsimor 1 dhe 2 arsimi parauniversitar), si dhe dy (2) institucione të arsimit të mesëm të lartë (niveli arsimor 3 arsimi parauniversitar), që përbëhen nga një (1) gjimnaz dhe një (1) shkollë e mesme profesionale. Përveç institucioneve publike, në komunën e Gllogocit ekzistojnë edhe katër objekte private të edukimit parashkollor.

Të gjitha këto institucione përfshijnë objekte shkollore, që nënkuptojnë edhe stafin edukativ-arsimor të përbërë nga mësimdhënës/e dhe personel tjetër mbështetës. Të dhënat statistikore në lidhje me këto institucione janë paraqitur në tabelat në vijim.

Ndërsa shpërndarja e objekteve shkollore (ndërtesave) është paraqitur përmes tabelave dhe hartave përkatëse. Sa i përket masave të sigurisë, tri institucione edukative-arsimore publike parauniversitare janë të pajisura me shkallë emergjente. Këto janë ndërtesa të arsimit parauniversitar që kanë më shumë se një kat.

*Tabela 15: Statistikat për numrin e institucioneve në arsimin parauniversitar në Komunën e Gllogocit 2023/2024*

| **Nr** | **Emri i Institucionit Arsimor** | **Vendbanimi** | **Email** |
|---|---|---|---|
| 1 | REGJEP GJELI | Likoshan | bujartahiri55@gmail.com |
| 2 | HALIL BAJRAKTARI | Drenas | berisha_23s@hotmail.com |
| 3 | FAZLI GRAJQEVCI | Vasilevë | ekremcurri@hotmail.com |
| 4 | HASAN PRISHTINA | Llapushnik | faikgashif@gmail.com |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | JUSUF GËRVALLA | Negroc | fkransigi888@gmail.com |
| 6 | NAIM FRASHËRI | Gllobar | shkurte.dvorani@hotmail.com |
| 7 | SHOTE GALICA | Abri e Eperme | eni.07@hotmail.com |
| 8 | ZENEL HAJDINI | Tërstenik I | shtim.z.hajdini@hotmail.com |
| 9 | GANI ELSHANI | Krajkovë | drenidinali@gmail.com |
| 10 | FEHMI DHE ISLAM KASTRATI | Kizhnarekë | xhemajl_brahimi@hotmail.com |
| 11 | ALI GASHI | Çikatovë e Re | antigone.d.gashi@gmail.com |
| 12 | ARIF SHALA | Korroticë e Poshtme | murte.shala@hotmail.com |
| 13 | AZEM BEJTA | Shtuticë | naimvelig10@gmail.com |
| 14 | XHELADIN GASHI - PLAKU | Komoran | imer.bujupi@hotmail.com |
| 15 | BAJRAM CURRI | Nekoc | meteorit788@hotmail.com |
| 16 | DESHMORET E DRENICËS | Çikatovë e Vjetër | dreniza_hasi@hotmail.com |
| 17 | DESHMORET E FORTESËS | Vërboc | arbresha.gashi@outlook.com |
| 18 | SHABAN POLLUZHA | Polluzhë | burim.astogu@gmail.com |
| 19 | RASIM KIÇINA | Drenas I | rasimkiqina@hotmail.com |
| 20 | LUIGJ GURAKUQI | Sankoc | e.isa@live.com |
| 21 | MIGJENI | Baicë | rrash_leh@hotmail.com |
| 22 | RILINDJA | Dobroshec | arsimvdy108@gmail.com |
| 24 | MEHMET GRADICA | Gradicë | shkollamehmetgradica@gmail.com |
| 25 | XHEVË LLADROVCI | Gllanasellë | ilirmika83@gmail.com |
| 26 | ABEDIN BUJUPI | Arllat | sahadete_26@hotmail.com |
| 27 | DESHMORET QENDRESES | Tërstenik II | Remzi.gashi@gmail.com |
| 28 | 24 KORRIKU | Fushticë e Poshtme | osmanosmaniss@live.com |
| 29 | GANI SYLA | Poklek i Ri | rifati_demaku@hotmail.com |
| 30 | MEHDI E SYLEJMAN BYTYQI | Lagjja Bytyqi | durmishkurti@gmail.com |
| 31 | FEHMI LLADROVCI | Poklek i Ri | shumfikduverl@gmail.com |
| 32 | GJERGJ KASTRIOTI - SKENDERBEU | Poklek i Ri | avni.h.jakupi@gmail.com |
| 33 | IP ARDHMERIA | Drenas | blerentina.gashi@rks-gov.net |

*Tabela 16: Statistikat e numrit të fëmijëve dhe nxënësve në arsimin parauniversitar 2023/2024, sipas klasës dhe gjinisë/ Gjithsej fëmijë/nxënës*

| Nr. | Institucionet edukative arsimore | Gjithsej | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|---|
| 1 | QEAP" Ardhmeria" | 190 | 93 | 97 |
| 2 | Gani Elshani | 225 | 108 | 117 |
| 3 | Fehmi dhe Islam Kastrati | 337 | 161 | 176 |
| 4 | Abedin Bujupi | 408 | 212 | 196 |
| 5 | Ali Gashi | 457 | 221 | 236 |
| 6 | Arif Shala | 307 | 153 | 154 |
| 7 | Azem Bejta | 127 | 63 | 64 |
| 8 | Bajram Curri | 465 | 182 | 282 |
| 9 | Dëshmoret e Drenicës | 148 | 55 | 93 |
| 10 | Dëshmoret e Forteses | 122 | 43 | 79 |
| 11 | Dëshmoret e Qendresës | 203 | 74 | 129 |
| 12 | Fazli Greiçevci | 143 | 47 | 96 |
| 13 | Jusuf Gërvalla | 240 | 99 | 141 |
| 14 | Luigj Gurakuqi | 331 | 130 | 201 |
| 15 | Mehdi e Sylejman Bytyçi | 100 | 32 | 68 |
| 16 | Mehmet Gradica | 52 | 27 | 25 |
| 17 | Regjep Gjeli | 71 | 34 | 37 |
| 18 | Migjeni | 259 | 111 | 148 |
| 19 | Naim Frasheri | 270 | 124 | 146 |
| 20 | Rasim Kiçina | 1272 | 640 | 632 |
| 20 | Halil Bajraktari | 358 | 179 | 179 |
| 21 | Rilindja | 255 | 97 | 158 |
| 22 | Shaban Polluzha P | 90 | 32 | 58 |
| 23 | Shotë Galica Abri | 197 | 78 | 119 |
| 24 | Shotë Galica Grykas | 111 | 37 | 74 |
| 25 | Xheladin Gashi Prishtina | 593 | 215 | 376 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 26 | Xhevë Lladrovci | 188 | 73 | 115 |
| 27 | Zenel Hajdini | 257 | 98 | 159 |
| 28 | Gjergj Kastrati Skenderbeu | 832 | 331 | 501 |
| 29 | Fehmi Lladrovci | 1399 | 602 | 797 |
| 30 | 24 Korriku | 125 | 39 | 86 |
| 31 | Gani Sylaj | 247 | 89 | 158 |
| 32 | Hasan Prishtina | 373 | 160 | 213 |
| 33 | Shaban Polluzha Korreticë e Epërme | 255 | 102 | 153 |
| | **Total** | **11007** | **4741** | **6263** |

Tabela 17 *Statistikat e numrit të fëmijëve në arsimin parauniversitar private 2023/2024*

| Nr. | Institucionet parashkollore private | Gjithëseit |
|---|---|---|
| 1 | Bambi | 80 |
| 2 | Edukimi | 30 |
| 3 | Gjeniu | 0 |
| 4 | Klea | 9 |
| | **Total** | **119** |

*Grafikoni 1 Përkatësia etnike e fëmijëve/nxënësve*



`

*Tabela 18: Statistikat e numrit të stafit edukativo-arsimor në arsimin parauniversitar 2023/2024*

| *Stafi edukativ arsimor* | | |
|---|---|---|
| *Arsimi parashkollor* | *Niveli arsimor 0* | *25 edukatore* |
| *Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët* | *Niveli arsimor 1dhe 2* | *498 mësimdhënës* |
| *Arsimi  i mesëm  i lartë* | *Niveli arsimor 3* | *165 mësimdhënës* |

**Sistemi edukativ** – **arsimor** në komunën e Gllogocit është i organizuar dhe funksionon në nivele të arsimit parauniversitar në 33 institucione arsimore publike parauniversitare:

- Arsimi parashkollor, fillor dhe i mesem i ulët, niveli arsimor 0, 1 dhe 2 – 523 mësimdhënës/e parshkollore, klasor dhe lëndor

- Arsimi i mesëm i lartë, niveli arsimor 3 -165 mësimdhënës

Totali i të punësuarve: 688 edukatore dhe mësimdhënës/e,

1. Numri i përgjithshëm i personave me nevoja të veçanta të punësuar në të gjitha institucionet komunale ( Arsim ) – 13;
2. Numri i grave me nevoja të veçanta të punësuar në institucionet komunale ( Arsim ) - 1 ;
3. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në të gjitha institucionet komunale ( Arsim ) ---- 950 ;
4. Numri i përgjithshëm i grave të punësuara në institucionet komunale ( Arsim ) – 495;
5. Numri i përgjithshëm i të punësuarve nga komuniteti jo shumicë ( Arsim ) – ska;
6. Numri i përgjithshëm i grave të punësuara nga komunitetet pakicë ( arsim ) – ska;

*Grafikoni nr. 2  Përkatësia gjinore e mësimëdhënësve e shprehur në përqindje*



*Figura 4: Harta e Shpërndarjës së Institucioneve Arsimore*




Prej 33 institucioneve edukative arsimore publike parauniversitare të tipit shkollor amë dhe paralele fizike të ndara, gjendja faktike është 33 objekte amë në kuadër të institucione edukative arsimore publike parauniversitare dhe 4 pralele fizike të ndara.

- Institucioni parashkollor QEAP “ Ardhmëria “ - 1 objekt amë në Gllogoc, 1 paralele e ndarë fizike në Komoran dhe 1 paralele e ndarë fizike në Çikatovë e Re,
- SHFMU “ Abedin Bujupi “, në Arllat 1 objekt amë në Arllat, 1 paralele e ndarë fizike në lagjen e Xhamisë,
- SHFMU “ Shotë Galica “, në Abri- Tërdevc, objekti amë në Abri dhe 1 paralele fizike në Tërdevc,

Prej 33 institucioneve edukative arsimore publike parauniversitare ndrrimi i orareve mësimore realizohet

- Institucioni parashkollor QEAP “ Ardhmëria” – procesi edukativ mësimore realizohet me qendrim tërëditor ,
- Në 23 institucione edukative arsimore publike parauniversitare procesi edukativ arsimor realizohet në dy ndërrime,
- Në 9 institucione educative arsimore publike parauniversitare procesi edukativ arsimor realizohet në një ndërrim

`

*Tabela 19: Instiucionet arsimore ne Komunen e Gllogocit*

| Nr | Emri i Institucionit Arsimor | Email | Nr. i klasave | Numri i stafit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | REGJEP GJELI | bujartahiri55@gmail.com | 6 | 15 |
| 2 | HALIL BAJRAKTARI | berisha_23s@hot mail.com | 22 | 34 |
| 3 | FAZLI GRAJQEVCI | ekremcurri@hotmail.com | 10 | 21 |
| 4 | HASAN PRISHTINA | faikgashif@gmail.com | 22 | 35 |
| 5 | JUSUF GËRVALLA | fkransigi888@gmail.com | 16 | 21 |
| 6 | NAIM FRASHËRI | shkurte.dvorani@hotmail.com | 22 | 19 |
| 7 | SHOTE GALICA (ABRI E EPËRME) | eni.07@hotmail.com | 20 | 36 |
| 8 | ZENEL HAJDINI | shtim.z.hajdini@hotmail.com | 16 | 21 |
| 9 | GANI ELSHANI | drenidinali@gmail.com | 7 | 21 |
| 10 | FEHMI DHE ISLAM KASTRATI | xhemajl_brahimi@hotmail.com | 18 | 31 |
| 11 | ALI GASHI | antigone.d.gashi@gmail.com | 20 | 36 |
| 12 | ARIF SHALA | murte.shala@hot mail.com | 18 | 27 |
| 13 | AZEM BEJTA | naimvelig10@gmail.com | 6 | 15 |
| 14 | XHELADIN GASHI - PLAKU | imer.bujupi@hot mail.com | 20 | 42 |
| 15 | BAJRAM CURRI | meteorit788@hot mail.com | 20 | 34 |
| 16 | DESHMORET E DRENICES | dreniza_hasi@hot mail.com | 6 | 17 |
| 17 | DESHMORET E FORTESES | arbresha.gashi@o utlook.com | 6 | 13 |
| 18 | SHABAN POLLUZHA | burim.astogu@g mail.com | 6 | 13 |
| 19 | RASIM KIÇINA | rasimkiqina@hot mail.com | 24 | 79 |
| 20 | LUIGJ GURAKUQI | e.isa@live.com | 16 | 29 |
| 21 | MIGJENI | rrash_leh@hotmail.com | 18 | 20 |
| 22 | RILINDJA | arsimvdy108@gmail.com | 10 | 21 |
| 23 | SHABAN POLLUZHA - KORROTICË E EPËRME | dcurri@hotmail.com | 10 | 22 |
| 24 | MEHMET GRADICA | shkollamehmetgr adica@gmail.com | 6 | 19 |
| 25 | XHEVË LLADROVCI | ilirmika83@gmail.com | 10 | 18 |
| 26 | ABEDIN BUJUPI | sahadete_26@hot mail.com | 20 | 37 |
| 27 | DESHMORET E QENDRESES | | 10 | 21 |
| 28 | 24 KORRIKU | osmanosmaniss@live.com | 6 | 14 |
| 29 | GANI SYLA | rifati_demaku@h otmail.com | 10 | 11 |
| 30 | MEHDI E SYLEJMAN BYTYQI | durmishkurti@gmail.com | 10 | 15 |
| 31 | FEHMI LLADROVCI | shumfikduverl@g mail.com | 33 | 109 |
| 32 | GJERGJ KASTRIOTI -SKENDERBEU | avni.h.jakupi@gm ail.com | 22 | 67 |
| 33 | IP ARDHMERIA | blerentina.gashi@ rks-gov.net | 10 | 25 |
| **Totali** | | | | **956** |

*Tabela 20: Shkollat, matja apo vlerësimi i nivelit të gatishmërisë në raste zjarri apo fatkeqësi të tjera*

| Nr | Lokacioni | Emri i shkollës | Nr. i Mësimdhënësve | Nr. i punëtorëve teknik në objektin shkollor | Nr. i kateve të objektit | Shkallët ose daljet Emergjente | Posedon Ujësjellës (U) Pus (P) Hidrant (H) | Shenjat e largimit nga objekti shkollor në raste emergjente | Përsonel të trajnuar për përdorim të pajisjeve për fikje të zjarrit Po/Jo |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kroikovë | "Gani Elshani " | 18 | 4 | 2 | Po [ ] Jo [X] | | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 2 | Kizhnarekë | "7 Marsi " | 29 | 4 | 2 | Po [ ] Jo [X] | | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 3 | Arllat | "Abedin Bujupi" | 39 | 5 | 2 | Po [X] Jo [ ] | | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 4 | Gllogoc II | "Ali Gashi" | 32 | 6 | 2 | Po [ ] Jo [X] | | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 5 | Korroticë e Poshtme | "Arif Shala" | 21 | 4 | 2 | Po [ ] Jo [X] | (U) | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 6 | Shtuticë | "Azem Bejta" | 14 | 3 | 2 | Po [ ] Jo [X] | (U) | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 7 | Nekoc | "Bajram Curri" | 32 | 5 | 1 | Po [X] Jo [ ] | (U) | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 8 | Çikatovë e Vjetër | "Dëshmorët e Drenicës" | 14 | 4 | 2 | Po [ ] Jo [X] | | Po [ ] Jo [X] | Po [ ] Jo [X] |
| 9 | Vërboc | | 10 | 2 | 2 | [ ] [X] | | [ ] [X] | [ ] [X] |

| | | | | | | Po | Jo | | Po | Jo | Po | Jo |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | "Dëshmorët e Fortesës" | | | | | | | | | | |
| 10 | Terstenik II | "Dëshmorët e Qëndreses" | 16 | 3 | 2 | | X | | | X | | X |
| 11 | Vasilevë | "Fazli Grajçevci" | 18 | 4 | 2 | | X | | | X | | X |
| 12 | Gllogoc II | "Halil Bajraktari" | 29 | 3 | 2 | | **X** | U+P | | X | | X |
| 13 | Llapushnik | "Hasan Prishtina" | 26 | 3 | 2 | **X** | | U+P+H | | X | | **X** |
| 14 | Negroc | "Jusuf Gërvalla” | 18 | 4 | 2 | | X | | | X | | X |
| 15 | Sankoc | "Luigj Gurakuqi" | 44 | 3 | 2 | | X | (U) | | X | | X |
| 16 | Bytyq | "Mehdi e Sylejman Bytyqi" | 14 | 2 | 2 | | X | P | | X | | X |
| 17 | Gradicë | "Mehmet Gradica" | | | P+ 1 | | X | | | X | | X |
| 18 | Baicë | "Migjeni " | 22 | 4 | 1 | | X | | | X | | X |
| 19 | Gllobar | "Naim Frashëri " | 19 | 3 | 1 | | X | (U) | | X | | X |
| 20 | Gllogoc | "Rasim Kiçina" | 55 | 8 | 2 | | X | (U) | | X | | X |
| 21 | Likoshan | "Rexhep Gjeli " | 11 | 2 | 1 | | X | (U) | | X | | X |
| 22 | Dobroshec | "Rilindja " | 29 | 5 | 1 | | X | P | | X | | X |
| 23 | | "Shaban Polluzha" | 19 | 3 | 2 | | X | | | X | | X |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Korroticë e Epërme | | | | | Po | Jo | | Po | Jo | Po | Jo |
| 24 | Polluzhë | "Shaban Polluzha " | 11 | 3 | 1 | <br>Po | X<br>Jo | P | <br>Po | X<br>Jo | <br>Po | X<br>Jo |
| 25 | Tërdec | "Shotë Galica" | 15 | 2 | 1 | <br>po | X<br>jo | | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 26 | Komoran | "Xheladin Gashi - Plaku " | 39 | 6 | 2 | <br>po | X<br>jo | | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 27 | Gllanasellë | "Xhevë Lladrovci " | 15 | 3 | 1 | X<br>po | <br>jo | U+H | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 28 | Tërstenik I | "Zenel Hajdini " | 17 | 5 | 1 | <br>po | X<br>jo | | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 29 | Fushticë e Poshtme | “24 Korriku" | | | | X<br>po | <br>jo | | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 30 | Gllogoc | Shkolla e Mesme "Fehmi Lladrovci" | 112 | 1 | 2 | X<br>po | <br>jo | U+H | X<br>po | <br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 31 | Gllogoc | Shkolla e Mesme “GJ.K.Skenderbeu’’ | 68 | 1 | P+ 2 | X<br>po | <br>jo | U+H | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| 32 | Gllogoc | “Ardhmëria” | 19 | 4 | 2 | X<br>po | <br>jo | | <br>po | X<br>jo | <br>po | X<br>jo |
| | **Gjithsejtë** | | **859** | **113** | | | | | | | | |

Gjendja e shkollave sa i përket sistemit të mbrojtjes nga zjarri nuk rezulton e kënaqëshme për shkaqe të mungesës së stafit trajnues për fikjen e zjarrit dhe përdorimit të pajisjeve për mbrojtje nga zjarri siç janë:

- Aparatet kundër zjarrit;
- Instalimi i hidrantëve në objektin e brendshëm shkollor dhe ata të jashtëm.

### *2.3.1 Identifikimi i rreziqeve*

Ekzistojnë 24 objekte shkollore, në arsimin parauniversitar të cilave ju mungojnë shkallët emergjente për evakuim të nxënësve, ku në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera, ku mungojnë edhe

`

shenjëzimet themelore informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, në rast të çfaqjes së nevojës për evakuim emergjent, ku mungojnë pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera si dhe edukimi bazik për reagim emergjent.

#### *2.3.2 Rekomandime*

Për zvogëlimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si zjarri, vërshimet etj. në objektet arsimore rekomandohet që të pajisen të gjitha shkollat:

- Pajisja me shkallë evakuimi për të gjitha objektet me 2 ose më tepër etazha;
- Pajisja me aparate kundër zjarrit, veshje mbrojtëse dhe vegla tjera për raste të fatkeqësive natyrore;
- Pajisja e objekteve sistem të alarmimit dhe lajmërimit të zjarrit;
- Pajisja e objekteve me shenjëzime informuese;
- Pajisja me planin e evakuimit për rastet e fatkeqësive dhe sinjalistiken adekuate për evakuim, etj. ;

## Kreu i III-të

## 3. Të mirat materiale, kulturore dhe të mjedisit

### 3.1. Objektet kulturore

Kultura është pjesë e rëndësishme e jetës së njerëzve që ndikon në pikëpamjet e tyre dhe ndërton identitetin e tyre. Komuna e Gllogocit në këtë grupacion përfshin **6 objekte të kulturës: 4 biblioteka, dhe 1 Qendër rinore dhe 1 sallë e kulturës**.

**Biblioteka në Gllogoc** - (134 $m^2$) gjendet në një objekt të banesave që është pronë publiko-private me gjendje relativisht të mirë. Nëse i referohemi normave të planifikimit (0.25$m^2$/b) atëherë vërehet që sipërfaqja e bibliotekës nuk i plotëson normat teknike. Një tjetër mangësi më e madhe është se nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuara.

**Salla e Kulturës** në Gllogoc - (410 m2) përfshin 310 ulëse, me sallë verore që gjendet në kuadër të sallës së kulturës me një sipërfaqe prej 385m2 dhe përfshin parkingun e sallës me 55 vend parkingje në total që është e ndarë për zyrtarë 25 parkingje dhe për vizitorë me 30 parkingje, **Arkivi Historik i Komunës** me sip. 40$m^2$ .

**Qendra Rinore** në Gllogoc – (323.24 m2)është objekt i vendosur në një parcelë prej 20.77.66 ha. Ky objekt ka pjerrina për persona me aftësi të kufizuar vetëm në përdhesë, ndërsa qasja në kat nuk është e mundur (nuk posedon ashensor apo pjerrinë).

**Biblioteka në Arllat**– me një sipërfaqe prej 54 m2 është në objektin e vjetër të shkollës "Emin Duraku" dhe gjendja e objektit nuk i plotëson standardet e nevojshme dhe normat e teknike të kërkuara me ligj dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar.

**Biblioteka në Tërstenik** – me një sipërfaqe prej 40 m2 për shkak të mungesës së hapësirës është e vendosur në objektin e ofiqarisë. Gjendja fizike e objektit është mesatare dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar. Gravitohet nga banorët që jetojnë në Tërstenik dhe rreth saj.

**Biblioteka në Komoran** - me një sipërfaqe prej 41 m2 për shkak të mungesës së hapësirës është e vendosur në objektin e ofiqarisë. Gjendja fizike është mesatare dhe nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar. Ky objekt gravitohet nga banorët e Komoranit dhe banorët

**Më poshtë janë listuar asete të trashëgimisë natyrore dhe arkeologjike si dhe arkitekturale nën mbrojtje:**

*Tabela 21: Trashëgimia arkeologjike* [1]

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi | I mbrojtur | Siperfaqja |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gërmadhat e kishës së vjetër në Fushticë | Mesjetë | Fushticë, Gllogoc | PO - MKRS | **0.10 ha** |
| 2 | Kalaja Antike dhe Mesjetare në Vërboc | Antikitet i Vonë, Mesjetë | Vërboc, Gllogoc | PO - MKRS | **2.42 ha** |
| 3 | Qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak | Antikitet i Vonë | Vuçak , Gllogoc | PO - MKRS | **2.20 ha** |
| 4 | Kalaja e Llapushnikut | Parahistori, Antikitet i Vonë | Llapushnik, Gllogoc | PO - MKRS | **1 ha** |
| 5 | Tuma e vetmuar në Llapushnik | Parahistori | Llapushnik Gllogoc | PO - MKRS | **0.20 ha** |
| 6 | Fortifikata parahistorike “Gradina” në Çikatovë të Vjetër | Parahistori | Çikatovë e Vjetër, Gllogoc | PO - MKRS | **0.30 ha** |
| 7 | Kalaja - Çuka e Godancit | Parahistori | Godanc, Gllogoc | PO - MKRS | **0.50 ha** |

*Tabela 22: Tregon monumentet e trashëgimisë Kulturore*

| Nr. | Lokacioni | Lloji | Periudha | Shenime |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Dobroshec | Kulla e Habib Xhemajl Agës Dobroshec | Shek. XIX | Mirëmbajtje |
| 2 | Gllogoc | Stacioni i Trenit | v. 1936 | Në gjëndje te mirë mesatare |
| 3 | Dobroshec | Stacioni i Trenit | v. 1936 | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 4 | Qikatovë e Vjetër | Kulla e Ibish Morinës | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 5 | Gradicë | Kompleks banimi Familja Dervisholli | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 6 | Polluzhë | Kulla e Shaban Polluzhës | Shek. XX | Në proces të ndërtimit |

[1] Në bazë të vendimit me numer protokoli 5304/2025/02, datë 10.10.2025, nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport

`

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Poklek i Vjetër | Shtëpi banimi – Smail Haxhiu | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 8 | Korroticë e Ulët | Shtëpi Banimi Muharrem Veseli | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 9 | Baicë | Shtëpi banimi Rexhep Zariqi | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 10 | Polluzhë | Kullë banimi Rashit Istogu | 1912 | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 11 | Gllogoc | Linja hekurudhore Gllogoc - Pejë | 1936 | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 12 | Baicë | Shtëpi banimi Rexhep Zariqi | Shek. XIX | Është dëmtuar në masë të madhe |
| 13 | Polluzhë | Kullë banimi Rashit Istogu | 1912 | Është dëmtuar në masë të madhe |

Në vitin 2014, është bërë lista e objekteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme nga MKRS. Komuna e Gllogocit ka një thesar të çmuar të trashëgimisë kulturore, siç janë: Monumentet e Trashëgimisë Kulturore: Arkitekturale, Arkeologjike dhe Natyrore Lokalitetet dhe monumentet e përfshira në listën me potencial për eko-turizëm të cilat kanë qasje të vështirë të medha për vizitorët si:

**Shpella e Kishnarekës, shpella e Peshterrit në Nekoc, shpellat: Kokilit, Ariut, dhe luftëtarve në Vërboc, Shpella e Baicës, Shpella e Gllanasellës,** Mali i Kosmaqit, Parku i pishave në fshatin Gllobar dhe Komoran.

Me rregullimin e Infrastrukturës do të ofrohet qasja adekuate dhe promovimi i vazhdueshëm i tyre ngase vizitorët mund të shijojnë bukuritë e natyrës dhe ndërkohë të freskohen në liqenin e Vasilevës.

Në komunë shtrihen edhe monumente tjera me vlera historike, siç janë:

*Tabela 23: Trashëgimia kulturore në Komunën e Gllogocit*

| Kategoritë; | Trashëgimia arkitekturale | Trashëgimia arkeologjike | Peisazhet kulturore |
|---|---|---|---|
| **Lokalitete arkeologjike - Kala** | **11 Monumente** | **7 lokalitete** | **Ska** |

*Tabela 24: Trashëgimia kulturore në Komunën e Gllogocit*

| Kategoritë | Monumente arkitekturale | Tërësi arkitekturale | Hapësira arkitekturale konservuese |
|---|---|---|---|
| Kullë-shtëpi | 11 Monumente | % | **1 objekt me 180m$^2$** |

*Figura 4: Harta e Shtrirjës së Asteve të Trashëgimisë Natyrore dhe Trashëgimisë Kulturore*




*Tabela 25: Monumentet Natyrore në Komunën e Gllogocit*

| ***Kodi*** | ***Emërtimi i Zonës/ objektit*** | ***Komuna/ zona*** | ***Sipërfaqja /ha*** | ***Kategoria*** | ***Viti i mbrojtjes*** | ***Përshkrimi i shkurtër i vlerave*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| MN_017 | Shpella e Baicës | Baicë Gllogoc | 0.11 | III | 1987 | Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik |
| MN_018 | Shpella e Gllanasellës | Gllanasellë Gllogoc | 0.05 | III | 1987 | Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik |
| MN_024 | Trungjet e rrënjës (Quercus robër) në Nekovc | Nekovc, Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_025 | Kompleksi i trungjeve të rrënjës | Negroc Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |

`

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (Quercus robur) në Negroc | | | | | |
| MN_026 | Trungjet e shpardhit në Negroc | Negroc Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_027 | Shpella e Kishnarekës | Kizhnarekë Gllogoc | 2 | III | 2006 | Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik |
| MN_028 | Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë | Krajkovë Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_029 | Guri i Gradinës në Llapushnik | Llapushnik Gllogoc | 2 | III | 2006 | Monument natyror me karakter gjeomorfologjik |
| MN_030 | Burimi i ujit mineral, në Poklek | Poklek Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter hidrologjik |
| MN_031 | Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan | Likoshan Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_032 | Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Tërstenik | Tërstenik Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_033 | Trungu i dushkut (Quercussp) në Likoshan | Likoshan Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |
| MN_034 | Guri i plakës në Dobroshec | Dobroshec Gllogoc | 0.05 | III | 2006 | Monument natyror me karakter botanik |

**Trashëgimia Kulturore që i përket historisë së re**

Në vitin 2018, në shenjë respekti dhe përkujtimi është ngritur përmendorja e ,,Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" në Sheshin e qytetit të Gllogocit, po ashtu në vitin 2019, janë ngritur përmendoret në shenjë respekti dhe përkujtimi edhe për dëshmoret e rënë për liri të familjes legjendare ,,Shaban, Hamez e Adem Jashari" dhe dëshmorve "Ilaz Kodra, Rasim Kiqina, Bedri Shala"dhe në vitin 2025 edhe përmendorja e heroit" Asllan Fazliu".

## 3.2. Parqet nacionale

Komuna e Gllogocit nuk posedon me parqe naconale, parqe natyrore dhe rezervate që janë të emertuara nga Kuvendi i komunës ndërsa është e begat me sipërfaqe pyjore, ku në të ardhëmen me një zhvillim ekonomik mund që një pjesë e këtyre sipërfaqeve pyjore ku kapin sipërfaqen prej 10895$^{ha}$, të shërbejn si parqe natyrore, si: Malet e Berishës, malet e Qyqavicës etj.

### *3.2.1.Hapësirat publike dhe të gjelbëra*

Komuna e Gllogocit ka të identifikuara 7 hapësira publike të cilat gjenden në qytetin e Gllogocit:

- Sheshi "Fehmi Lladrovci";
- Parku i qytetit;
- Parku i Komunës së re;
- Parku i Komunës së Vjetër;
- Hapësirë e gjelbëruar i Banesave (tek 5 blloqet);
- Hapësirë e gjelbëruar në afërsi të Çerdhja "Ardhmëria" dhe
- Hapësirë e gjelbëruar në afërsi të qendres së re zejtare.

Këto hapësira janë pjesë-pjesë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe tentojnë të formojnë një rrjet të unifikuar të gjelbër me përmbajtje rekreative për të rritur dhe fëmijë. Qasja ofrohet kryesisht përmes transportit privat, ndërsa për banorë të moshuar, nënat me fëmijë dhe personat me nevoja të veçanta, qasja është e lehtësuar përmes intervenimeve si ‘pjerrinat’, ofrimit të ulëseve dhe hijes për mbrojtje nga dielli si dhe ofrimit të ujit të pijshëm. Në total janë 4.13 ha sipërfaqe të hapësirave të gjelbra që i shërben 58,531 banorëve në tërë komunën, që rezulton me vlerë prej 0.70 $m^2$/banor. Duke e krahasuar këtë rezultat me standardet nga Normat e Planifikimit 22, rezulton që Komuna e Gllogocit ka deficit.

*Figura 5: Harta e Planit të Hapësirave Publike dhe të Gjelbra*




### *3.2.2. Sipërfaqet pyjore/bio-diversiteti*

Territori i Komunës së Gllogocit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug-Perëndimore, Kasmaqit në pjesën Perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore.

Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Sipërfaqja totale e pyjeve është **11355** $^{\mathbf{ha}}$, ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 41.2% Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në Pal Nikës të maleve të Berishës.

*Tabela 26: Hapësira Pyjore në Komunën e Gllogocit*

| **Pyjet e sektorit publik dhe privat** | | **Sektori publik/ ha** | **Sektori privat/ ha** |
|---|---|---|---|
| | **11, 355** $^{\mathbf{ha}}$ | 7,040 $^{ha}$ | 4,315$^{ha}$ |

*Figura 6: Hapësira Pyjore në Komunën e Gllogocit*




## *3.2.2. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore*

Përpos begative të tjera territori i Komunës së Gllogocit karakterizohet me lloje të ndryshme të florës dhe faunës.

**Flora:** Në pjesët malore prezent janë llojet e drurit: ahu, bungu, qarri, frashri, shkoza, plepi i egër, molla e egër, dardha e egër, shelnja e tj. Ndërsa nga drunjtë e shkurta (shkurret) lajthi, manaferra, kaça, kulumbria etj.

**Fauna***:* llojet dhe gjendja e kafshëve të egra
Fauna është ndikuar nga pozicioni gjeografik dhe kushtet e vendit, të cilave i përshtaten disa kafshëve.Të gjitha fushat dhe zonat kodrinore janë një lloj strehimi për derrin e egër, lepujt, korbat, laraskat, gargulleshat, harabelat e fushës, qukapikët dhe kumriat. Në zonat malore jetojnë thëllëzat, shkurtëzat, fazani, ketri, lejlekët, disa lloje të shqiponjave, hutat, gjeraqinat etj..

Grupet e kafshëve të rralla përfshijnë, ujkun, kaprollin, pulën e egër dhe pulën e pyjeve.

## 3.3. Bujqësia

Bujqësia është një nga veprimtaritë kyçe në këtë trevë mirëpo, sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2024), vetëm rreth 43 % të të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Bujqësia, në sektorin privat është e zhvilluar kryesisht në formë të bujqësisë familjare, fermave për jetesë dhe tokave të vogla private bujqësore, ku viteve të fundit sektorit të bujqësisë është duke iu kushtuar vëmendje më e shtuar si nga institucionet qeveritare ashtu edhe nga ato komunale, me subvencione, ndërtim të kanaleve për ujitje dhe aplikimit të masave intensive agro-teknike. Pjesa më e madhe e koncentrimit bujqësorë-agrar është në zonat e tokës bujqësore në kultivimin e dridhërave duke rritur prodhimtarin e produkteve të blegtoriale, shpeztarisë dhe pemë dhe perime.

### *3.3.1.Zhvillimi bujqësor dhe rural*

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për Komunën e Gllogocit ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes se këtij sektori të ardhurat neto për fermerët janë rritur ndjeshëm.

Sa i përket bujqësisë Komuna e Gllogocit ka: **6,103.00** hektarë tokë të punueshme (ara), **7,080.00** hektarë kullosa dhe livadhe, kopshte **83,00 ha,** serra **21.15 hektarë**, pemishte **196 hektarë**, vreshta **5.72 ha** etj. Tokat e punueshme shfrytëzohen për të siguruar ushqim për njerëz, kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare: grurë, misër dhe perime. Sa i përket sektorit të pemëtarisë, Komuna e Gllogocit ka mbështetur me subvencione ngritjen e plantacioneve që kultivohen: mollë, dardhë, kumbulla, mjedra arra, manaferra, etj. për 179 hektarë. Komuna ka mbështetur zhvillimin e ekonomisë bujqësore lokale, edhe përmes sigurimit të 12500 m² serra, apo 12.15 ha për 3816 ekonomi familjare. Kjo mbështetje ka treguar rezultate premtuese në prodhimin e kulturave perimore (tranguj, domate, speca, sallatë e gjelbër, etj.).

Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale (produktet e qumështit), shpeztari, bletari si dhe prodhimet e verës.

`

*Figura 7: Harta e Kategorive të Tokës Bujqësore*




*Tabela 27: Sipërfaqja e tokës në përdorim nga ekonomitë familjare*

| Komuna | Gjithsej | | Sipërfaqja e tokës në përdorim nga ekonomitë familjare | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ekonomi familjare | Ekonomi familjare qe kanë tokë në pronesi apo në shfrytezim | Tokë e punueshme (ara) | Serrat | Livadhet (tërfili, bari i përzier, jonxhe etj) | Pemishte | Vreshta | Djerrinë (tokë e pakultivuar për më shumë se 2 vite) | Kullosë | Pyje | Të tjera (oborre shtëpie, hurdha peshqish ...) |
| | | | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha |
| **1** | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| **Gllogoc** | **3816** | **/** | **6,103** | **12.15** | **7,080** | **196** | **5.12** | **1,651.66** | **1600** | **11,355.00** | **83.00** |

### 3.3.2. Kultivimi i bimëve një vjeçare

Sipërfaqe e punueshme me kultura bujqësore njëvjeqare(ara) në Komunen e Gllogocit janë 4740 hektarë,

Sipërfaqe me drithëra të bardha janë **4597** hektar.

Egziston infrastruktura në kuadër të industrisë përpunuese të ktyre produkteve agrare e cila mundëson: grumbullim, vendosjen dhe ruajtjen/deponimin dhe përpunimin e drithëravenë komunën tonë e cila bënë pjesë në segmentin e biznesit agro-industrial. Komuna e jonë është e përfshirë në kuadër të sistemit të ujitjes " 5600 ha me Ibër-Lepenc" apo tjetër. Aktualisht ujiten 50 % të tokës punuese, ndërsa vendbanimet që merren me kultivimin e bimëve shumëvjeçare, 50% prej tyre nuk kanë sistem të përshtatshëm të ujitjes në të gjitha zonat. Problemi me pamjaftueshmërinë e sistemit të ujitjes është i theksuar më së shumti në fshatra që kanë prodhimin e kulturave njëvjeçare. Ujitja është një çështje shumë e rëndësishme dhe vitale për kultivimin e produkteve bujqësore.

*Tabela 28: Sipërfaqet e realizuara me mbjellje një-vjeqare*

| Nr. | Kultura: | Fermer /numri | Sipërfaqja e realizuar/ ha | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1. | Misër | 560 | 1917.18 | 2017.10 | 2305.70 |
| 2. | Grurë | 849 | 1913.93 | 2630.02 | 2133.80 |
| 3. | Elb | 20 | 28.52 | 23.19 | 45.63 |
| 4. | Tërshërë | 34 | 60.55 | 74.59 | 100.53 |
| 5. | Bimë Furragjere | / | 145 | 120 | 110 |
| 6. | Bimë industrial | / | 00 | 00 | 4.70 |
| 7. | Perime në serra | / | 2.40 | 4.85 | 21.15 |
| 8. | Perime në fushë të hapur | 108 | 94.92 | 50.03 | 143.08 |
| 9. | Patate | 10 | 8.15 | 5.40 | 6.53 |

### *3.3.3. Kultivimi i kulturave bujqësore shumë-vjeçare*

Në komunën e Gllogocit me veprimtarinë e kulturave shumë-vjeqare / plantacione të reja të ngritura pas luftës, afërsisht 145 ekonomi familjare bujqësore me sipërfaqe rreth 196 hektar me kultura shumë-vjeqare. me sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 56.68 %, me mjedër 0.11 % , me arrë 37.74%, dardhë 4.10 % , hardh rrushi 1.38 %, sa i përket sasisë së prodhimit, analizat e statistikave për periudhën 2021 – 2024 tregojnë rritje (zvogëlim) të prodhimit të të gjitha pemëve.

*Tabela 29: Sipërfaqet e realizuara me kulturat shumë-vjeqare*

| Nr. | **Kulturat** | **Fermer / numri** | **Sipërfaqja e realizuar /ha** | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1. | Pemë molla | 79 | 84.45 | 86.27 | 79.20 |
| 2. | Arra | 45 | 42.30 | 45.15 | 52.70 |
| 3. | Mjedër | 1 | 1.36 | 0.15 | 0.15 |
| 4. | Dardha | 4 | 0.78 | 0.75 | 1.93 |
| 5. | Kumbell | 33 | 17.15 | 20.15 | 27.40 |
| 6. | Lajthi | 5 | 3.99 | 3.72 | 3.39 |
| 7. | Qershi | 4 | 0.50 | 2.36 | 3.95 |
| 8. | Vishnje | 2 | 0.66 | 0.50 | 1.16 |
| 9. | Hardhi rrushi | 1 | 5.32 | 5.32 | 5.72 |

## *3.4.Agrobiznesi*

Ekonomia e Komunës së Gllogocit është kryesisht bazuar biznesin individual ne sektorin e : bujqësisë, tregtisë, ndërtimtarisë dhe përpunimit të ushqimit. Në Komunën e Gllogocit janë të regjistruara dhe zhvillojnë aktivitete 3862 biznese private që operojnë brenda juridiksionit Komunal. Bujqësia është një ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe të sigurisë së ushqimit. Sektorët të cilët vazhdojnë të kenë kushte të favorshme dhe me rendimente në rritje janë: Sektori i pemëtarisë, blegtorisë, drithërat si dhe kultivimi i frutave dhe perimeve dhe përpunimi i tyre në produkte finale. Përkundër potencialeve për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet pak i përfaqësuar me vetëm 25 % nga se zhvillimet e hovshme në sektorët e tjerë, sidomos migrimi dhe emigrimi i popullatës një pjesë e madhe e tokës ka mbetur e pa punuar, ndikim negativ ka edhe ndërtimi i objekteve të ndryshme në toka bujqësore, siç janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzinës dhe objektet e ndryshme industriale, kjo ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shëndërruar në tokë ndërtimore.

### 3.4.1. Fermat bujqësore

Kultivimi i shtazëve, shpezëve dhe përpunimit të mishit ka të bëjë me biznesin privat andaj bartës ekskluziv të kësaj sfere janë subjektet private dhe fermerët individual të cilët merren me këtë veprimtari.

*Tabela 30: Fermat e shtazëve në Komunën e Gllogocit*

| Nr. | Kategoria e fermave | Nr. i fermave | Njësia në copë/krerë | Lokacioni | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ferma e lopëve qumështore me mbi 5 krerë | 168 | 1683 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Gllogocit | Qumështore Reproduktim |
| 2 | Krer të deleve mbi 30 krere | 89 | 5475 | Ne disa fshatra | |
| 3 | Krere të dhive mbi 30 | 9 | 701 | Ne disa fshatra | |
| 4 | Ferma të Pulave | 2 | 17000 | Arllat | |
| 5 | Bletë mbi 30 koshere | 75 | 4938 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Gllogocit | |

### 3.4.2. Turizmi

Komuna e Gllogocit është e pasur me atraksione të ndryshme natyrore. Edhe Komuna e jonë disponon me bukuri natyrore, shtigjet e përshtatshme për këmbësorë, ajri i pastër, burimet e ujit/lumi, me veçoritë dhe pasuritë reale natyrore për zhvillimin e turizmit malor , dimëror, sportiv, shëndetësor, etj.).

*Tabela 31: Asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore*

| NR. | ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE | LLOJI |
|---|---|---|
| 1 | Kulla Veli Pajaziti | Trashëgimi Kulturore |
| 2 | Gradina e Madhe (Gjyeti i Madh) dhe Gradina e Vogël (Gjyeti i Vogël) | Trashëgimi Kulturore |
| 3 | Kalaja e Llapushnikut | Trashëgimi Kulturore |
| 4 | Tuma e vetmuar në Llapushnik | Trashëgimi Kulturore |
| 5 | Fortifikata parahistorike "Gradina" në Çikatovë të Vjetër dhe monumenti për Fehmi e Xheva Lladrovci (1998) | Trashëgimi Kulturore |
| 6 | Kalaja Çuka e Godancit | Trashëgimi Kulturore |
| 7 | Germadhat e Kishës së Vjetër në Fushticë | Trashëgimi Kulturore |
| 8 | Kalaja antike dhe mesjetare në Vërboc | Trashëgimi Kulturore |
| 9 | Kulla e Habib Xhemajlagës - Dobroshec (Dritan) | Trashëgimi Kulturore |
| 10 | Stacioni i trenit në fshatin Dobroshec | Trashëgimi Kulturore |
| 11 | Kulla e Ibish Morinës | Trashëgimi Kulturore |

`

| | | |
|---|---|---|
| 12 | Kompleksi i banimit i familjes Dervisholli | Trashëgimi Kulturore |
| 13 | Kulla e Shaban Polluzhës | Trashëgimi Kulturore |
| 14 | Shtëpia e banimit – Smail Haxhiu | Trashëgimi Kulturore |
| 15 | Mulliri i Gani Syla, shek. XIX – Kishnarekë, Gllogoc | Trashëgimi Kulturore |
| 16 | Shtëpi banimi Rexhep Zariqi | Trashëgimi Kulturore |
| 17 | Linja hekurudhore Gllogoc - Pejë | Trashëgimi Kulturore |
| 18 | Shtëpia e Muharrem Sali Veselit – Korroticë e Ulët | Trashëgimi Kulturore |
| 19 | Kullë banimi Rashit Istogu | Trashëgimi Kulturore |
| 20 | Shpella e Kishnarekës | Monument Natyror |
| 21 | Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) – Krajkovë | Monument Natyror |
| 22 | Guri i Gradinës në Llapushnik | Monument Natyror |
| 23 | Trungu i Dushkut në Likashan (6 lisat) | Monument Natyror |
| 24 | Guri i Plakës | Monument Natyror |
| 25 | Liqeni i Vasilevës | Monument Natyror |
| 26 | Pishat e Kamenicës – Fsh. Gllobar | Monument Natyror |

*Figura 8: Harta e Shtrirjës së Aseteve të Trashëgimisë Natyrorë dhe Trashëgimisë Kulturore*






*Figura 9: Katalogu turistik i Komunës së Gllogocit*

### *3.4.3. Sektori privat /komuniteti i biznesit*

Qyteti i Gllogocit ka një traditë të hershme manifakturale dhe për përpunimin e materialeve të ndryshme nga guri, druri, për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare si dhe veprimtari hoteliere. Veprimtari bazë e ndërmarrjeve private është prodhimi i FeroNikelit. Komuna e Gllogocit ka kushte mjaftë të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtesë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik e cila ka potencial ende të pa shfrytëzuar nga aspekti i pasurisë mbitokësore, nëntokësore , burimet e ujit, malore , bujqësia , energjia, etj. Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Gllogocit janë: ekonomitë e vogla familjare, shërbimet, bujqësia, tregtia dhe remitencat nga Diaspora. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e bizneseve makro, ende mbetet i pafavorshëm dhe kërkon mbështetje institucionale të fuqishme.

*Tabela 32. Bizneset aktive në Komunen e Gllogocit*

| | |
|---|---|
| SEKTORI A -BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI | 124 |
| SEKTORI B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE) | 7 |
| SEKTORI C - INDUSTRIA PËRPUNUESE | 300 |
| SEKTORI D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR | 4 |
| SEKTORI E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, VEPRIMTARITË E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE | 12 |
| F - NDËRTIMTARIA | 445 |

`

| | |
|---|---|
| SEKTORI G- TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE | 729 |
| SEKTORI H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI | 100 |
| SEKTORI I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR | 153 |
| SEKTORI J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI | 61 |
| SEKTORI K -VEPRIMTARITË FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT | 4 |
| SEKTORI L - VEPRIMTARITË E PATUNDSHMËRISË | 6 |
| SEKTORI M - VEPRIMTARITË PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE | 110 |
| SEKTORI N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE | 107 |
| SEKTORI O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM | 2 |
| SEKTORI P - ARSIMI | 25 |
| SEKTORI Q - VEPRIMTARITË E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE | 60 |
| SEKTORI R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI | 40 |
| SEKTORI S - VEPRIMTARITË E TJERA SHËRBYESE | 163 |
| SEKTORI T - VEPRIMTARITË E EKONOMIVE FAMILJARE SI PUNËDHËNËS; MALLRAT DHE SHËRBIMET E PADIFERENCUARA, VEPRIMTARITË E EKONOMIVE FAMILJARE PËR PËRDORIM VETANAK | 0 |
| SEKTORI U - VEPRIMTARITË E TRUPAVE DHE ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE | 0 |
| GJETHSEJ BIZNESET JANË | **2452** |

*Tabela 33: Ndërmarrjet private në Komunën e Gllogocit*

| Nr. | **Ndërmarrjet Private** | | |
|---|---|---|---|
| | **Kompania** | **Lokacioni** | **Veprimtaria** |
| **1** | Biznese aktive 2000-2023 | Gllogoc | **2197** |
| **2** | B.I | | 1301 |
| **3** | SH.P.K | | 896 |
| **4** | Biznese aktive 2000-2024 | Gllogoc | **2452** |
| **5** | B.I | | 1512 |
| **6** | SH.P.K | | 940 |

Në komunë janë të regjistruara deri në vitin 2024 gjithësej **2452** biznese. Nga bizneset e regjistruara ,**1512** ose 62% biznese janë individuale ndërsa **940** ose 38% janë biznese SHPK, Shoqëri Aksionare – Ortakëri, bizneset e huaja dega në Kosovë, etj. Viteve të fundit ka rritje te bizneseve të tipit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

### *3.4.4. Të dhënat statistikore ndër vite*

Në Komunë janë të regjistruara deri në vitin 2023 gjithsej **2197** biznese. Nga bizneset e regjistruara , **1301** ose 61% biznese janë individuale ndërsa **896** ose 39% janë biznese SHPK, Shoqëri Aksionare – Ortakëri, bizneset e huaja dega në Kosovë, etj.

### *3.4.5. Zonat industriale dhe objektet ekonomike*

Në këto objekte, shkalla e rrezikshmëris është e theksuar , në krahasim me objektet të tjera , sidomos objekti i Ferronikelit duke e pasur parasysh teknologjinë që e përdorë kjo kompani. Gjithashtu shkallë të rrezikshmërisë paraqet edhe teknologjia për përpunimin e gurit, e që në Komunën e Gllogocit është mjaftë e theksuar, të cilat janë të regjistruara në zona katastrale. Paraqitja dhe sipërfaqja e këtyre objekteve është si në vijim.

*Tabela 34: Objektet industriale në Komunën e Gllogocit*

| Objektet industrial | Vendi i objktit | Siperfaqja $m^2$ |
|---|---|---|
| Objekti i Feronikelit | Qikatovë e Vjetër | 22,151 $m^2$ |
| Minjera e Feronikelit | Qikatovë e Vjetër | 1,235 $m^2$ |
| Objekti i fermes së Viqave | Krajkovë | 7,649 $m^2$ |
| Trasing Group | Korroticë e Epërme | 8500 $m^2$ |
| Qëndra e biznesit | Korroticë e Epërme | 47,983 $m^2$ |
| Qendra tregtare | Gllogoc | |

Në vitin 2004 ka filluar punën Qendra e Re Tregtare që ka 134 lokale tregtare- zejtare e që kishte punësuar rreth 150 veta. Komuna ka realizuar këtë projekt në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, ku Komuna ka bashkë investuar me sigurimin e projektit, menaxhimin e projektit dhe dhënien e tokës ndërtimore.

## 3.5.Objektet

### *3.5.1. Objektet e banimit*

Në Komunën e Gllogocit numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 13,593 ku pjesa më e madhe e njësive të banimit gjendet në zonën urbane të Komunës 3,707 ndërsa në atë rural 9,886 ekonomi familjare.

*Tabela 35: Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit dhe tipit të vendbanimit në Komunë*

| **Lloji i objektit** | **Urban** | | | **Rural** | | | **Gjithësej** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Banesa kolektive** | **Ekon. Familjare** | **Persona** | **Banesa kolektive** | **Ekon. Familjare** | **Persona** | **Banesa kolektive** | **Ekon. Familjare** | **Persona** |
| Komuna e Gllogocit | 2,636 | 2,653 | 12,315 | 7,165 | 7,225 | 35,764 | 9,801 | 9,879 | 48,079 |

### *3.5.2. Objektet afariste*

**Objektet afariste** - strukturë heterogjene e ndërtimeve në Komunën e Gllogocit ku dominon në vendbanimet urbane dhe rreth akseve rrugore, ku ka qasje dhe frekuentim më të madh të njerëzve dhe automjeteve. Këto objekte ku zhvillohen veprimtari të ndryshme ndahen në dy grupe më pastaj: objekte të ndërtuara urbane, me destinime të përbashkëta, me banim kolektiv në katet më të larta, ndërsa me destinacion të veprimtarisë në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme afariste: tregtare, shërbyese, zejtare, kulturore, shëndetësore, etj. Brenda hapësirave urbane afarojnë edhe biznese me objekte të cilat disponojnë sipërfaqe të mëdha të cilat merren me shërbime, si : qendrat tregtare, bao-marketet, stacionet e derivateve, etj. Bizneset që afarojnë me objekte prodhuese, deponime të materialeve të ndryshme, materialeve lehtë-ndezëse apo materiale të rrezikshme janë të ndërtuara në zona /park biznesi me destinacion dhe planifikim hapësinorë dhe urbanistik, në pajtueshmëri me PZhK dhe normat ligjore në fuqi.

Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë Komunale mund të jenë:

- Industria dhe bizneset me ndotje të vogël;
- Industritë/ bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore dhe të importuara, ( me materie të rrezikshme, lehtëndezëse, shpërthyese, etj)
- Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produkte bujqësore.

### *3.5.3. Objektet sportive*

**Fusha Sportive** - Stadiumi i qytetit **„Rexhep Rexhepi"** në Gllogoc- me një sipërfaqe prej 6300 m² që menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Nëse krahasohet me norma teknike 21 (4.5m²/b) atëherë vlërshet se nuk është i plotësuar ky kriter. Duhet të theksohet se përveç fushës së lojës nuk ka shtegun për vrapim. Gravitohet nga banorë e Gllogocit dhe banorët e fshatrave që jetojnë rreth saj(shih shtojcën).

**Palestra sportive "Hysni Jetullahu" në Poklek i Ri** – është objekt që përfshin në vete edhe zyre dhe menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Stadiumi sintetik Qikatovë e Re – Gllogoc** – përdorët gati çdo ditë nga klubet sportive dhe shkollat e futbollit.Menaxhohet nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Fusha sintetike/ Komoran, Damanek dhe Polluzhë,** - janë prona publike por të menaxhuara nga komuniteti i fshatit. Fusha në Komoran dhe Polluzhë janë nga betoni Komuna është duke investuar në përmirësimin e fushave sportive (rrethojat)

### *3.5.4. Objektet Kulturore, Sportive dhe Rinore*

- **Salla e Kulturës,**
- **Arkivi Historik i Komunës,**
- **Biblioteka në Gllogoc, Komoran, Tërstenik, Arllat**
- **Stadioni Sintetik Qikatovë e Re - Gllogoc, Komoran ( në ndertim),**
- **Stadioni i Qytetit Rexhep Rexhepi,**
- **Palestra Sportive "Hysni Jetullahu"**

*Tabela 36: Objektet sportive*

| Vëndi | Stadium i qytetit | | | Palestra sportive | | | Stadiumi sintetik | | | Fusha sintetike | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sasia: | $m^2$ | ulse | Nr: | $m^2$ | ulse | Nr: | $m^2$ | Ulse | Nr: | $m^2$ | Ulse |
| Gllogoc | 1 | 6300 | / | / | / | / | 1 | 1863 | / | / | / | / |
| Komoran | / | / | / | / | / | / | / | / | / | 1 | $0.25^{ha}$ | / |
| Damanek | / | / | / | / | / | / | / | / | / | 1 | $0.25^{ha}$ | / |
| Polluzh | / | / | / | / | / | / | / | / | / | 1 | $0.25^{ha}$ | / |
| Poklek i Ri | / | / | / | 1 | 1775 | / | / | / | / | / | / | / |
| Qikatov e Re | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |

### *3.6. Strehimoret dhe objektet për strehim*

Në Komunën e Gllogocit nuk kemi strehimore të veqanta për këto raste, mirëpo Drejtorati për SHPE-cë, i ka paraparë këto objekte të përkohëshme për strehim emergjentë si në tabelën e më poshtme.

*Tabela 37: Objektet për strehim të përkohshëm për rastet emergjente*

| Nr: | Komuna | Lloji dhe lokacioni i strehimorës | Departamenti administrativ | Kapaciteti për familje | Kapacitet për individ | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Gllogoc | Salla e sporteve në shkollën fillore ,,Rasim Kiqina" | Drejtoria e Arsimit | 20 familje me nga 5 anëtarë | 100 anëtarë | Përkohësishtë |
| 2. | Poklek i Ri | Salla e sporteve në Shkollën e mesme ,"Gjergj Kastrioti-Skenderbeu'' | Drejtoria e Arsimit | 100 familje me nga 5 anëtarë | 500 anëtarë | Përkohësishtë |
| 3. | Poklek i Ri | Salla e sporteve në Shkollën e mesme | Drejtoria e Arsimit | 100 familje me nga 5 anëtarë | 500 anëtarë | Përkohësishtë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | profesionale "Fehmi Lladrovci" | | | | |
| 4. | Poklek i Ri | Palestra soprtive "Hysni Jetullahu" | Drejtoria e kultures | 200 familje me nga 5 anëtarë | 1000 anëtarë | Përkohësishtë |

Gjëndja e objekteve për strehim të përkohshëm sa i përket gjëndjes teknike mund të themi se janë me kushtet mesatare, në të gjitha objektet ka energji elektrike, ujë të pishem, banjo dhe tualete.

### 3.7. Kapacitetet shëndetësore publike dhe private

- Institucione me veprimtari spitalore 28;
- Institucione private stomatologjike 31;
- Institucione private Fizioterapisë 5;

Këto të dhëna ( për institucionet private shëndetësore) janë marrë nga Drejtoria e Ekonomisë në Komunën e Gllogocit.

**Drejtoria Komunale për Shëndetësi** së bashku me stafin e tij është organi përgjegjës i cili i zhvillon politikat dhe kujdeset për funksionimin dhe organizimin në nivel parësorë-komunal. DSHMS, aktualisht ka staf të mjaftueshëm, 4 zyrtarë profesional dhe administrativ. Organizimi i shërbimeve shëndetësore parësore bëhet përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 7 Ambulanca te Mjekësisë Familjare , ku numri i personelit të punësuar në QKMF, QMF dhe AMF është 179 nga gjithsej 205 vende pune (pozita) të lejuara. Organizimi parësor shëndetësorë në Komunën e Gllogocit është si në vijim:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Hafir Shala";
- Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF): 3 qendra;
- Ambulanca shëndetësore (AMF): 7 qendra.

*Tabela 38: Institucionet shendetësore në Komunën e Gllogocit*

| Titulli i institucioneve shëndetësore | Zona e mbulimit/ Lagje, Fshatra | Zona e mbulimit të banorve | Resurset humane | Orari | Infrastruktura |
|---|---|---|---|---|---|
| QKMF Gllogoc | Gllogoci 1, 2, Çikatovë e Re, Çikatovë e Vjetër, Gllobar, Shtrubullovë, Poklek i Ri, Lagja e Feronikelit | 14896 | Doktor familjarë 10 dhe Infermier familjarë 20 | 24 /7 Shërbimi i urgjencës dhe Materniteti | Objekti nuk ka shkallë emergjente, pjerrinë (vetëm në hyrje) apo ashensorë 2500 m (3 kat) |
| QMF Komoran | Komoran 1,2,3,4 | 11561 | Dr. Familjarë 6 dhe infermier familjarë 12 | 24/7 Shërbimi i Urgjencës | Objekt i ri (një katësh) Ka pjerrinë 154 m (1 kat) |
| QMF Arllat | Arllat, Llapushnik 1/2, Negroc, Vuçak, Gjergjicë | 5990 | Dr. familjarë 3 dhe infermier familjarë 6 | 8:00-16:00 | Objekti nuk ka pjerrinë 144 m (1 kat) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| QMF Terstenik | Terstenik 1, 2, Polluzhë, Verboc, Shtuticë | 7101 | Dr. familjarë: 3 dhe infermier familjarë 6 | 8:00-16:00 | Èshtë objekti ri Ka pjerrinë 150 m (1 kat) |
| AMF Gllansellë | Gllanasellë,Likoshan, Godanc. Zona e mbulimit banorë: | 3210 | Dr. familjarë: 2 dhe infermier familjarë 4 | 8:00-16:00 | Objekt i renovuar vetëm kati parë shfrytëzohet për veprimtari shëndetësore, Nuk ka pjerrinë 288m$^2$ (2 kate) |
| AMF Baicë | Baicë | 2307 | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë: 2 | 8:00-16:00 | Objekt i ri (një katëshe 144 m) Ka pjerrinë |
| AMF Dobroshec | Dobroshec | 1457. | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë 2 | 8:00-16:00 | Objekt ka pjerrinë 120 m (1 kat) |
| AMF Poklek Vasilevë | Poklek/Vasilevë | 3601 | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë: 2 | 8:00-16:00 | Objekti nuk ka pjerrinë 90 m (1 kat) |
| AMF Nekoc | Nekoc | 3118 | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë: 2 | 8:00-16:00 | Objekti. ka pjerrinë 144 m (1 kat) |
| AMF Abri | Abri | 1776 | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë: 2 | 8:00-16:00 | Objekt nuk ka pjerrinë 100m(1 kaT) |
| AMF Sankoc | Sankoc | 2421 | Dr. familjarë: 1 dhe infermier familjarë: 2 | 8:00-16:00 | Objekti nuk ka pjerrinë 100 m (1 kat) |

Sipas U.A. 04/2020 çdo AMF ofron shërbime shëndetësore deri ne 10.000 banorë, kurse QMF-të ofrojnë shërbime shëndetësore jo më pakë se 10.000 banorë duke respektuar kriterin një ekip i mjekësisë familjare me 2000 banorë, (një mjek, dy infermier).

Në të gjitha këto institucione gjinden aparate për fikjen e zjarreve , mirëpo nuk janë kontrolluar dhe atestuara nga profesionistet e këtyre pajisjeve, andaj nuk mund të themi se janë funksionale.

*Tabela 39: Numri i të punsuarve në QKMF, QPS dhe DSHMS*

| **Totali i të punësuarve në QKMF, QPS dhe DSHMS** | | |
|---|---|---|
| Kujdesi Parësorë Shëndetësorë (KPSH) | Gjithësej | 188 |
| Qendra për Sociale | Gjithësej | 14 |
| Drejoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Gjithësej | 4 |

`

*Tabela 40: Kapacitetet teknike në sektorin publik (QKMF/QMF)*

| Nr. | *Kapacitetet shëndetësore reaguese publike* | Dinamika |
|---|---|---|
| 1. | Dhënja e ndihmës së parë nga personeli profesional/numri | **4** |
| 2. | Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (transporti me AMF) | **17 min** |
| 3. | Transporti nga lokacioni i pacientit në QMF/Qendra spitalore/ QSUK | **25 min** |
| 4. | Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë (24 h) | **8** |
| 5. | Numri i shtretërve në QKMF | **36** |
| 6. | Numri i shtretërve në QMF | **14** |
| 7. | Numri i shtretërve mobil në QMF/AMF | **18** |
| 8. | Numri i leseve për të lënduar | **9** |
| 9. | Autoambulanca | **6** |
| 10. | Shërbime për dializë (numri) | **E kontraktuar** |
| 11. | Automjetet e QKMF/QMF për realizim të detyrave dhe shërbimeve | **5** |
| 12. | Siperfaqja e të gjitha objekteve në meter katror QKMF.QMF,AMF | **7127.00** |

### *3.7.1. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente*

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të triazhës së pacientit dhe mbajtja e evidencës,
- stabilizimin fillestar te parametrave shëndetesorë emergjent të pacientëve te klasifikuar urgjent dhe përgatitjen sa më profesionale për transport në Qendrat më të avansuara;
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale;
- Marrja e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre;
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera;
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente;
- Sanimi i terenit-lokacionit të aksidentuar;
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funksionim adekuatë në situata emergjente;

- Stabilizimin fillestar te parametrave shëndetesorë emergjent të pacientëve të klasifikuar urgjent dhe përgatitjen sa më profesionale për transport në Qendrat më të avansuara;
- Dhe detyra tjera sipas specifikave dhe nevojave.

**Shërbimet që kryhen ne Klinika Private Shëndetësore-KPSH janë:**

- Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshire informimin,komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;
- Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
- Shërbimet esenciale kurative dhe nderhyrjet e vogla kirurgjike;
- Sherbime të kujdesit akut dhe urgjent;
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor per sëmundjet kronike;
- Shërbimet e kujdesit shëndetesor per fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë;
- Shërbimet e shëndetit riprodhues;
- Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues;
- Shërbimet e shëndetit mendor;
- Shërbimet e kujdesit shtëpiak perfshire shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijes, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtepiak bazuar në nevojat e popullates dhe prioritetet e shëndetit publik;
- Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.

Profesionistet shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësore nëpër institucionet e Klinikave Private Shëndetsore- KPSh jane:

*Tabela 41: Personeli i QKMF/QMF në Komunën e Gllogocit*

| Lokacioni/lagjia: | | Peroneli shëndetësorë | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mjek i përgj. | Mjek Spec. | Teknik medic. | Stom. | Labor. dhe RTG | Stafi adm. | Shofer i AMF | Punëtor ndihmës | Radiolog |
| 1. | QKMF rruga Xhevat Demaku<br>Nr. tel.emergjent 038-584-094<br>Drejtoria 038-585-255 | 9 | 12 | 53 | 3 | 10 | 6 | 5 | kontraktuar | 1 |
| 2. | QMF Komoran<br>Nr. tel. | 5 | 3 | 24 | 1 | 5 | | | | |
| 3. | QMF Terstenik | 1 | 1 | 5 | 1 | 1 | | | | |
| 4. | QMF Arllat | | 1 | 4 | | | | | | |
| 5. | AMF.Nekoc,Sankoc,Baicë,Abri, Gllanasellë,Dobroshec,Vasilevë | 6 | 1 | 15 | | | | | | |
| Gjithsej: | | 21 | 18 | 101 | 5 | 16 | 6 | 5 | 12 | 1 |

`

*Tabela 42: Numri i doktoreve, infermiereve dhe bashkëpuntorëve profesional*

| | |
|---|---|
| Doktor (mjek të përgjithëshem, mjek specialist) | 39 |
| Doktor (Stomatolog, Radiolog) | 6 |
| Infermier | 101 |
| Bashkëpunëtorë profesional | 27 |
| Totali | 173 |

Në kuadër të DSHMS-së funksionon edhe Qendra për punë sociale e cila posedon 14 zyrtar me dy sektore: Sektorin e Shërbimeve Sociale si dhe Sekorin e Asistencës sociale.

**Kreu IV**

# 4. Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut

## 4.1. Rrjeti rrugor në Gllogoc

Pozita Gjeografike e Komunës së Gllogocit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor, të cilat ndihmoj në zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Në komunën e Gllogocit ekzistojn katër nivele të kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato lokale.

Rrjeti i rrugëve në komunën e Gllogocit për bëhet nga:

- Autoudhë
- Rrugët Magjistrale Prishtinë – Pejë
- Rrugë regjionale. Komoran-Gllogoc-Skenderaj që lidhë pjesën veriore të Kosovës dhe Komoran-Grykë e Carralevës që lidhë Gllogocin me pjesën Jug-perendimore të Kosovës.
- Rrugë lokale.

Rrugët të cilat i lidhin 35 zona kadastrale

*Tabela 43: Rrjeti i rrugëve në Komunen e Gllogocit*

| Nr | Përshkrimi | Gjatësia në km |
|---|---|---|
| 1. | Autoudhë | 2.78 |
| 2. | Rrugë magjistrale | 19.53 |
| 3. | Rrugë regjionale | 35.4 |
| 4. | Rrugë lokale | 512.5 |
| Totali | | **570.21 km’** |

Gjendja e rrugëve në Komunën e Gllogocit - nga të gjitha rrugët të cilat e përbëjnë edhe rrjetin e rrugëve të komunës me gjatësi prej 570.21 km’, prej tyre autoudhë janë 2.78 km, rrugë magjistrale janë 19.53 km, rrugë regjionale 35.4 km’, rrugë lokale 512.5 km’. Tri kategoritë e para të rrjetit të rrugëve janë të asfaltuara dhe mirëmbahen nga Ministria eInfrastrukturës ndërsa kategoria e katërt mirëmbahet nga

Komuna e Gllogocit. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara të këtyre kategorive në komunën e Gllogocit është 335.22km’. Numri i automjeteve që qarkullojnë në teritorin e komunës së Gllogocit brenda 24 orëve është mjaft i lartë Sipas matjeve të fundit që janë bërë qarkullojnë afërsisht 30 automjete për /minut në teritorin tonë.

## 4.2. Siguria në trafik

Vlerësimi i sigurisë në trafik në rrugët kryesore në Komunën e Gllogocit është e bazuar në analizën nga të dhënat e ofruara nga Statcioni Policor Gllogoc. Të dhënat janë të paraqitura për vitet 2022-2023 të cilat kanë për qëllim vlerësimin dhe trendin e ngjarjeve /aksidenteve rrugore si dhe pasojave sipas metodës krahasuese.

*Tabela 44: Krahasimi i aksidenteve për periudhën: Janar-Dhjetor 2022-2023 në Komunën e Gllogocit*

| Aksidente fatale | | | Persona të vdekur | | | Aksidente me lëndime | | | Persona të lënduar | | | Aksidente me dëme materiale | | | Gjithësejt: | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % |
| 6 | 6 | 0 | 8 | 6 | -25 | 223 | 279 | 25.1 | 522 | 576 | 10.4 | 262 | 308 | 17.5 | 491 | 593 | 20.7 |

*Figura 10: Harta e Infrastrukturës së Transportit*



Për kalimin dhe lidhjen e rrugëve kemi edhe ura për qarkullim në rrugët magjistrale, regjionale e lokale, dhe gjithësejt janë 77 ura

- Në rrugët magjistrale dhe regjionale të Gllogocit janë gjithësej 5 ura;
- Në rrugët lokale brenda teritorit të komunës sonë janë gjithësejt 72 ura.

## 4.3. Transporti Hekurudhor

Në teritorin e Komunës së Gllogocit përpos sistemit rrugor kalon edhe rrjeti hekurudhor që lidhë Prishtinën me qytetin e Pejës. Momentalisht gjatë vitit 2021-2022, në këtë segment të hekurudhës qarkullon treni vetëm katër here në ditë në relacionin Prishtinë – Pejë, për transportin e banorëve, po ashtu përdoret edhe për transportin e mallrave për nevojat e sektorit publik dhe privat. Mirëmbajtja e hekurudhave është në nivel të ultë, ato po dëmtohen nga mbikalimet e pa autorizuara, nga ndërtimet ilegale në brezin hekurudhor dhe hedhja e mbeturinave në afërsi të tyre.

Komuna e Gllogocit posedon edhe tunele që janë:

- **Tuneli i Baicës 1050 mˈ dhe**
- **Tuneli i Çikatovës së Vjetër 200 mˈ**

Stacioni më i afërt hekurudhor nga komuna fqinjë është në teritorin e Klinës në largësin afërsisht 20 km.

*Figura 11: Rrjeti i hekurudhor në Komunën e Gllogocit*




## 4.4.Transporti Ajror/ Aeroportet

Komuna e Gllogocit nuk posedon aeroport civil për fluturimin e udhëtarëve , por vetëm një aeroport bujqësor i cili ka qenë i ndërtuar në fshatin Korroticë e Ulët, dhe përdoret për qëllime bujqësore. Nga

aeroporti i  Prishtinës qytetarët udhëtojnë në destinacione të ndryshme në botë që mundësohet nga aviokompani të ndryshme.

Numri i fluturimeve të realizuara nga aeroporti i Prishtinës, per vitin 2021 ishte 4157, ndërkaq numri i udhëtarëve (vajtje – ardhje) ishte 840,000 udhëtarë në vit. Numri i fluturimeve dhe udhëtarve mund të ndryshoj nga viti në vit.

Në Kosovë sot ekziston aeroporti civil në Sllatinë afër Prishtinës, aeroporti ushtarak afër Gjakovës si dhe 12 fusha ajrore - aerodrome bujqësore të Avio Kosovës si dhe një fushëajrore e Federatës Aeronautike të Kosovës në Dumosh. Shumë prej aerodromeve bujqësore janë në gjendje të keqe fizike dhe pa përkujdesje. Transporti ajror i udhëtarëve për në vendet e huaja bëhet përmes aeroportit ndërkomëtar të Prishtinës,

Komuna e Gllogocit ka afër aeroportin ndërkombëtar“**Adem Jashari** “në Sllatinë dhe largësia është afërsisht 20 km, që shërben si pikë strategjike për ndërlidhje me botë në aspektin e shkëmbimit të mallrave dhe njerëzve.

## 4.5.Sistemi  energjetikë ( objektet dhe sistemet)

Në Komunën e Gllogocit është i ndërtuar nënstacioni( NS) ku janë instaluara, dy transformator me fuqi 2x40 MVA (megavat) të furnizuar nga linja (TL)- 220/110 Kv, dhe me linjen (TM)- 35 kV nga Kosova A, po ashtu është i vendosur në Parkun e Biznesit edhe Nënstacioni 35/10 kV me fuqi të instaluar 2x8 MVA (megavat) dhe ekziston edhe linja 35 KV (si mundësi alternative për funizim ) nga Magura në Park të Biznesit. Kapacitetet instaluese energjetike në Gllogoc, mund të furnizoj edhe dyfishin e numrit të banoreve që ka sot Gllogoci.

*Tabela 45: Tregon kV,gjatësin në  km, si dhe llojin e shtyllave të vendosura në teritorin e Gllogocit*

| Rrjeti | Fuqia në KV | Gjatësia | Lloji i materialit të  shtyllave |
|---|---|---|---|
| Rrjeti | 220/110 kV | 3.2 km | Metalike të tensionit të lart (TL) |
| Rrjeti | 35 kV | 55 km | Metalike dhe të betonit |
| Rrjeti | 10 kV | 160 km | Nga betoni, druri dhe metali |
| Rrjeti | 0,4 kV | 450 km | Nga betoni dhe druri |

Trafostacionet e regjistruara në Komunën e Gllogocit me fuqi të ndryshme janë të paraqitura në pjesën e poshtme në formë tabelare.

*Tabela 46:  Tregon fuqin dhe sasin e trafostacioneve*

| LLoji | Kapciteti Linjës (Kv) | Fuqia e Transformatorit (MVA,KVA) | Sasia |
|---|---|---|---|
| Trafostacione | 220/110 kV | 40 MVA | 2 |
| Trafostacione | 35/10 kV | 8 MVA | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 1000 kVA | 11 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 630 kVA | 22 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 400 kVA | 29 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 250 kVA | 75 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 160 kVA | 52 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 100 kVA | 32 |
| Trafostacione | 10/0,4 kV | 50 kVA | 15 |
| Totali | | | 240 |

Energjetika në kushtet bashkëkohore është një resurs i pazëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive të tjera, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe të mirëqenies sociale në përgjithësi. Sot, sektori energjetikë është në gjendje të bëjë furnizim me energji elektrike 24h, për të gjitha bizneset dhe konsumatorët shtëpiakë në teritorin e komunës së Gllogocit

*Figura 12: Harta e Shtrirjës së Rrjetit Energjetikë dhe Telekomunikacionit*



### 4.6. Sistemet e tele-komunikimit

Në Gllogoc ekzistojnë dy objekte të postës për telefoninë fikse, dhe atë në Gllogoc dhe Komoran.

Tërë territori i Komunës është i mbuluar edhe me rrejtin e telefonisë mobile nga të dy operatorët dhe atë të Valës 900 dhe IPKO-së. Konkurenca në këtë lëmi, ka mundësuar shërbime më cilësore dhe çmime relativisht të arsyeshme.

Në telefonin fikse janë bërë investime të reja duke bërë zgjerimin e rrjetit në drejtim të Komoranit dmth në: Sankoc, Kishnarek, Zabel, Korroticë. Sot ekzistojnë rreth 25 mijë para pagues të telefonisë fikse, kurse mbi 30 mijë parapagues të telefonis mobile (Operatori Vala dhe Ipko). Po ashtu Platforma; Kujtesa dhe Art Motion, kanë bërë zgjerimin e rrjetit të internetit stabil të shpejt dhe efikas pa ndërprerje e cila ka bërë përparime të dukshme duke ofruar edhe platforma televizive dhe internet të shpejt.

*Tabela 47: Operatoret e telefonise mobile dhe internetit*

| Nr. | Institucioni | Tel. kontaktues | Adresa elektronike |
|---|---|---|---|
| **1** | **PTK** | **038/ 585 555** | info@kosovotelecom.com |
| **2** | **IPKO** | **038/ 700 700** | info@ipko.com |
| **3** | **Kujtesa** | **080040040** | hello@kujtesa.com |
| **4** | **Art Motion** | **080020600** | info@artmotion.com |

### 4.6.1. TV dhe radiostacionet

*Tabela 48: Radiostacionet ne Komunen e Gllogocit*

| Transmetuesi | Indeksi | Frekuenca | Drejtor | Adresa | Tel | Email |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Capital FM** | | 92.1 | / | Gllogoc | / | / |

### 4.7.Sistemet hidro-teknike

Banorët e Komunës së Gllogocit furnizohen me ujë të pijës nga rrjeti i ujësjellësit ekzistues të qytetit, nga rrjeti i ujësjellësit nëpër fshatra që furnizohen nga burimet alternative si dhe nga puset private në mënyrë individuale.

Një pjesë e madhe e teritorit të Komunës kryesisht qyteti i Gllogocit me lagjet përreth , pjesa tjetër urbane që përfshinë zonën e Komoranit-qendra dhe disa fshatra përreth saj furnizohen nga Ujësjellësi Rajonal i Prishtinës (KUR-Prishtina) NJOU në Gllogoc që kryesisht furnizohet nga pellgu i Ibrit përmes kanalit të hapur gjer në Bivolak dhe përmes gypit te mbyllur vjen deri në rezervuarët që janë në fabrikën e ujit në Qikatovë të Vjetër afer Feronikelit dhe aty bëhet prodhimi, përpunimi i ujit dhe në fund shpërndarja në rrjetin e ujësjellësit . Për nga numri i banorëve ne këto vendbanime, rezulton që rrjeti i ujësjellës shpërndahet dhe i shërben 29,792 banore apo 44.6%, dhe pjesërisht kane qasje 6,481 banore apo 11.1%, kurse pjesa tjeter shumë shpejt do të furnizohen me ujë.

`

Gypat e ujit që kanë furnizuar banorët e qytetit kanë qenë prej materialit të azbestit e që përbënte rrezik shumë të madh për shëndetin e njerëzve, ndërsa me një projekt nga KUR "Prishtina" është bërë ndrrimi i tyre me gypa polietilen me diametër sipas nevojave të kërkuara me projekt.

Kapaciteti i fabrikës për prodhimin e ujit është 150-180 l/s, nga 2 (dy) rezervuar në kuadër të fabrikës .

1. Rezervuaret për deponim te ujit me kapacitet (2x2500) 5000m³ i papërpunuar,
2. Rezervuari për deponim për ujin e pijes me kapacitet 1000m³ i përpunuar,
3. Rezervuari për deponim për ujin e pijes me kapacitet 500m³, i përpunuar,
4. Rezervuari për deponim për ujin e pijes me kapacitet 500m³ i përpunuar Komoran dhe Zabel i Eperm.

### *4.7.1.Objektet për furnizim me ujë*

**Procesi teknologjik i furnizimit me uji kryhet nga objektet:**

1. Një Stacion i pompave në Bivolak (furnizon me ujë industrin e feronikelit dhe fabrikën për përpunim të ujit;
2. Një Fabrikë për përpunim të ujit;
3. Pesë Stacionet e pompimit për zona te caktuara Gllogoc, Qikatovë e vjeter dhe Komoran;
4. Rezervuaret në Gllogoc dhe Komoran si dhe në Kamenicë

Qytetarët e Komunës së Gllogocit furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi i qytetit, ujësjellësit lokal dhe puset.

Ujërat në Gllogoc shfrytëzohen për pije, për furnizim të industrisë, ujitje, etj.

Gllogoci bën pjesë në rajonet me sasi të limituara të resurseve ujore .

Ujësjellësi kryesor që furnizon banorët e Gllogocit është Bazeni që gjendet në afërsi të Feronikelit dhe burimit të fshatit Krajkovë.

Rezervat e ujit në Komunë u shtuan me lëshimin në funksionim të sistemit "Ibër-Lepenc"

*Figura 13 : Harta e zonave me Ujësjellës në Komunën e Gllogocit*



### *4.7.2. Korporata rajonale e ujërave ( KRU) dhe burimet alternative*

K.R.U "Prishtina" Sh.A. përkatësisht NJOU operon dhe mirëmbanë rrjetin e Ujësjellësit në Komunën e Gllogocit, aktualisht, KRU “Prishtina” Sh. A. – NJOU në Gllogoc është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën tonë, e cila ofron shërbime për pjesën e qytetit dhe fshatrave te cilat furnizohen nga burimet e Ujmanit Kapacitetet të prodhimit të ujit (kapacitetet e shfrytëzuara) janë premtuese për nevojat e shpenzimeve nga qytetarët, ku koha e furnizimit me ujë të pijshëm në rastin më të mirë është 24 orë( me reduktime sezonale). Edhe pse me shumë përpjekje akoma, kjo kompani nuk ka arritur që të shtrijë rrjetin e shërbimeve në të gjitha vendbanimet rurale të komunës sonë.

Furnizimi përmes sistemit rajonal të KRU "Prishtina" NJOU në Gllogoc.

Aktualisht, përmes rrjetit të shpërndarjes që menaxhohet nga KRU “Prishtina”,përkatesisht NJOU në Gllogoc me burim ujor ekskluzivisht nga Liqeni i Ujmanit, furnizohen me ujë të pijshëm këto zona:

Qyteti i Gllogocit, Çikatova e Re, Shtutbullova, Gllobar, Çikatova e Vjetër, Gllanasella, Komorani I, II, III, Zabeli i Lartë, Pokleki i Vjeter, Pokleki i Ri, Vërboci, Shtuica, Polluzha, Korrotica e Ultë, Zabeli i Ulët dhe Tersteniku I dhe II.

Të gjitha këto vendbanime janë të lidhura me rrjetin primar dhe sekondar të ujësjellësit dhe përfitojnë furnizim të rregullt nga sistemi qendror.

Fshati Sankoc furnizohet me ujë nga një burim lokal në territorin e vet, mirëpo menaxhimi, mirëmbajtja dhe shpërndarja e këtij burimi bëhet nga KRU “Prishtina”, NJOU në Gllogoc ashtu si me zonat tjera të mbuluara nga rrjeti qendror. Ky burim është i integruar në sistemin e rrjetit për qëllime operative dhe monitorimi.

Fshatrat në proces të përfshirjes në rrjetin e ujësjellësit:

Aktualisht janë në proces të planifikimit dhe zbatimit të projekteve për furnizim me uji në këto fshatra:

Baica, Dobrosheci, Godanci, Likoshani,

**Gjendja e rrjetit të furnizimit:**

Në zonat e mbuluara, rrjeti ka një moshë mesatare mbi 10 vjet, me nevojë për investime të vazhdueshme në mirëmbajtje dhe zëvendësim të infrastrukturës së amortizuar.

Në disa zona periferike, kapaciteti i rrjetit është i kufizuar për shkak të mungesës së presionit të mjaftueshëm apo mungesës së linjave sekondare.

Ka nevojë për zgjerim të rrjetit të hidrantëve dhe pikave teknike të kontrollit, në veçanti për nevoja emergjente dhe zjarrfikëse.

### *4.7.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije*

**1. Rrjeti i furnizimit me ujë**

Rrjeti primar përfshin gypat kryesorë të transportimit të ujit nga stacionet e pompimit Bivolak deri në qendren e përpunimit te ujit ( fabrika për trajtim te ujit) e shpërndarjes brenda vendbanimeve.

Rrjeti sekondar përfshin degëzimet që e shpërndajnë ujin brenda zonave të banimit.

`

Hidrantët publikë janë të instaluar në disa pika të caktuara për nevoja të mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave, por jo në nivelin sipas nevojave, andaj komuna se bashku me KRU”Prishtina”, duhet të investojn në instalimin e Hidrantve në ato lokacione(fshatra) ku është i shtrir sistemi i Ujësjellësit, sepaku në bashkësit lokale.

**2. Stacionet e pompimit**

Në territorin e Komunës së Gllogocit operojnë ( pesë) 5 stacione të pompimit, të cilat shërbejnë për ngritjen e ujit në zonat me lartësi të ndryshme gjeografike. Këto stacione janë të lidhura me sistemin SCADA për monitorim dhe menaxhim efikas.

**3. Mbulueshmëria në terren**

Sistemi i ujësjellësit aktualisht mbulon rreth  40 % të territorit të komunës dhe 59.18% të popullsisë së përgjithshme. Pjesa tjetër e popullsisë furnizohet me burime alternative (puseta private, burime lokale, cisterna etj.).

- Numri i përgjithshëm i konsumit mujor 250,000 $m^3$ /muaj, ku prej tyre shpenzime të amvisërisë janë 211,000 $m^3$ /muaj apo 84.4 %, Institucione publike shpenzimet arrin në 14,500 $m^3$ /muaj apo 9.8% dhe shpenzimet në sketorin komercial arrin 24,500 $m^3$ /muaj apo 5.8% .

*Figura 14:  Harta e Shtrirjës së Rrjetit të Ujitjës dhe Ujësjellësit*



### 4.7.4. Monitorimi i ujërave për pije

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike.Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësorë konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHP është institucion i ngarkuar me përgjegjësi ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm. IKSHP siguron se uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendorë për parametrat mikrobiologjikdhe fiziko-kimik. Gjatë vitit 2023, janë marrë 416[2] mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, në të cilën 100%të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara. Ndërsa në vitin 2024 janë marrë 432. mostra të ujit nga rubinetet e me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik në të cilën 100%të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara.

*Tabela 49: Norma (100%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-Prishtina 2023/2024*

| *Parametrat:* | *Viti* | *KRU " Prishtina "* | |
|---|---|---|---|
| | | *Mostrat /numri* | *Vlera mesatare* |
| *Mikro-biologjike* | *2023* | *156+52 uji I papërpunuar* | *%* |
| | *2024* | *162+54 uji I papërpunuar* | *%* |
| *Fiziko-kimike* | *2023* | *156+52 uji I papërpunuar* | *%* |
| | *2024* | *162+54 uji I papërpunuar* | *%* |
| *Mesatarja për KRU* | *2023* | *208* | *%* |
| | *2024* | *216* | *%* |

### 4.7.5.Rrjeti i sistemit të kanalizimit

Sistemi i kanalizimit është i tipit të ndarë. Si në ç'do vend në Kosovë edhe në Komunën e Gllogocit rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terrenit. Rrjeti është i shpërndarë nëpër pika të caktuara të lagjeve dhe fshatrave. Megjithatë, një numer i vogël i familjeve nuk janë kyçur në kanalizim, shkaku i kostos që ka ardhur nga distanca e madhe mes shtëpive, pra nga shpërndarja e shtëpive pa ndonjë rregullim adekuat të planifikuar.

Shumica e teritorit të Komunës së Gllogocit deri pas luftës nuk ka qenë e përfshirë në rrjetin e kanalizimit fekal përveq qendrës së qytetit e cila poashtu ka qenë e përfshirë edhe me kanalizim atmosferik . Rrjeti ekzistues i kanalizimeve nuk kanë kapacitete të mjaftueshm për shkarkim, sidomos në qendren e qytetit , për shkak të ndërtimeve të larta që janë në ndërtim e sipër.

[2] Shenimet janë marrë nga KRU "Prishtina" Njesia në Drenas

Rrjeti i kanalizimit atmosferik është ndërtuar pas atij fekal për arsye se ka qenë e organizuar në drejtim të rrjetit hidrografik që gjendet në Komunën e Gllogovcit. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është komplet i orientuar në drejtim të Lumit Drenica dhe përroskave tjera siç është ajo e Verbocit. Gypat janë nga Betoni, PVC etj. me dimensione të ndryshme.

Ky rrjet kryesisht është i punuar me gypa PVC me diametër të ndryshëm sipas projektit ,ndërsa kemi disa pjesë që janë të punuara edhe me gypa betoni . Kryesisht këto rrjete përfundojnë  në pika të caktuara ku edhe janë të punuara gropat septike, por, këto tash më janë eleminuar  dhe  rrejti i kanalizimit fekal  është i lidhur  përmes kolektorëve kryesor që shtrihen përgjat brigjeve të lumit Drenica dhe Vërbica dhe  deri tek lokacioni për impiantin e pastrimit të ujërave të zeza që me Planin Zhvillimor Komunal është paraparë të ndërtohet  në fshatin Dobroshec, mirëpo duhet të shikohen edhe mundësit për ndërtimin e Imianteve me të vogala ku përdshihet deri në 10,000 mijë banor.

*Tabela 50 : Kanalizimet fekale dhe atmosferike.*

| | | |
|---|---|---|
| Kanalizim | Gjatësi | 456.2 km |
| Gropa Septike | Vëllimi | / |
| Kanalizim atmosferik | Gjatësi | 4.634km |

*Figura 15 Harta e planit të Ujësjellsit dhe Kanalizimit*



### *4.7.6. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nënëtokësor*

Në shumicen e vendbanimeve të gjitha ujërat e kanalizimit, pa trajtim paraprak, shkarkohen në rrjedhat e Lumit Drenica dhe në këtë mënyrë shkaktojnë ndotje të lumit, tokës dhe sigurisht edhe ujërave nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës dhe për mjedisin në tërësi.

Ndotja e ujërave, si sipërfaqësorë ashtu edhe nëntokësorë, paraqet një ndër sfidat më të mëdha mjedisore në Komunën e Gllogocit. Ky problem është i vazhdueshëm dhe ende i pazgjidhur në mënyrë të plotë, për shkak të burimeve të shumta ndotëse dhe mungesës së infrastrukturës/**impianteve**/ për trajtimit të ujrave fekele.

**Burimet kryesore të ndotjes:**

Hedhja ilegale e mbeturinave urbane nëpër përrocka, lumenj dhe ambiente të hapura.

Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak në rrjetet natyrore ujore;

Mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe prishja e objekteve, të cilat grumbullohen në mënyrë jo të kontrollua;

Mbeturinat industriale nga bizneset dhe zonat industriale, përfshirë edhe mbetjet nga industria e rëndë (metale, kimikate);

Mbeturinat e automjeteve të vjetra, dhe derdhja e vajrave;

Mbeturinat spitalore dhe të klinikave, të cilat, për shkak të mungesës së trajtuesve të specializuar në nivel lokal dhe kombëtar, paraqesin rrezik serioz për shëndetin publik dhe mjedisin ku në komunën e Gllogocit këto mbeturina nuk hudhen por grumbullohen përmesë kompanis se kontraktuara nga komuna, ku sasia e tyre është: **Mbeturina mjekësore – 2,743.00 kg/v;**

Mbeturinat shtëpiake dhe ato nga jeta e përditshme, të cilat, në mungesë të menaxhimit efikas dhe deponimit të duhur, ndikojnë drejtpërdrejt në ndotjen e ujërave, sidomos gjatë reshjeve ose përmbytjeve dhe sasia vjetore e grumbullimit të tyre sillet rreth: **Mbeturina shtëpiake – 6,841.58 ton/v.**

**Vlerësimi i ndikimit**

Ujërat sipërfaqësore, sidomos lumi Drenica dhe përrenjtë përreth, janë më të ekspozuar ndaj ndotjes së drejtpërdrejtë nga deponitë ilegale dhe rrjedhjet e ujërave të kanalizimit.

Ndikimi negativ është më i theksuar në afërsi të vendbanimeve të mëdha dhe zonave industriale si: zona industriale në Gllogoc, fshatrat me densitet më të lartë të popullsisë dhe zona pa mbulim të rrjetit të kanalizimit.

*Figura 16: Harta e planit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Reciklim*




### *4.7.8.Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit*

Masat që duhet ndërmarrë për parandalimin e ndotjës së ujërave janë të shumta, por do të adresohen disa që janë më kryesore;

- Parandalimin e ndotjës së burimeve ujore;
- Identifikohen të gjithë ndotësit potencial të ujërave;
- Të mirren masat për parandalimin dhe penalizimin e tyre nga Inspektorët përgjegjës;
- Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të ndotura;
- Trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet normative vendore;
- Shmangje nga çfardo lloj shkarkimi të pesticideve, vajrave dhe kemikateve të rrezikshme në ujëra;
- Ndalimi i hudhjes së mbeturinave afër çdo burimi të ujërave, etj;

### *4.7.8.Rekomandimet*

- Implementimi i infrastrukturës ligjore të ujërave;
- Kompletimi dhe modernizimi i sistemit për monitorimin e cilësisë së ujëravesipërfaqësor dhe nëntokësor;

- Nevoja për investime kapitale në infrastukturën për trajtimin e ujërave urbane;
- Rritja e kapaciteteve dhe avansimi i sistemit të ujësjellësve;
- Përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit për trajtimin e ujërave urbane dhe industriale;
- Masat për parandalimin e humbjës së ujërave në rrjet;
- Hulumtime në fushën e ujërave, s idomos resurseve ujore nëntokësore;
- Ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore;
- Ngritja e vetdijësimit në komunitetin e biznesit dhe ekonomive familjarepër shfrytëzimin racional të ujërave;
- Në raste si vërshimet, ndotje, ose mungesë uji, **komuna duhet të dijë saktë ku gjenden burimet** për të ndërhyrë ose mobilizuar ujë alternativë për qytetarët.
- Në këtë plan Vlerësimit të Rrezikut është **jetike** që të dihen:
    - Vendndodhja e burimeve.
    - Kapaciteti i tyre.
    - Statusi ligjor (privat apo publik).
    - Përdoruesit (banorë, biznese, etj.);
    - Pa këtë informacion, komuna nuk mund të japë leje ndërtimore dhe duhet të parandalojë ndotjen e burimeve nga veprimtarit ekonomike të cilat nga prodhimi i tyre mund të ndotin ujin.
- Burimet private mund të ndikojnë në rrjedhën ose sasinë e burimeve publike — ndaj duhen mbikëqyrur;
- Vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave.

## 4.8. Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës

### *4.8.1. Pompat e derivateve*

Në territorin e Komunës së Gllogocit, në qendren urbane dhe periferike si dhe në vendbanimet në pjesën rurale të komunës, janë të evidentuara 32 pika të shitjes së karburanteve të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë shumica përgjat akseve rrugore urbane dhe rurale.

### *4.8.2.Gjendja e deponive të karburanteve*

Në Gllogoc nuk ka burime të naftës dhe gazit që do të mund të shfrytëzoheshin, prandaj nuk ka edhe rrjetë të tyre dhe as deponi të tjera, të cilat shkallën e rrezikshmërisë e kanë të lartë, përveç pikave të shitjes së karburanteve.

Pas vizitave në pikat e karburantit janë konstatuar se gjendja me pajisje kundërzjarrit është e mirë pasi që çdo objekt qe ushtron këtë biznes është i pajisur me paisje për mbrojtje nga zjarri, të dhëna për stafin se sa janë të çertifikuar/trajnuar/ për shuarjen e zjarrit nuk i kemi të siguruara.

*Tabela 51: Pompat e derivateve në Komunën e Drenasit*

| Nr | Kompania | Vëndi | Pronari | Sektori | kapaciteti L |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fer Petrol | Terstenik | Mehdi Gjoka | Privat | 3x25000 lit n/b |
| | | | | | 1x8000 lit b/p |
| 2 | Fer Petrol | Gllobar | Mehdi Gjoka | Privat | 3x25000 lit n/b |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1x8000 lit b/p |
| 3 | Fer Petrol | Komoran | Mehdi Gjoka | Privat | 3x31000 lit n/b |
| | | | | | 1x6000 lit b/p |
| 4 | ,, ATC” | Gllogoc | Avdi Morina | Privat | 2x20000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 5 | ,,Shell” | Gllogoc | Arbën Kryeziu | Privat | 4x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x6000 lit b/p |
| 6 | ,,Ip-Petrol’’ | Poklek i Ri | Visar Lajqi | Privat | 2x40000 lit n/b |
| | | | | | 1x6000 lit b/p |
| 7 | ,,Alfa Company’’ | Poklek i Ri | Musa Hajdari | Privat | 3x50000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 8 | ,,Sllovenija Petrol’’ | Komoran | Nazmi Bytyqi | Privat | 2x42000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 9 | ,,Shell” | Komoran | Arbër Kryeziu | Privat | 4x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x6000 lit b/p |
| 10 | ,,H-Petrol’’ | Llapushnik | Haxhi Telaku | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 11 | ,,Bes Oyl’’ | Komoran | Besim Bujupi | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | 1x6000 lit b/p |
| 12 | ,,D.H.F’’ | Komoran | Hisen Jusaj | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 13 | ,,Ex Fis’’ | Komoran | Isa Muharremi | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 14 | ,,Te Luta ‘’ | Gllansellë | Besim Berisha | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 15 | ‘’Veda 2 Petrol,, | Sankoc – Krivov | Dashnim Miftari | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1X8000 lit b/p |
| 16 | ,,Ip-Kos-Sh.p.k,, | Gllogoc | Visar Lajqi | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 17 | ,,Al Petrol-Sh.p.k’’ | Gllogoc | Latif Resuli | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 18 | ,, Al Petrol-Sh.p.k‘’ | Zabelë i Epërm | Latif Resuli | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 19 | ,,Al Petrol-Sh.p.k‘’ | Llapushnik | Latif Resuli | Privat | 2x45000 lit n/b |
| 20 | ,,Alfa Company’’ | Terstenik | Musa Hajdari | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 21 | ,,Butrinti Petrol’’ | Komoran | Bujar Zogaj | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 22 | ,,Ip-Petrol ‘’ | Komoran | Visar Lajqi | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 23 | ,,Kastrati Petrol ‘’ | Komoran | Kushtrim Kastrati | Privat | 2x45000 lit n/b |
| 24 | ‘’Ar Benz,, | Komoran | Milaim Zogu | Privat | 2x15000 lit n/b |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1X8000 lit b/p |
| 25 | ,,Kabashi Petrol,, | Çikatovë e Re | Ismet Kabashi | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 26 | ,,Benita Corporation’’ | Korroticë e Epërme | Nexhat Kalludra | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 27 | ,,Hib Petrol ‘’ | Llapushnik | Kujtim Bucalia | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 28 | ,,Rreze K‘’ | Polluzhë | | Privat | 2x45000 lit n/b |
| 29 | ,,Exfis’’ | Korroticë e Epërme | Lum Muharremi | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 30 | ,,Exfis’’ | Llapushnikë | Lum Muharremi | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 31 | ,,Ip Kos Sh.p.k ‘’ | Arllat | | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 32 | ,,Petrol Company ‘’ | Arllat | Shkelzen Jusaj | Privat | 2x45000 lit n/b |

## *KREU i V-të*

## *5.Objektet e rëndësisë së veçantë*

Sikur edhe Komunat tjera edhe Komuna e Gllogocit nuk bën përjashtim ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri, qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme, andaj edhe objektet e rëndësisë së veqantë kanë rol dhe rëndësi jetike në paqë dhe në rrethana të krijuara nga FNFT.

### 1. Objektet e sigurisë në Komunën e Gllogocit

Sikur edhe komunat tjera edhe Komuna e Gllogocit nuk bën përjashtim ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri, qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme. Objekte të karakterit të tillë në komunën tonë janë:

- Objektet e Administratës civile komunale dhe shërbimet publike;
- Objektet shëndetësore si: QKMF-ja , QMF-të dhe AMF-të në Komunën e Gllogocit;
- Objektet e shërbimeve postare dhe telekomit;
- Qendra për punë sociale;
- Qendra për Punësim;
- Qendra e Regjistrimit të Automjeteve (QRA);
- Qendra e Regjistrimit Civil (QRC);
- Stacioni Policor në qytetit Gllogocit dhe 1 nënstacion i policisë në Komoran;
- Objekti i Gjykatës;
- Objektet e Komunitetit (Komoran, Terstenik, Arllat, Dobroshec, Abri);
- Objekti i Zjarrfikësve;

- Stacioni i Trenit;
- Stacioni i Autobusave;
- Nënstatcioni energjetikë;
- Objektet shkollore;
- Objektet sportive;
- Objektet kulturore dhe Arkeologjike;
- Objektet e KRU "PRISHTINA" & KRM "PASTRIMI" etj.

*Harta 17 Lokacionet e objekteve të rëndësis të veqant*




## *3. Institucionet dhe shërbimet financiare*

Në Komunën e Gllogocit kemi edhe objektet të bankave komerciale si: Rafaissen Bank, Pro Credit Bank, NLB, TEB, BKT, BBP, Banka ekonomike, Mikrobankat si: FINCA, Banka Buqësore, Banka Kreditore etj, si dhe kemi edhe 4 filala të sigurmieve të automjeteve se bashku me Objektet i Kontrollit teknik.

## *4. Objektet shkollore në komunën e Gllogocit*

Komuna e Gllogocit posedon këto institucione arsimore:

- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 3 objekte parashkollore (çerdhe), me 31 objekte të shkollave Fillore të Mesme të Ulëta dhe me 2 objekte / shkolla të Mesme të Larta.

*Figura 17: Institucionet arsimore në Komunen e Gllogocit*




## *KREU VI-të*

## *5. LLOJET E FATKEQËSIVE*

Fatkeqësitë, varësisht nga shkaktari i tyre ndahen në: fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera(FNFT);

**Fatkeqësitë Natyrore** janë fenomene natyrore të cilat, varësisht nga efekti goditës mund të shkaktojnë humbje me pasoja në popullatë, në të mira materiale, mjedis dhe trashëgimi kulturore.
Ndryshimet klimatike në përgjithësi, veçanërisht frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit dhe luhatjet e temperaturave që parashikohen të ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, po ndikojnë edhe tek ne, duke krijuar klimë me cenueshmëri më të lartë, duke përfshirë, ndër të tjera: zjarret pyjore dhe fushore, Zjarret në objekte banimi, thatësirat, reshjet e dendura të shiut me shtrëngata, breshëri, bora, acari , orteqet, erërat, vërshimet, epidemitë/pandemitë, rrëshqitjet e tokës, valët e të nxehtit, Tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore, etj;
Institucionet tona në nivel lokal si dhe akterë tjerë jo-qeveritar, duhet të kemi një përkushtim më të madh në zhvillimin e masave parandaluese me qëllim të vlerësimit të rreziqeve natyrore si dhe zvogëlimit të tyre për të arritur një qasje më proaktive për mbrojtje nga fatkeqësitë.

**Fatkeqësi tjera** nënkuptohen ato fatkeqësi tekniko-teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri apo përmes proceseve teknologjike /incidentet në objektet afariste, tregtare, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidente në trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidentet nukleare si dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, veprimet luftarake dhe terroriste;

## 6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive natyrore

Secila nga fatkeqësitë apo fenomenet natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri kanë natyralitetin e ndryshëm të ngjarjes, të shkasit dhe pasojes, ashtuqë edhe identifikimi, analizimi, trajtimi dhe vlerësimi i tyre bëhet sipas specifikave dhe efekteve goditëse të tyre.

Pika fillestare për vlerësimin e ndikimit janë pasojat, shumëllojshmëria e gjerë e pasojave të ndryshme përmblidhet në një parametër, të quajtur 'ndikim'. Ndikimi është një mbledhës apo grumbullues I informacioneve mbi pasojat, prandaj për vlerësimin e rrezikut, mund të përdorim disa kritere të ndikimit: jeta dhe shëndeti i njeriut, mjedisi, funksionaliteti i shoqërisë, ekonomia, etj

Komuna e Gllogocit, sipas Informacioneve që kemi në disponim , si Fatëkeqësi Natyrore që me së shumti i'u është ekspozuar rreziqve janë:

- **Vërshimet,**
- **Zjarret Fushore dhe Malore,**
- **Zjarret në Objekte Industriale dhe prodhuese,**
- **Zjarret në Pompat e Derivateve të naftës,**
- **Epidemitë, Endemitë dhe Pandemitë,**

Ndërsa si rreziqe dytësore janë :

- **Breshëri,**
- **Tërmetet**
- **Erërat,**
- **Përmbytjet,**
- **Ortekët etj.**

## 6.2. Prioritizimi i fatkeqësive natyrore bazuar në matricën e rreziqeve

Vlerësimi i autoriteteve lokale për rreziqet e fatkeqësive natyrore bazohet në analizën e plotë të rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinjë. Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme për tu përballë me pasojat e fatkeqësive natyrore, duke e marrë për bazë edhe Profilin e rrezikut( fletë-pune e profilit të rrezikut);

Matrica e rrezikut pasqyron gërshetimin apo korelacionin e probabilitetit (gjasave ) dhe pasojave, të nivelit të rrezikut e cila përbëhet nga dy boshte:

- **boshti horizontal** në të cilin paraqiten vlerat e gjasave (***e sigurtë/ gati e mundur/ e besueshme/ e pa besueshme/ e pamundur***), ndërsa

- **boshti vertikal** në të cilin paraqiten vlerat e pasojave *(**e papërfillshme/ e vogel/ e mesme/ kritike/ katastrofike**);*

Secili bosht ka nga pesë vlera (fusha), ku gërshetimi i tyre jep një matricë prej 25 fushash ndërsa për ta realizuar shkallëzimin e rrezikut thjeshtë shumëzohet/gërshetohet gjasa me pasojat/ashpërsinë/ ku do të prodhojnë rezultatet/numrat nga 1 deri në 25 dhe bëhet kategorizimi si në tabelën në vijim për t'i nxjerr rreziqet e mbetura, ose rreziqet që mbesin pas vendosjes së masave të kontrollit;

**Prioritizimi i listës së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera** është produkt matrices së probabilitetit/gjasave. Matrica e probabiliteti/gjasave janë të bazuara në **treguesit e probabilitetit/gjasave**:

- Probabiliteti dhe frekuenca e ndodhjes;
- Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut;
- Pasojat ekonomike nga FNFT;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-infrastruktura kritike;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë;
- Matrica përmbledhëse e cila pasqyron stabilitetin shoqëror (3a dhe 3b/pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmet nga infrastruktura kritike dhe pasojave ekonomike);
- Matrica e cila pasqyron rrezikun e përgjithshëm;

## 6.3. Matrica e gjasave

| Shkalla e ashpërsisë | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)<br>nuk kërkohet veprim |

Gjasat

| Pasojat | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Katastrofike | 5 | 5 | 10 | 15 | 20 | 25 |
| Kritike | 4 | 4 | 8 | 12 | 16 | 20 |
| E mesme | 3 | 3 | 6 | 9 | 12 | 15 |
| E vogel | 2 | 2 | 4 | 6 | 8 | 10 |
| E papërfillshme | 1 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | E sigurt | Gati e mundur | E besushme | E pa besueshme | E pamundur |

## 6.4 Llogaritja e Rrezikut

Rreziku = Probabiliteti i ngjarjes(gjasa) * Pasojat e ngjarjes

Ku:

- **Probabiliteti** → sa e mundshme është që ngjarja të ndodhë,
- **Pasojat** → sa e madhe është dëmi ose ndikimi nëse ndodh ngjarja (p.sh. në para, jetë njerëzish, dëmtime etj.)

Në varësi të fushës, këto vlera mund të jenë numerike, të kategorizuara (ulët, mesatar, lartë), ose të kombinuara në tabela të rrezikut.

PSH: Për vershime

Në menaxhimin e fatkeqësive natyrore, **rreziku nga përmbytjet** zakonisht llogaritet me këtë formulë bazë:

**Rreziku nga përmbytjet**=Rrezikshmëria*Ekspozimi*Ndjeshmëria

◆ **1. Rrezikshmëria**

Tregon **sa e madhe është mundësia që të ndodhë përmbytja** dhe **me çfarë intensiteti**. Përfshin faktorë si:

- Shpeshtësia e reshjeve ekstreme (p.sh. 1 herë në 50 vjet)
- Lartësia e ujit gjatë përmbytjes (në metra)
- Koha e ekspozimit (sa gjatë qëndron uji)

**Matet** zakonisht si probabilitet ose nivel i rrezikut fizik (p.sh. ulët, mesatar, lartë).

---

◆ **2. Ekspozimi**

Tregon **çfarë ka në zonën e rrezikuar**:

- Popullsia që jeton aty
- Infrastrukturat (rrugë, ura, spitale, shkolla)
- Pasuritë materiale (shtëpi, toka bujqësore, etj.)

Matet si **vlerë monetare**, **numër njerëzish** ose **shtrirje gjeografike**.

---

◆ **3. Ndjeshmëria**

Tregon **sa e prekshme është ajo që është e ekspozuar**, pra sa lehtë dëmtohet:

- Cilësia e ndërtesave (a janë rezistente ndaj ujit)
- Sistemet e paralajmërimit
- Përgatitja e komunitetit (planet e evakuimit, etj.)

### ***6.5. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore***

Fatkeqësi natyrore konsiderohen fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri apo fenomene natyrore deri në nivele ekstreme, duke filluar nga ato me shpeshtësi më të madhe dhe me probabilitet të lartë të ndodhjes deri tek ato më ekstreme me pasoja të rënda dhe me probabilitet të ultë. Fatkeqësitë natyrore përbëjnë një listë të gjatë të fenomeneve natyrore , si : vërshimet, tërmetet, zjarret, rrëshqitjet e dheut dhe përmbytjet, ortekët, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësira, epidemitë dhe pandemitë, fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga natyra e dukuri tjera që ndikojnë në humbje të jetërave të njerëzve, të mirave materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

`

### *6.5.1. Vërshimet*

Territori i Komunës së Gllogocit bazuar në bazën e të dhënave egzistuese si dhe në të dhëna historike, ka një cenueshmëri dhe rrezik serioz nga vërshimet, tek shteretërit e limit Drenica dhe Verbica dhe hapësirat e rrafshëta, ku shkaktohen nga fryrja e lumenjëve (përrockave) dhe ngritja e nivelit të ujërave , gjatë të reshurave të reshurave të dendura apo shkrirjes së shpejtë të dëborës;

Pothuajse të gjitha Komunat e Kosovës janë të prekura nga rreziku i vërshimeve që ndodhin kryesisht pas stuhive në hapësirat malore, shirave të vazhdueshme, shkrirjes së borës si dhe në rastet kur brigjet e lumenjve degradohen nga shfrytëzimi i pakontrolluar i rërës dhe hedhjes së mbeturinave. Nëpër pjesët më të ulëta të territorit të Komunës së Gllogocit kalon lumi Drenica i cili me rastin e të reshurave të mëdha atmosferike del nga shtrati dhe shkakton dëme të konsiderueshme. Në bazë të statistikave prej vitit 2004 e deri në vitin 2025 kanë ndodhur pesë vërshimeme për masa të mëdha (në fund të shkurtit dhe fillim të marsit) ku janë shkaktuar dëme të mëdha në pronat bujqësore, infrastrukturë dhe objekte të banimit. Vendbanimet që ndodhen përgjatë një pjese të lumit Drenica si ato në Zabel të Ulët, Komoran, Qikatove e re, Shtrubullov , Verboc, Dobroshec, Fushticë e Poshtmë , Nekoc, Kizharek , Pokler I Ri, janë të rrezikuara nga vërshimet. Zona e rrezikuar nga vërshimet është paraqitur në në hartë. Sipërfaqja totale e rrezikuar nga përmbytjet është **264.61ha me 236 objekte.**

### *6.5.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;*

Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet është proces i cili duhet të fillojë që nga përcaktimi apo qartësimi i përmbajtjes së ekipit apo strukturës profesionale me qëllim të identifikimit të rreziqeve. Vetë procesi i identifikimit të rrezikut nga vërshimet është një aktivitet profesional dhe i spektrit të gjërë( shumë-disiplinarë) e cila ngërthen në vete një mori aspektesh dhe të fushave që mund të prekin dhe cenojnë: jetën e njeriut, sistemet e ndryshme, infrastrukturën, ekonominë, mjedisin, trashëgiminë kulturore, etj. Vërshimet dhe përmbytjet determinohen nga një mori faktorësh ndër të cilët dallojmë:

- Mos rregullimi i infrastrukturës së shtretërve të lumenjve ;
- Degradimi i shtretërve të lumenjve - gërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara i resurseve natyrore ,masës drunore në shtratin dhe përgjatë shtratit të lumenjve, duke inicuar vërshime, përmbytje të brigjeve të lumenjve.
- Ndërtimet e pa autorizuara afër shtretërve të lumenjëve me ç'rast paraqitet pas ngritjes se nivelit të ujit të lumenjëve mund të rrezikohen nga përmbytjet disa nga vendbanimet e caktuara si ,Qikatove e re, Shtrubullovë, Verboc, Dobroshec, Nekoc, Krojkovë etj.
- Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjëve,
- Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjëve, sidomos në pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.

*Figura 18: Harta e rrezikut nga vërshimet me probabailitet te ulët, popullsia e ndikuar*




## *6.5.3.Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshimeve*

Komuna e Gllogocit është e ndjeshme ndaj vërshimeve të shpeshta të cilat përfshijnë gati çdo vit vërshime të ekonomive familjare, bizneseve, duke përmbytur rreth *264.61ha* sipërfaqe fushore dhe duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Kushtet natyrore të Komunës se Gllogocit janë të tilla, ku pjesët e rrafshta të territorit janë të përshtatshme dhe me potencial për toka bujqësore dhe shtrirjen e vendbanimeve, vendosjen e industrisë, zhvillimin e infrastrukturës, ndërsa pjesët me lartësi më të madhe mbidetare qe shtrihen më në periferi, kushtëzon rrjedhjen e shpejt të ujërave dhe me kapacitete shpesh maksimale të ujë-rrjedhave lumore. Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që mund të dëmtojnë zona të mëdha të deltave lumore të lumenjve dhe të shkaktojnë vërshime rrëke në përrenj më të vegjël. Për më tepër, për shkak të ndryshimit të klimës, ndikimet e ashpra të vërshimeve mund të priten edhe në komunën tonë në të ardhmen.

## *6.5.4.Historiku i vërshimeve ( koha, hot-spotet/pikat e nxehta)*

Bazuar në të dhënat historike,Komuna e Gllogocit ka pasur vërshime të shpeshta, po thuaj se cdo vit , por me intezitete të ndryshme të vershimeve, dhe zonat më të rrezikuara janë : Shtrubullova, Qikatova e re,Nekoc, Kizharek, Dobroshec, Verboc, Zabel i Ulte, Poklek i ri, Polluzhë, Terstenik etj.

`

### 6.5.5. Vendet (vendbanimet) më të atakuara nga vërshimet /pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve

*Tabela 52: Të dhënat për vërshimet në në Komunën e Gllogocit*

| **Komuna e Gllogocit**<br>**Data /vitet 2021-2024** | **Lumi "Drenica " dhe Vërbica** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Lumi " Drenica"** | ***Përrojet e "E Lugut", në Nekoc, Kizharek dhe Shtrubullovë*** | **Lumi " Verbica"** | ***Përrojet "E lagjes Rrukiqi" në Verboc*** |
| Lokacioni i vërshimeve (Fshati , Nekoc-L.Gashi,L.Dugolli,L. Kastrati,Fshati Verboc-L. Rrukiqi, Gllareva, Prokshi, Bylykbashi, Dvorani, Qikatova e re, Shtrubullova, etj) | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ |
| *Profili/ numri i banorëve të përfshirë* **(**popullata)/evakuimi | **1067** | **356** | **216** | **10** |
| Sipërfaqja e vërshuar | **>25ha** | **>10 ha** | **<10 ha** | **<5ha** |
| Dëmet e shkaktuara në ekonomi familjare | **217,643.20€** | **52,510.68 €** | | |
| Dëmet e shkaktuara në biznese | **479,517.00€** | | | |
| Dëmet e shkaktuara në bujqësi | **6,738€** | **162,749.00€** | | |
| Infrastruktura kritike egzistuese | **1,705,000.00€** | | | |
| *Gatishmëria për reagim emergjent/ERE* | **Kanë reaguar Ekipet Emergjnete te SHZSH** | | | |
| *Ndikimi në natyrë dhe mjedis* | **Demtim të mbjellurave me kuktura vjeshtore dhe prnaverore** | | | |
| *Dëmet e shkaktuara në objektet e trashëgimisë kulturore* | **Nuk ka** | | | |
| Strehimorete përdorura /kapacitet | **Nuk janë përdor** | | | |

*Figura 19 Harta e vershimeve ne Komunen e Gllogocit*[3]




## 6.5.6. Kushtet hidro-meteorologjike

Territori i Komunës së Gllogocit në kuptimin klimatik i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme në përgjithësi në nivel vendi. Veçoritë klimatike ndryshojnë varësisht nga elementet klimatike si: diellosja (insolacioni), temperatura, reshjet, shtypja atmosferike, erërat, etj. Edhe Komuna e jonë sikur në gjithë vendin, me disa dallime të vogla klimatike shënojmë vlerat ekstreme pozitive të temperaturave në Komunë. Sipas të dhënave historike. ditët me acar mesatarisht zgjasin rreth 4 ditë dhe ( më të shpeshta janë në fshatrat në viset malore si : Fshati Gradicë, Lokoshan, Dobroshec etj, ( afer Maleve të Qyqavices ),Fsh. Nekoc dhe Kizharek, afer Maleve të Berishes). Periudha me temperatura nën zero zakonisht zgjat prej majit dhjetor deri në fillim të Marsit. Temperaturat e larta (tropike) më shpesh paraqiten në korrik e gusht, por ato ndodhin edhe në qershor e maj, vlerat e të cilave arrin nivelin mesatar mujor; në korrik 32°C dhe gusht me 34°C, me temperatura maksimale ditore deri në 34°C. Kjo gjendje klimatike krijon parakushte të përhapjes së zjarreve malore dhe fushore. Zjarre pyjore me përmasa me të mëdha ka pasur gjatë verës së viteve ( 2006-2010) dhe viteve (2010-2021), të cilat kanë përfshirë lokacionet: Malet e Vasileves, Dobroshecit, Gradices, Godancit, Abrisë, Vuqakut, Gjergjices, Baicës, Terdecit, Sankoc të Qukat, në të cilat ka pasur dëmtime të shumta të masës drunore, dhe siperfaqe të mëdha të pyjeve të dëmtuara, ku si shkatar po thuaj se është faktori njëri dhe faktoret natyror.

[3] Harta e rrezikut nga Vershimet e punuar nga MPHMM

`

Për shkak të ndryshimeve klimatike, ngjarjeve ekstreme të motit të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet, mund të rriten në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomi familjare, infrastrukturë biznes dhe mjedis.

Sasia vjetore e reshjeve: në komunën e Gllogocit sillen rreth 200 mm, ndërsa, gjatë vegjetacionit arrinë vlerën 500 mm. Maksimumi absolut është 500mm në muajin janar/shkurt dhe mars që paraqet 70 % të sasisë mesatare. Muaji me minimum absolut janë Muaji Korrik, Gusht, Shtator me vetëm (20 mililitra për $m^2$).

*Tabela 53: Sasia e reshjeve në milimetra në Komunën e Gllogocit*[4]

| Muaji/viti | Reshjet mesatare / mm | Sasia absolute maksimale / mm | Sasia absolute minimale / mm | Sasia maksimale ditore |
|---|---|---|---|---|
| Janar | | 11.0 | 0.0 | |
| Shkurt | | 9.8 | 0.0 | |
| Mars | | 10.5 | 0.0 | |
| Prill | | 17.2 | 0.0 | |
| Maj | | 8.0 | 0.0 | |
| Qershor | | 25.8 | 0.0 | |
| Korrik | | 21.5 | 0.0 | |
| Gusht | | 8.7 | 0.0 | |
| Shtator | | 9.8 | 0.0 | |
| Tetor | | 3.7 | 0.0 | |
| Nëntor | | - | - | |
| Dhjetor | | - | - | |
| **Vjetore** | | 25.8 | | |

**Lagështia:** Muaji më i lagësht është Qershori (25.8 mm) ndërsa muaji më i thatë gushti me Tetori 3.7 mm,
**Era**: në komunën e Gllogocit është e theksuar në drejtimin veri - jug dhe veri – lindje ( trëndafili i erës-grafikoni) , të cilat kohë pas kohe arrijnë shpejtësinë 25 m/s.
**Thatësia** si dukuri që ndër vite çfaqet simungesë e theksuar e të reshurave atmosferike në komunën tonë, sipas të dhënave historike në rastin më ekstrem ka zgjatur deri në 45 ditë pa reshje atmosferike, ( muajt:korrik, gusht të vitit 2024-2025).

### *6.5.7. Treguesit hidrologjik*

Ndryshimi i tipareve gjeomorfologjike, siç janë fushat e gjera të rrethuara me male dhe shtretërit e lumenjve të parregulluar dhe jo të mirëmbajtur, hedhja e mbeturinave në lumenj dhe nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, ndikon në shtrirjen dhe dinamikën e vërshimeve në komunën e Gllogocit. Vërshimet prekin kryesisht zonat bujqësore pothuajse çdo vit duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ekologjike. Shumica e kanaleve të lumenjve nuk

[4] *Instituti hirdometeorologjik i Kosovës- Vjetari hirdometeorologjik 2022*

mund të pranojnë sasi shtesë të ujit të krijuar ngjarje ekstreme të motit, shpesh duke çuar në vërshime të një game të gjerë.

Për shkak të ndryshimit të klimës, ngjarjeve ekstreme të motit, të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet janë rritur në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar një rritje të konsiderueshme të dëmtimit të ekonomisë, zonave urbane, infrastrukturës, mjedisit dhe natyrës.

### 6.5.8. Masat Parandaluese

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë nga vërshimet:

- Rritja e kontrollit mbi ndërtimet e egra të objekteve të banimit në shtretërit dhe brigjet e lumit;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale, kanaleve të hapura të ujitjes etj. që kalojnë edhe nëpër qytet, shtretërve të lumenjve, urave, etj;
- Ndalimi i mbeturinave dhe inerteve të ndryshme në lumenj, kanale dhe bllokimi i hapjeve të urave;
- Ndalimi dhe kontrolli i gërmimeve dhe eksploatimeve të pa kontrolluara të resurseve natyrore , meqërast ndërron edhe kahja e rrjedhës së ujit e më pastaj dalja nga shtrati;
- Mirëmbajtja e shtreteve të lumenjve nga organet kompetente;
- Zgjërimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë ngastrat pranë;
- Hapja e kanaleve anësore( të kullimit) dhe të rrugëve nga ndërtimet e paligjshme të pronarëve privat, etj.

### 6.5.9. Rekomandime:

- Marrja e masave për rregullimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar i lëndëve inerte nga shtretërit e lumenjëve në Kosovë;
- Marrja e masave nga organet e nivelit lokal në menaxhimin adekuat të mbeturinave në shtretërit e lumenjëve;
- Marrja e masave në mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale;
- Të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional veçënarisht në nivelin Komunal, kompanitë e furnizimit dhe shkarkimit të ujërave, lidhur me parandalimin, mbrojtjen nga vërshimet; dhe
- Masa tjera që ndikojnë pozitivisht për tu mbrojtur nga ndikimet e veprimeve të dëmshme të ujërave.etj.

`

## Skenari 1: Vërshimet

| Emri i skenarit: | Vërshimet |
|---|---|
| Frekuenca e ndodhjes: | |
| **X Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );**<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X E kufizuar( 10 deri 25%)**<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| **X- Skenari 1;** ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **X - I vogël ;** ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: 23/06/2024 | |
| 23/06/2024 | |

KONTEKSTI

| Nr. rend. | Parametrat: | Përmbajtja: |
|---|---|---|
| 1. | Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet në komunën e Gllogocit janë:<br>1.Gllogoc (qendra zejtare) 2.Dobroshec, 3.Lokoshan, 4. Verboc, 5.Poklek, 6. Shtrubullovë 7. Komoran, 8.Nekoc, 9.Zabel I Ultë, 10.Qikatovë e Re, etj.<br>Harta e vërshimeve në komunën e Gllogocit |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 2. | Kushtet meteorologjike | Për dy ditë rresht, nga data:21.06.2024 deri më:22.06.2024, në Komunën e Gllogocit , ka pasur të reshura shiu dhe breshri me dendësi të mesatare prej: 10 l/m². Më datë: 21/06/2024, ka pasur të reshura 9l/m², kurse më datë: 22/06/2024, ka pasur të reshura 11 l/m². Për tri ditë rresht, sipas matjeve në institutin metrologjik ka pasur të reshura 10 l/m².Sipas të dhënave meteorologjike, reshjet e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të 10 viteve të kaluara. |
| 3. | Periudha e vitit: | Qershor |
| 4. | Lloji i ditës: | Ditë pune |
| 5. | Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Gllogocit dhe fshatrave për rreth. Për çdo 3 vite kanë ndodhur vërshime të mëdha me pasoja, kurse nëse e marrim 10 vjeqarin e fundit kemi pasur disa vërshime në zona të ndryshme, që dmth se pothuajse për çdo vit kemi kemi pasur kërcënime nga vërshimet.(2019, 2020, 2021, 2023, 2024).<br><br>- Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie ishte në periudhen e qershorit, ku si pasojë e të reshurave të shiut në Gllogoc, ka pasur prurje të mesatare ujore, duke nxjerrë lumenjtë( Drenica dhe Verbica si dhe përrockat tjera) nga shtrati i tyre dhe duke vërshuar vendbanime në rrjedhën e poshtme të lumit "Drenica dhe Verbica", si Gllogoci ( Qendra e Re zejtare), Shtrubullova, |

| | | |
|---|---|---|
| | | Qikatova e Re, Verboci, Nekoci, Dobrosheci, Likoshani, Gllanasella, Pokleki i Ri, Tersteniku. |
| 6. | Popullata | Numri i familjeve të prekur nga vërshimi në zonën e vërshuar është 97 familje, kurse numri i banorëve ishte 430, prej tyre:<br><br>Fëmijë: 29;<br><br>Të moshuar dhe invalid: 5;<br><br>Gra; 179;<br><br>Meshkuj: 217; |
| 7. | Infrastruktura kritike egzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi ka pasur infrastukturë e cila ka ka pasur pasoja në këtë zonë.<br><br>Struktura rrugore;<br><br>Rrugët lokale – 25 km)<br><br>ura;7<br><br>tunela; nuk ka<br><br>Aeroporte jo funksionale; nuk ka<br><br>Sistemi i ujit( primare dhe sekondare), nuk ka.<br><br>Sistemi i kanalizimit( Primar dhe Sekondar), ka pasur demtime të gypave të kolektorve kryesor dhe sistemit sekondar përgjatë brigjeve të lumit Drenica dhe Verbica për shkak të rrjedhës së fuqishme të ujit |
| 8. | Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Gadishmëria e Shërbimit të Zjarrfikësve si dhe edukimi qytetarë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore ( popullatë rezistente nga FNFT), në këtë rast janë premisa që ndihmojnë në masë të madhe zvogëlimin e rreziqeve përmes kampanjave vetëdijësuese, edukimit shkollorë, udhëzuesve (fletë-palosjeve), ushtrimeve të ndryshme, etj.<br><br>Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK të RK për sasinë e madhe të reshjeve të shiut, QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative, për organet kompetente shtetërore, në nivel qëndror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të këtyre shërbimeve;<br><br>Kryetari i komunës së Gllogocit ka ndërmarr masat dhe aktivitetet e nevojshme për tejkalimin e vërshimeve, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal (PREL), ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik, |

| | | |
|---|---|---|
| | | paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br><br>Masat parandaluese për mbrojtje nga vërshimet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes. Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Kryqi i Kuq Komunal (KKK),OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| 9. | Info plotësuese | Informacione të besueshme për gjendjen nga terreni, raporte vlerësuese, raporte përkatëse institucionale, etj. |



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 26/11 2024
Nj. Org. 01 | Numër 052/01 | Shtojca – | Vlera 56542

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna/municipality Drenas/Gllogoc
Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

**Raporti përmbledhës i dëmeve nga Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera për vitin 2024**

| | Ndertim | Bujqësi | Totali |
|---|---|---|---|
| Komsioni I | 8,904.00 | 22,734.03 | 31,638.03 |
| Komsioni II | 33,583.00 | 78,309.42 | 111,892.42 |
| Komsioni III | 10,023.68 | 61,750.74 | 71,774.42 |
| Totali | **52,510.68** | **162,794.19** | **215,304.87** |

Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera, me nr. protokoll 01-020/04-30728, dt. 18.06.2024
1 Bislime Dvorani
2 Ilir Berisha
3 Kaltrina Gjoka
4 Valdete Ramaj
5 Vehbi Jashari

01-020/04-30728 28/06 24

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
| 9. | Info plotësuese | Informacione të besueshme për gjendjen nga terreni: Kryetari ka hartuar vendimin me nr. Protokoli 01-032-925 dt. 08.01.2016 për formimin e komisionit për vlerësimin e demeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike me datë (06-10).01.2016. Ku është hartuar raporti i komisionit të vlerësimit të demeve me dt. 22.01.2016 me nr. Protokoli 01-553-3846, dhe i njejti raport është derguar në Qeveri për kompenzim të demit te shkaktuar. |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DRENASIT

RAPORT I KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET E TË RESHURAVE ATMOSFERIKE

Për : z.Nexhat Demaku –Kryetar I Komunës

Nga : Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike dhe erërat e forta

Lënda : Raport I Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike dhe erërat e forta

Bazuar në Rregulloren (QRK) nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitëtjera ,si dhe të Vendimit nga Kryetari I Komunës nr.031-925 dt.08.01.2016 ,Komisioni në përbërje :

1. Halim Vrellaku-Kryetar
2. Ahmet Ahmeti,anëtar
3. Baki Fetahu-anëtar
4. Shaban Dobra-anëtar
5. Vehbi Jashari-anëtar

Ka bërëvlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e të reshurave atmosferike dhe erërat e forta në teritorin e Komunës së Drenasit nga data 06-10.01.2016.

Komisioni ka dalë në teren që nga data 08.01.2016 sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të qytetarëve për të vlerësuar dëmet e shkaktuara me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira material e shprehur në vlerëmonetare . Komisioni ka konstatuar se dëmet janëshkaktuar kryesisht në zonat rreth lumenjëve ,prrockave dhe vendeve kodrinore në këto vendbanime :
Drenas,Çikatovë e Re,Poklek I Ri,Komoran,Nekoc,Kizharekë,Fushticë e Ulët,Arllat,Gllobar,Dobroshec,Terstenik dhe lokalitete tjera të Komunës ku kishte dëme. Komisioni megjithë punën e kryer në teren konstaton mund të ketë edhe raste të tjera të dëmeve por që nuk ka pasur kërkesa

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DRENASIT

RAPORT I KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET E TË RESHURAVE ATMOSFERIKE

Për : z.Nexhat Demaku –Kryetar I Komunës

Nga : Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike dhe erërat e forta

Lënda : Raport I Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike dhe erërat e forta

Bazuar në Rregulloren (QRK) nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitëtjera ,si dhe të Vendimit nga Kryetari I Komunës nr.031-925 dt.08.01.2016 ,Komisioni në përbërje :

1. Halim Vrellaku-Kryetar
2. Ahmet Ahmeti,anëtar
3. Baki Fetahu-anëtar
4. Shaban Dobra-anëtar
5. Vehbi Jashari-anëtar

Ka bërëvlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e të reshurave atmosferike dhe erërat e forta në teritorin e Komunës së Drenasit nga data 06-10.01.2016.

Komisioni ka dalë në teren që nga data 08.01.2016 sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të qytetarëve për të vlerësuar dëmet e shkaktuara me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira material e shprehur në vlerëmonetare . Komisioni ka konstatuar se dëmet janëshkaktuar kryesisht në zonat rreth lumenjëve ,prrockave dhe vendeve kodrinore në këto vendbanime :
Drenas,Çikatovë e Re,Poklek I Ri,Komoran,Nekoc,Kizharekë,Fushticë e Ulët,Arllat,Gllobar,Dobroshec,Terstenik dhe lokalitete tjera të Komunës ku kishte dëme. Komisioni megjithë punën e kryer në teren konstaton mund të ketë edhe raste të tjera të dëmeve por që nuk ka pasur kërkesa

**REKAPITULIM**

| Nr. | LLOJI I DËMIT | VLERA NË (euro) € |
|---|---|---|
| I. | DËMET NË BIZNESE | 44,990.00€ |
| II. | DËMET NË EKONOMITË FAMILJARE | 5,198.00€ |
| III. | DËMET NË INFRASTRUKTURË | 71,320.00€ |
| IV. | DËMET NË BUJQËSI | 48,387.00€ |
| | GJITHËSEJT EURO : | 169,895.00€ |

Komisioni :

1. Halim Vrellaku-Kryetar
2. Ahmet Ahmeti,anëtar
3. Baki Fetahu-anëtar
4. Shaban Dobra-anëtar
5. Vehbi Jashari-anëtar

Drenas, 21.01.2016

INCIDENTI-NGJARJA

| | | |
|---|---|---|
| 10. | Shkaku dhe shkaktari | Pas reshjeve intensive dhe të pa gjate periudhes (06-10)/01/2016 të cilat shkaktuan vërshime të rrëzikeshme dhe fuqishme, dhe erërave te forta në disa zona që përfshijnë një pjesë të madhe të komunës së Gllogocit dhe fshatrt për rreth, në këtë rast të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, u alarmuan dhe po veprojnë në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT. Është ngritur gatishmëria e ERE lokale (Zjarrfikësit), Me datë: (06-10)/01/2021, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi |

`

| | | |
|---|---|---|
| | | njoftim/komunikatë përmes ueb faqes http://wwwihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë:<br><br>Për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e vershimeve në zona të caktuara të Kosovës, ku edhe ne si komunë jemi pjesë përbërëse e kësaj zone. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për mundësinë reale të vërshimeve të shpejta i parashikuar nga IHMK:<br><br>Kjo situatë do të vazhdoj për disa ditë (deri më: 10/01/2016), ), ku si pasojë e intensitetit më të lartë të tyre, në disa zona mund të paraqiten vërshime të lehta/shpejta, të cilat potencialisht mund të shkaktojnë ngritje të shpejtë të nivelit të ujit ku si pasojë e intensitetit më të lartë të tyre, në disa zona mund të paraqiten vërshime të shpejta, të cilat potencialisht shkaktojnë ngritje të shpejta të nivelit të ujit nëpër lumenj e sidomos nëpër rrjedhat ujore të cilat kanë karakter të rrëkeve. Nëpër lumenjtë kryesorë do të ketë ngritje të lehët të niveleve gjatë ditëve në vijim, ndërsa rrjedhat me karakter malor dhe ato të rrëmbyeshme do të paraqesin mundësi të vërshime të shpejta dhe vështërsi nëpër zonat/vendbanimet ku ato kalojnë. Figurat lartë paraqesin, zonat e shtrirjes kohore dhe hapësinore të situatës meteorologjike dhe të vërshimeve.<br><br>- Reshjet e shiut, të cilat po vazhdojnë pa ndërpre, më shumë se 48h, duke përfshirë tërë territorin e Komunës sonë me intensitet më të shprehur në zonën e Gllogocit dhe Shtrubullovës, ku gjatë kësaj kohe, ka pasur të reshura mesatarisht rreth 22 (l/m2), duke shkaktuar vërshime/përmbytje nëpër disa zona komunale, si pasojë e ngritjes së niveleve të lumenjve përtej kapaciteteve të tyre bartëse. Vërshimet në Pellgun e Lumit Drenica dhe Verbica, paraqet një periudhë kthyese 10-15 vjeçare, ku sipas parashikimeve të IHMK-së, ditëve në vazhdim do të ketë reshje shiu që do ta rëndojnë edhe më shumë situatën.<br><br>**Vërejtje**: Në shtratin lumor të Lumit Drenica dhe Verbica dhe të prrockave që derdhen në këtë shtrat lumor, tendencat janë në ngritje të masës ujore kështu që pas dy ditësh me datë 07/01/2016, pritet që të arrihet maksimumi i niveleve dhe i prurjeve.<br><br>-Situata po vazhdon të rëndohet duke u zgjeruar zonat e vërshuara në gjithë gjatësin shtratin e lumit Drenica dhe Verbica<br><br>-Më i atakuari është shtrati i lumit Drenica, ku nivelet e ujit kanë arritur kuotat maksimale të brigjeve lumore, e disa prej tyre kanë shkaktuar vërshime dhe dëme materiale ne infrastruturë, bujqësi, ekonomi familjare dhe biznesetj.)<br><br>-Sipas parashikimeve të IHMK-së, pritet që ditëve në vazhdim të ketë reshje në tërë vendin por më të theksuara përsëri në viset tona, që do ta rëndojnë |

| | | |
|---|---|---|
| | | edhe më shumë situatën, sidomos me temperaturat pozitive të cilat ndikojnë në shkrirjen e borës së rënë së fundi( janar 2021)<br><br>- Ngritje e norme e nivelit të ujit brenda 24h, janë duke u regjistruar në lumin Drenica dhe deget e saj dhe lumin Verbica dhe përrockat e saj, në profilin hidrometrik në Gllogoc, ku brenda 24h, kemi ngritje të nivelit nga 1 m, në 3 m, apo për 2 m më shumë, (shih tabelen).Gjendja e niveleve të ujit në lumenjtë kryesorë të Kosovës nga datë: 06/01/2016 deri më 10/01/2016.<br><br>Tabelorja: zgjidhi vlerat, sipas nivelit te prurjeve te ujit gjate vershimeve ne shtratin e lumit Drenica dhe degëve të tijë dhe Lumit Verbica dhe prrockave të saj |

| Nr | LUMI | VENDI | DATA | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 10.01.2021 | 11.01.2021 | Tendenca |
| | | | Nivelet në m | | |
| 1 | Drenica | Gllogoc | 1.5 | 3 | +1.5 |
| 2 | Drenica | Shtrubullovë | 1.4 | 3 | +1.6 |
| 3 | Drenica | Komoran | 1.2 | 3 | +1.8 |
| 4 | Gllogoc | Dobroshec | 1.6 | 3.5 | +1.9 |
| 5 | Drenica | Poklek I Vjeter | 1.5 | 3.2 | +1.7 |
| 6 | Drenica | Poklek I Ri | 1.3 | 3.1 | 1.7 |
| 7 | Drenica | Kizharek | 1.2 | 2.7 | +1.5 |
| 8 | Drenica | Arllat | 0.7 | 1.5 | +0.8 |
| 9 | Drenica | Nekoc | 1 | 2.5 | +1.5 |
| 10 | Verbica | Verbofc | 0.5 | 2.4 | +1.9 |
| 11 | Verbica | Terstenik | 0.5 | 2.5 | +2 |
| 12 | Drenica | Gllobar | 0.7 | 1.5 | +0.8 |
| 13 | Verbica | Qikatov e Re | 1.2 | 3 | +1.8 |

| | | |
|---|---|---|
| 11. | | Në disa segmente lumore dalja e ujit nga shtrati ka krijuar situatë kritike me vershime dhe përmbytje në zona të caktuara urbane dhe fushore, ashtu siç edhe është përshkruar në raportet /njoftimet e IHMK, të paraqitura më lartë, dhe njoftimet nga zyra për informim e Komunës. |

`

| | | |
|---|---|---|
| | Ngjarja kryesore | Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe është regjistruar niveli i ujërave që tejkalon vlerën maksimale historike ( 3.5 m) në lumin Drenica në pikën matëse në Dobroshec e cila ka arritur në: 3.5 m.<br><br>-Pas ndërprerjes se reshjeve më: 10/01/2016, niveli i ujërave në lumenjë filloj të bie në shumicën e lumenjëve, për më saktë në vazhdim janë dhënë grafikonet e niveleve të ujërave në lumenjët kryesorë të Kosovës gjatë periudhës së vërshimeve.<br><br>Niveli i ujerave pikat matese:<br><br><br><br>*Graf.1. Në lumin Drenica dhe Verbica*<br><br>Thelbi i skenarit i nxitur nga një sërë shkaqesh deri të pasojat.<br><br>- Më: 06/01/2016, uji i dalur nga shtrati, që ka shaktuar një vërshim përgjatë luginës së lumit të Drenica, në një gjatësi rreth 30 km, me sipërfaqe rreth 50 ha për rrethë ketij, duke përfshirë dhe rrezikuar: njerzë, ekonomi familjare, gjënë e gjallë, infrastrukturë rrugore.<br><br>-Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve , thellimin e shtretërve të lumenjëve dhe heqjen e barrierave ( masave inerte nga lumi) për rrjedhje të ujit pa pengesa, masat për mbrojtjen e sistemit të ujit të pijshëm, infrastrukturën rrugore( urat, rrugët). Vërshimet kanë përfshirë 150 shtëpi banimi me dëme 5,198.00€ të amvisërisë dhe bisnese të vogla, si dhe objekte përcjellëse, janë përmbytur 50 Ha tokë me të mbjellura ,<br><br>-Operacionet e ekipt emergjent kanë qenë në gatishmëri për reagim emergjent, në rast të paraqitjes së nevojës, në largimin e ujit nga podrumet, largimi i banorve te rrezikuar, furnizimi me produkte ushqimore të familjeve te bllokuara etj. |

| | | |
|---|---|---|
| | | -Është ngritur gjendje e gadishmërisë emergjente dhe janë ftuar për gatishmëri edhe ShRE lokal dhe publik si dhe biznesi privat me makineri si dhe OJQ (KKK). |
| 12. | Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi):**5,198.00€**<br><br>-Dëmtim i përkohshëm apo eroziv i sipërfaqeve 50 Ha ;<br><br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore (4 ura të dëmtuara, rrugë të dëmtuara 50 km<br><br>- Dëmtim i Infrstrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit, kanalizimit, sistemi energjetikë);<br><br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i plotë i orendive shtëpike: 150 shtëpi);<br><br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore (kultura bujqësore të dëmtuara):50/ha.<br><br>-Dëmtimi i bizneseve:**44,990.00 €**<br><br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit :**169,895.00€** |
| 13. | Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti | Vështërësi dhe bllokada rrugore për qarkullim në trafik: **Po;**<br><br>Paraqitja e rrëshqitjes së dheut: **Jo**;<br><br>Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante: **Po** ( turbullira në bazenet e KRU "Prishtina" tek feronikeli, puset private);<br><br>Kërcënimi për mundësinë e shfaqjes së ndonjë epidemije( si pasoj nga shkarkimet e gropave septike, etj)/<br><br>Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore ( dëmtim i **50 Ha** me të mbjellura vjeshtore /grur/); |
| NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES | | |
| 14. | Rastet me fatalitet | Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| 15. | Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar; | -Situata e krijuar pas vërshimeve është shqetësuese, janë të lënduar 2 persona me pasoja afatshkurta ( pasoja nga lëndimet e lehta trupore dhe pasojat nga traumat pas perfshirjes se tyre në valet e ujit, etj),në zonën e kizharekes, të cilet jan nxjerrur nga valet e lumit Drenica. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Ne përgjithesi në zonat e përfshira janë gjasat reale për shfaqjen e rrezikut nga shpërthimet epidemiologjike( tifoja, ethet e minjëve, sëmundjet lëkurore, etj.);<br><br>-Turbullirat e ujit të pijshëm në bazenet e feronikelit dhe në puse private; |
| 16. | Mungesë<br><br>e nevojave elementare | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe urave,<br><br>- Punëtorët po hasin në vështërësi të madhe për të arritur në punë, një pjesë e tyre kanë qenë pjesë e komunitetit të goditur dhe kanë nevojë të kujdesit familjar;<br><br>- Për 3 ditë fëmijët nuk do të mund të shkojnë në shkolla e kopshte;<br><br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri dhe i pa mjaftueshëm për shkak të mungesës së stafit të specializuar si dhe kërkesave të mëdha;<br><br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br><br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| 17. | Të evakuuarit | -Janë kryer 3 veprime operacionale të KSh gjatë kohës së vërshimeve, por ende ka nevojë për operacione të KSh ;<br><br>- Deri më tani, më shumë se 20 familje u evakuuan gjatë vërshimeve në të gjitha rastet dhe ata u derguan tek te afermit e tyre, |
| 18. | Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz( shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , të mëdha dhe ende të evidentuara tërësisht nga komisioni lokal për vlerësim të dëmeve;<br><br>Dëmet e shkaktuara në:<br><br>-Ekonomi familjare ( rreth 150 familje), të përllogaritura:5,198.00 €;<br><br>- Bujqësi ( sipërfaqe të mbjellura me të lashta) të përllogaritura: 48,387.00€,;<br><br>- Infrastrukturë kritike((rrugët,urat,trotuare, energjia elektrike, ujësjellës dhe kanalizim, KRU, ShA), të përllogaritura:71,320.00€;<br><br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 169,895.00€; |
| 19. | Ndikimi në natyrë dhe<br><br>mjedisi | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësorë ka sjellur ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br><br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga përmbytjet, etj.<br><br>- Degradimi i shtretërve të lumenjëve, argjinaturave dhe kanaleve kulluese; |

| | | |
|---|---|---|
| 20. | Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerjet e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Gllogoc, Poklek i Ri, Qikatov e Re, Komoran;<br><br>- Furnizimi alternativ me ujë të pijshëm me autobot;<br><br>- Furnizim me energji elektrike; |
| 21. | Humbje në trashëgimi kulturore | Nuk ka; |
| 22. | Implikime politike | Nuk ka; |
| 23. | Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i nivelit mesatar |
| PROBABILITETI-GJASAT | | |
| 24. | Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit kritik të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat vlerësuese preliminare |
| 25. | Paralajmërimi i hershëm | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi(eskaloi) në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br><br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br><br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me planin komunal për reagim emergjent(PREL) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, ueb-faqe të, interneti, etj. |
| 26. | Masat parand. gjatë periudhës së paralajm.<br><br>të hershëm | -Pas marrjes së paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria për të papriturat dhe aktivizohet Plani lokal i Reagimit Emergjent ose Planifikimi Kontigjent për vërshimet si dhe është ngritur gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| 27. | Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 (tri) ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 15-25 ditë. |

`

| | | |
|---|---|---|
| 28. | Koordinimi | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO(procedurave standarte operative) njoftohen organet kompetente dhe organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&SH për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PREL;<br><br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, është aktivizuar QOEL sipas vendimit të Kryetarit të Komunës, është aktivizuar Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës/I deleguari i tij.<br><br>Është PKI dhe KI për menaxhimin e situatës emergjente në Zonën e ngjarjes( vërshimit)<br><br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qëndror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br><br>- Në ndërkohë është aktivizuar edhe Komisioni lokal për vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, me qëllim të mbledhjes së të dhënave për dëmet e shkaktuara si dhe të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br><br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br><br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon AME-së në afat të caktuar;<br><br>-Është bërë kontakti dhe është kërkuar ndihma e humanitare nga mekanizmat vendorë (organizata dhe OJQ humanitare).<br><br>- Menaxhim dhe koordinim i situatës nga Entitetet Koordinuese dhe menagjuese; |
| 29. | Informata plotësuese | Nuk ka info plotësuara |

**Probabiliteti/Gjasat:**

Sipas kritereve në tabelë, ngjarja e përmbytjes në vitin 2016 mund të klasifikohet si fatkeqësi e madhe/kritike. Vërshimi ka ndodhur në muajin Janar, me një periudhë kthimi nga viti 2021, prej T = 2 vjet, pra probabiliteti i ndodhjes: **p= (51-98)%.**

Treguesit e probabilitetit:

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | |
| 4 | E madhe /<br>Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë ka pasur viktima por vetem dy të lenduar me lendime të lehta trupore, si pasoj e renjes s tyre në valet e lumit Drenica, në fshatin Kizharek prandaj duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen(përllogariten) si të nivelit mesatar

-Përveç kërcënimit ekonomik të zonës së Gllogocit gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim serioz i standardit jetesorë në zonën e prekur nga vërshimet;

Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut |
|---|

`

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

Pasqyrimi i pasojave në ekonomi : përcaktohen në raport me bruto-produktin e brendshëm në Republikën e Kosovës, për zonën e prekur.

-Demonstrimi i pasojave për stabilitetin social/ dëm material ndaj infrastrukturës kritike;

-Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 169,895.00 €.

- Pasojat në ekonomi të shkaktuara nga vërshimet, përllogariten në raport me bruto-produktin e GDP-së së Republikës së Kosovës për zonën e prekur.;

Pasqyrimi i pasojave në ekonomi

| Pasojat ekonomike |
|---|

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social, dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike.

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturën kritike janë përllogaritur në bazë të raportit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve dhe arrinë shumën: **169,895.00 €.**

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike

| Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike |
|---|

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm i objekteve me rëndësi të veqantë:

| Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë: | | | |
|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
| 1 | Të papërfillshme | < 0.5 % GDP | |
| 2 | Të vogla | 0.5 -1 % GDP | |
| 3 | Mesatare | 1 – 3 % GDP | |
| 4 | Kritike | 3 – 5 % GDP | |
| 5 | Katastrofike | > 5 % GDP | |

**Matrica 1:** Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:




**Matrica 2:** Rreziku për pasojat në ekonomi:




**Matrica 3a:** Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike

**Matrica 3b:** Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:

**Matrica përmbledhëse:** 3a dhe 3b, pasqyron rrezikun  rrezikun për stabilitet shoqëror:




**Matrica 4:** Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm:



## 6.5. ZJARRET

Gjatë viteve 2012-2024, në teritorin e Komunës së Gllogocit, ka pasur raste të shumta të paraqitjes së zjarreve më përmasa të ndyshme sidomos ne ato fushore dhe malore të cilat shumica prej tyre, dyshohet që janë shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia e faktori njeri, po ashtu zjarret në objektet e banimit dhe objekte të tjera përcjellëse të cilat janë përfshirë nga zjarri janë marrë të gjitha masat e shpejta nga njësitet e para reaguese në parandalimin dhe minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri, pjesmarrja ka qenë aktive në të gjitha rastet emërgjente si në; kushtet klimatike, nderlikushmeria e rastit emërgjent, llollojshmeria e rasteve emërgjente, distanca e afert apo e largët etj .

### 6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve,

Sikur edhe relievi i Kosovës që përbëhet prej vargmaleve, maleve, fushëgropave dhe luginave, të krijuara nga lëvizjet tektonike, nga format erozive, etj. edhe reliefi i komunës sonë, si pjesë integrale, është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre te jashtme të cilat kanë modeluar atë, që në aspektin morfologjik brenda territorit të Komunës së Gllogocit mund të diferencohen këto njësi morfologjike, malet e Drenices dhe ato Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug- Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së Lumit Drenica.

Edhe Komuna e Gllogocit sikur edhe komunat e tjera gjatë dy dekadave të fundit, kanë qenë të kërcënuara nga zjarret, sidomos zjarret urbane dhe malore. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga terreni nga IMNZ, shkaktari kryesor i përhapjes së kësaj kategorie të zjarreve është faktori njeri, qofte nga pakujdesia apo me qellim.

**Shkaqet e zjarreve** në Komunën e Gllogocit kanë karakter:

- Antropogjenik (mos kujdesi i njerëzve),
- Djegia e hamulloreve dhe kullotave( **zjarrëvënie e qëllimshme**);
- Zjarrëvënie e qëllimshme në pyjeve për interesa ( perfitime) personale apo vese piromanie;
- Zjarre të shkaktuara nga natyra (**shumë të rralla por të mundshme**).

Zonat më të atakuara nga zjarret janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, kurse zjarret fushore i ekzpozohen zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.

Në pjesen e poshtme në formë tabelare janë të paraqitura të gjitha intervenimet e natyrave të ndryshme të cilat ka intervenuar NJPSHZSH-ja.

*Tabela 54: Numri i zjarreve në vitet 2014-2024*

| Janar Dhjetor | Nr.i përgjith. i daljeve | Nr.i zjarreve | Shërbime Teknike | Intervenime teknike rrugore | Vërshime | Të lënduar | Të vdekur |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2014** | **248** | **190** | **28** | **14** | **16** | **8** | **2** |
| **2015** | **267** | **193** | **7** | **19** | **17** | **2** | **1** |
| **2016** | **175** | **104** | **1** | **14** | **34** | **5** | **0** |
| **2017** | **397** | **309** | **45** | **22** | **15** | **5** | **3** |
| **2018** | **276** | **190** | **38** | **22** | **19** | **0** | **0** |
| **2019** | **432** | **323** | **67** | **28** | **8** | **1** | **1** |
| **2020** | **516** | **267** | **191** | **43** | **7** | **20** | **5** |
| **2021** | **407** | **283** | **41** | **23** | **47** | **0** | **2** |
| **2022** | **403** | **275** | **61** | **37** | **25** | **5** | **4** |
| **2023** | **513** | **439** | **5** | **35** | **26** | **5** | **3** |
| **2024** | **494** | **417** | **11** | **53** | **6** | **9** | **1** |
| **Gjithësej** | **4128** | **2990** | **495** | **310** | **220** | **60** | **22** |

*Grafiku nr.1 Numri i zjarreve në vitet 2014-2024*



## 6.5.2. Kushtet klimatike

Në aspektin klimatik, Komuna e Gllogocit nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme, të cilat gjatë muajve të verës shkakton mungesë të reshjeve të shiut dhe lagështisë se ajrit dhe tokës ku për pasojë kemi mungesë të theksuar të të reshurave meqërast teritori i Komunës sonë përfshihet nga thatësia dhe temperaturat e larta deri 35. $^{0}$C , dukuri kjo që po merr përmasa të gjëra dhe Relievi karakterizohet me klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohët dhe verë të ngrohtë. Temperatura mesatare vjetore është 11.8$^{0}$C, maksimumi absolut i temperaturave është 33. $^{0}$C, ndersa minimumi absolut është -16.2.$^{0}$C Muaji më i ftohët është marsi me -16.$^{0}$C, kurse muaji më i ngrohët është gushti më 33.$^{0}$C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm. Lartësia mbidetare është prej 500-650 m, ku rreth 46% të sipërfaqes gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650 m, e cila lartësi është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore etj.

Reshjet atmosferike se bashku me temperaturën paraqesin tiparin primar klimatik. Sasia e reshjeve, forma dhe intensiteti i reshjeve janë karakteristikat më të rëndësishme për hapësirën e një territori. Reshjet paraqesin vetëm një pjese të ciklit hidrologjik dhe ripërtritjes së ujit për një hapësire të caktuar respektivisht për territorin e Komunës sonë. Zhvillimi i vegjetacionit në sezonën pranverore, mungesa e të reshurave atmosferike në sezonën verore si dhe ngritja e temperaturave krijojnë parakushtet ideale të përhapjes së zjarreve malore dhe fushore.

**6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike**
**Karakteristikat e zjarreve pyjore dhe fushore**

- Zjarret pyjore dhe fushore janë fatkeqësi që shkaktojnë dëme të mëdha të sipërfaqeve të tëra drusore të llojeve dhe vlerave të ndryshme, shkakton dëme në faunë si dhe dëme ekologjike/mjedisore e që mvarësisht nga përmasat dhe pasojat, përcaktohet edhe niveli/shkalla e rrezikshmërisë.

- Zjarret e shkaktuara në sipërfaqe të mëdha në pyjeve ose shkurre ku përfshihen edhe zona të banuara (vendbanime), mund të shkaktojnë cenueshmëri /rrezikshmëri të lartë për njerëzit brenda zonës, pasurisë së tyre, për pyjet dhe mjedisin brenda zonës së caktuar.

- Zonat më të atakuara nga zjarret fushore dhe malore janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, si dhe fshatrat e zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.

- Shkaktarët e paraqitjes së këtyre kryesore të zjarreve kryesisht vijnë nga njerëzit( duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të pa-kontrolluara, zjarret aksidentale dhe zjarrvëniet e qëllimshme, etj.);

*Tabela 55: Tabela me zjarre  malore-fushore (nurmi i zjarreve dhe sipërfaqja në hektarë), gjatë viteve 2014-2025*

| VITET | Zjarre Fushore | Zjarre Malore | Siperfaqja (ha) | Dëmet |
|---|---|---|---|---|
| **2014** | 51 | 8 | 1.7 | |
| **2015** | 70 | 9 | 12 | |
| **2016** | 14 | 7 | 1.7 | |
| **2017** | 130 | 20 | 5 | |
| **2018** | 51 | 18 | 29.82 | |
| **2019** | 115 | 52 | 85.48 | |
| **2020** | 77 | 35 | 33.28 | |
| **2021** | 102 | 18 | 6.68 | |
| **2022** | 87 | 38 | 92.65 | |
| **2023** | 274 | 24 | 36.6 | |
| **2024** | 222 | 66 | 45.6 | |
| **2025** | | 37 | 105.9 | |
| **Gjithsej** | **1193** | **332** | **456.41** | |

Grafiku nr.2. *Grafikoni i zjarreve  malore-fushore (nurmi i zjarreve dhe sipërfaqja ), gjatë viteve: 2014-2024*



*Grafiku nr.3. Numri Siperfaqja në ha*




### 6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohëzgjatja

| **Fletë pune e profilit të rrezikut për zjarre Pyjore dhe fushore (2014-2025)** | |
|---|---|
| **Madhësia e mundshme** ( Përqindja e komunitetit që mund të goditet): ( **Niveli i ultë** )<br>**Katastrofike**: ☐ më shumë se 50%<br>**Kritike**: ☒ 25 deri 50%<br>**E kufizuar**: ☐ 10 deri 25%<br>**E papërfillshme**: ☐ më pak se 10% | |
| **Frekuenca e ndodhjes:**<br>▪ **Shumë e mundshme: mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm;**<br>▪ E mundshme: mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm; ose së paku një rast në 10 vitet e ardhshme;<br>▪ Ka gjasa: mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një rast në 100 vitet e ardhshme;<br>▪ I pa mundshëm: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.<br><br>Frekuenca e ndodhjes se zjarreve pyjore dhe fushore **janë shumë të mundëshme** dhe mund të ndodhin cdo vit, me pasoja her më të mëdha e herë me të vogla, sidomos pasoja në pyje ku kanë shkaktu deme të konsiderushme në masen drunore, ndërsa rrallë kanë ndodhë që pasojat të jenë edhe nga zjarret fushore, konkertishtë në të mbjellura, por nuk përjashtohen këto zjarre në të ardhëmen. | **Modeli Sezonal:**<br>☐ Pranverë;<br>☒ Verë;<br>☐ Vjeshtë ;<br>☐ Dimër; |

| |
|---|
| ▪ **Zonat e goditura**: **Zonat me të goditura, janë lokacionet tek Pishat e Gllobarit, Malet e : Vasileves, Vuqakut, Baices, Kosmaqit, Gradicës ,Berishës, Terstenikut, Sankocit, Llapushnikut, Gjergjicës, Negrocit etj.** |
| ▪ Kohëzgjatja: **kohëzgjatja e zjarreve fushore dhe Pyjore ka qen me gjata deri në tri ditë në malet e Gradicës ku kanë qenë më përmasa të mëdha.** |
| ▪ **Shpejtësia e mundshme e mësymjes** (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): |
| - Paralajmërim minimal (apo fare); - Paralajmrim 12 deri 24 orë;<br>- **Paralajmërim 6 deri 12 orë**; - Paralajmërim më shumë se 24 orë; |
| ▪ **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:**<br>**- Instituti i meteorologjisë;**<br>**- QOE-112/AME, etj;** |
| ▪ **A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?**<br>☒ **Po; Janë bërë analiza pas përfundimit të intervenimeve nga ana e zjarrfikësve, dhe kanë dal me disa konkludime si: Mungesë të pasijeve për shuarjen e zjarreve( si Ajrfryerse Portative të zjarreve, qanta shpinore, Autocisterna me kapacitet deri në (8 -10 )mijë litra.Ndërsa nga aspekti i parandalimit, duhet të bëhët vetëdijësim I qyetarve dhe një Inspektim me i shpeshtë i Inspektorve të parandalimit të zjarrve, shqiptimi i gjobave për të gjithë ata që shkaktojn zjarre të qëllimshme në pyje dhe fusha apo edhe objekte.**<br>▪ ☐ **Jo;** |

**Të dhënat për zjarret në pyje dhe fushore;**

Gjatë viteve 2014 deri në vitin 2025, nga shenimet e marrura nga NJPSHZSH, në Gllogoc, gjithësejt zjarre fushore kanë qenë **1193** raste, ndërsa zjarre malore kanë qenë **332** raste, ku me këtë rast ka pasur demtime të sipërfaqeve pyjore rrethë **456.41 Ha.**

**- Specifiko analizën e zjarreve në 10 vitet e fundit, intenzitetin e zjarreve dhe angazhimin e reaguesve emergjent**

Zjarret fushore zakonisht kanë qen nëpër hamullore , të cilat janë shkaktuar disa me qellim e disa rastësisht, dhe një pjesë e zjarreve janë shkaktuar edhe në siparfaqe të pa mjellura apo fusha ku ka qenë bari i that, ku vlen të theksohet zjarri në sipërfaqet e majes se Goleshit ku me këtë rast janë rrezikuar edhe disa shtëpi të fshatit Sankoc , ndërsa zjarret Malore janë raste ku janë dëmtuar pyje shkurre, ku vlen të theksohet zjarret me intenzitet me lartë kanë qenë ato të maleve të Gradices, Godancit, Gjergjicës, Korroticës se lartë, ku intervenimet kan zgjatur deri në tri ditë për t'i lokalizuar zjarrët.

Angazhimi i zjarrfikësve ka qenë maksimal, ku kanë reaguar me të gjitha mundësit dhe kapacitetet humane dhe mjeteve që i kanë në disponim. DSHPE-ja i ka mbeshtur me ushqim, qumsht dhe ujë gjatë intervenimeve, në rastet ku intervenimet kanë zgjatur me ditë.

*Tabela 56: Tabela për numrin e zjarreve pyjore dhe fushore në 10 e fundit, se bashku me diagramin*

| VITET | Zjarre Fushore | Zjarre Malore | Siperfaqja (ha) |
|---|---|---|---|
| **2014** | 51 | 8 | 1.7 |
| **2015** | 70 | 9 | 12 |
| **2016** | 14 | 7 | 1.7 |
| **2017** | 130 | 20 | 5 |
| **2018** | 51 | 18 | 29.82 |
| **2019** | 115 | 52 | 85.48 |
| **2020** | 77 | 35 | 33.28 |
| **2021** | 102 | 18 | 6.68 |
| **2022** | 87 | 38 | 92.65 |
| **2023** | 274 | 24 | 36.6 |
| **2024** | 222 | 66 | 45.6 |
| **2025** | | 37 | 105.9 |
| **Gjithsej** | **1193** | **332** | **456.41** |

*Grafiku nr.4. Zjarret Fushore-Zjarret Malore*



### 6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga Zjarri

Zjarre pyjore dhe fushore të përmasave mesatare në Komunën e Gllogocit ka pasur gjatë verës dhe fillimit të vjeshtës së viteve 2014-2025, por në përmasa shqetësuese ka pasur edhe në 4 vitet e fundit, të cilat kanë përfshirë lokacionet me pyje dhe fusha:

- Në malet e fshatit Gradicë me kohëzgjatje prej 3 ditësh të cilat kanë ndodhë në muajin korrik të viteve 2024 dhe 2025 në një sipërfaqe prej 15 hektar ,ku lloji i drurit është Bung , Qarr dhe ahisht, si masë drusore.
- Në fshatin Korroticë e Eperme përkatësisht në malet e Korroticës se Eperme me kohëzgjatje prej 2 ditësh, të cilat kanë ndodhur gjat muajit korrik dhe gusht të viteve 2024 dhe 2025 në sipërfaqe prej 6 hektar pyjore, lloji i drurit është Bung e Qarr si masë drusore, etj.

***Tabela 57: Historiku i zjarreve me intensitet të lartë në Komunën e Gllogocit***

| ***Historiku i zjarreve me intensitet të lartë në Komunën e Gllogocit*** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muajt** | **Viti:** | **Lokacioni:** | **Nr. Zjarr.** | **Tipologjia** | **Sipërfaqja/h** | **Masa drusore ($m^3$)** |
| **Mars** | **2019** | **Fshatrat:Llapushnik, Dobroshecë, Baicë,Gjërgjicë, Baicë, Nekoc, Damanek,Poklek,Tërstenik,Tërdec, Çikatovë e Vjetër,Gradicë,Fushticë e Ulët,Vasilevë,Arllat,Likoshan.** | **29** | **Zjarr Malor** | **56.10** | **16.83** |
| **Mars** | **2020** | **Fshatrat:Korroticë e Eperme, Gllobarë(Pishat), Çikatovë e Vjetër,Tërstenik,Llapushnik, Shtuticë,Vërboc,Gllanasellë, Fushticë e Ulët, Negrocë, Vasilevë, Gjergjicë.** | **16** | **Zjarr Malor** | **13** | **3.9** |
| **Mars** | **2022** | **Arllat,Gllanasellë,Likoshan, Tërdec,Dobroshec,Polluzh, Gradicë, Llapushnik, Tërstenik.** | **13** | **Zjarr Malor** | **17.50** | **5.25** |
| **Gusht** | **2024** | **Fshatrat Llapushnik,Sankoc,Korroticë e Eperme,Gllobarë(Pishat), Dobroshec,Abri,Arllat,Komoran,** | **27** | **Zjarr Malor** | **19** | **5.7** |

`

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Fushticë e Ulët, Baicë, Gllanasellë, Nekoc,Negrocë,Terstenikë,Tërdec.** | | | | |

*Tabela 58:Të dhëna për reagimin e ERE në zjarret fushore –malore, vitet: 2014-2025 në komunën e Gllogocit*

| Viti | *2014* | *2015* | *2016* | *2017* | *2018* | *2019* | *2020* | *2021* | *2022* | *2023* | *2024* | *2025* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i interven. të ERE | *8* | *9* | *7* | *20* | *18* | *52* | *35* | *18* | *38* | *24* | *66* | *37* |

### 6.5.6.Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

- Analiza profesionale dhe vlerësimi profesional i ekspertëve përkatës të fushës për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri është pjesë përbërëse e Planeve Komunale Zhvillimore(PZhK) si dhe planeve Urbanistike. Në këto plane është e paraparë zbatimi i dispozitave ligjore si: Ligji i Ndërtimit, Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, akteve nënligjore përkatëse, normave teknike, si dhe normave( kodeve) ndërkombëtare të pranuara.
- Në kuadër të projekteve të ndërtimit (objekteve specifike ) dhe atyre që zhvillojnë(deponojnë) aktivitet me materie të rrezikshme apo paraqesin rrezikshmëri të lartë, pjesë e projektit duhet të jetë edhe elaborati për mbrojtje nga zjarri.
- Pjesa urbane e qytetit tonë, kohëve të fundit(2023-2024-2025) ka një zgjërim dhe ndërtim të hovshëm, sidomos me objekte shumë-katëshe për banim, me objekte privato-publike dhe parqe industriale , ku një pjesë dërmuese e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin kënaqshëm kërkesat dhe nevojat për mbrojtje nga zjarri, gjat implemntimit siç janë:
- Mungesa e sistemit të lajmërimit dhe alarmimit nga zjarri;
- Mungesa e rrugëve( hapsirave të mjaftueshme ) për grubullim dhe evakuim;
- Atesti i qëndrueshmërisë së konstruksionit të objekteve ndaj zjarrit;
- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë dhe në ndërtesë,
- Mungesa e daljeve emergjente, Shkallëve emergjente( tek shkollat dhe QKMF);
- Mungesa e hidranteve në objektet e lartëcekura ( hidrante jo-funksionale);
- Mungesa e inspektimeve të mjaftueshme nga inspektoret e parandalimit nga zjarri, si nga AME-ja ashtu edhe nga Komuna, etj.

**Masat parandaluese:**

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë për zjarret fushore dhe malore:

- Komunikimi me publikun, vetëdijësimi publik;
- Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve;

- Hapja e rrugëve malore për intervenim;
- Pastrimi i sipërfaqeve pyjore nga Mbeturinat dhe masa e that drusore;
- Zbatimi i masave ndëshkimore për zjarrëvënsit;
- Masat parandaluese për zjarret industriale;
- Ngritjen e Njësisë se mbrendeshme të Zjarrfikësve nga vet pronaret e objekteve Industriale siq parashihet me ligj, dhe trajnimi i tyre;
- Instalimi i hidranteve në lokacionet e bashkësive lokale, aty ku ka rrjet të Ujësjellësit;
- Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimi automatic në objketet industriale;
- Atestimi i këtyre sistemeve;

**Masat parandaluese të zjarreve në fusha/sezonale**

Bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri, autoriteti lokal në sezonën e korrje – shirjeve, janë të obliguar të marrin masa parandaluese , si:

- Formimi i komisonit komunal për korrje shirje (**Inspektimet në tëren dhe informimit në vijimësi gjatë korrje–shirjes**);
- Autokombajnat dhe mjetet pjesëmarrëse në korrje- shirje duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të pajisura me mjete (aparate) për mbrojtje nga zjarri;
- Të njoftohen qytetaret që të mos bëjn ndezjen e hamulloreve pas korrje-shirjeve;

**Rekomandimet:**

- Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente lokale (PREL);
- Krijimin e procedurave standarde operative për reagim emergjent;
- Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për kordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
- Identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioriteteve për menaxhimin e zjarreve ;
- Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
- Ngritja e kapaciteteve ( resurseve ) teknike dhe standardizimi i tyre;
- Të ngritet infrastruktura rrugore ( me qëllim të reagimit më të lehtë me mjete motorrike) në pyje dhe të të sigurohen burimet ujore, sa më afër vatrave potenciale të zjarreve për furnizim;
- Të bëhet sanimi dhe gjenerimi i sipërfaqeve pyjore, pas zjarreve të shkaktuara;
- Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret(sipërfaqet e djegura, masa drusore, bimët aromatike, bimët mjekuese dhe dëmet ekologjike) në vlerë valutore Euro;
- Arritja e memorandumeve të mirëkuptimit ndërkomunal me qëllim të ofrimit të ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit me komunat fqinje, sektorin privat dhe OJQ humanitare, në rast se paraqitet nevoja;

`

## Skenari 1 – Zjarret fushore dhe Malore

| Emri i skenarit: | **Zjarret Fushore dhe malore** |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| **X Shumë e mundshme** (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>**X Kritike: 25 deri 50% .** ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| **X- Skenari 1**; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ - I vogël ; **X I mesëm ;** ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: **(07-30)/07/2024** | |

**KONTEKSTI**

| Nr. rend. | **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|---|
| 1. | **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Vendet më të rrezikuara nga Zjarret Malore/Fushore në Komunën e Gllogocit janë:<br>1. Malet e Gradices dhe Godancit 2. Malet Dobroshecit , 3.Malet e Abris, 4. Pishat e Gllobarit, 5.Malet e Sankocit, 6. Gradic, 7. Korroticë e lart-Poklek-Vasilevë<br>Harta e e zonave te rrezikuara nga Fatekeqësit natyrore dhe fatekeqësit tjera/ Zjarreve fushore dhe malore |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 2. | **Kushtet meteorologjike** | Për disa ditë rresht gjatë muajit korrik, nga data:21.07.2024 deri më: 31.07.2024, në komunën e Gllogocit, kanë mbizotruar temperatuara të larta (prej $32^{o}C-37^{o}C$), ku si rezulatat i këtyre temperaturave janë shkaktur disa raste të zjarreve fushore dhe malore në vendbanimet e larëshënuara . |
| 3 | **Periudha e vitit:** | /Korrik/ Gusht/Shtator |
| 4 | **Lloji i ditës:** | Ditë pune dhe vikendi |
| 5. | **Analiza meteorologjike për kohën** | Mundësia për të ndodhur zjarret malore dhe fushore në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Gllogocit dhe fshatrave për rreth. Për çdo vit kanë ndodhur zjarre malore dhe fushore me demtime të masës drunore dhe dëmtime të ambientit , kurse nëse e marrim 10 vjeqarin e fundit sipas statistikave të marruara nga NJPSHZSH kemi pasur gjithësejt **324** zjarre malore dhe **1193** zjarre fushore në zona të ndryshme të komunës, që dmth se pothuajse për çdo vit kemi kemi pasur kërcënime nga zjarret (2015-2025). |

| | | |
|---|---|---|
| | | Koha e paraqitjes së këtyre zjarreve ishte ne periudhat korrik/gusht/shtator , ku si pasojë e zjarreve në Gllogoc, ka edhe demtime të maleve dhe kullosave, dhe njëhërit edhe ndotje të ambientit. |
| 6. | **Popullata** | Si rezulatat i zjarreve malore dhe fushore, kanë qenë të rrezikuara edhe shtëpit afër këtyre maleve, e konkretishtë lagja Fazliu, por nuk kanë pasur nevoj për evakuim. |
| 7. | **Infrastruktura kritike egzistuese** | Nuk ka pasur infrastrukturë ekzistuse të rrezikuar drejtpërdrejt, por në mënyrë indirekte ka mundur të rrezikohen shtëpit e banimit. |
| 8. | **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | Gadishmëria e Shërbimit të Zjarrfikësve si dhe edukimi qytetarë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore ( popullatë rezistente nga FNFT), në këtë rast janë premisa që ndihmojnë në masë të madhe zvogëlimin e rreziqeve përmes kampanjave vetëdijësuese, edukimit shkollorë, udhëzuesve (fletë-palosjeve), ushtrimeve të ndryshme, etj.<br><br>Kryetari i Komunës së Gllogocit ka ndërmarr masat dhe aktivitetet e nevojshme për reagim emergjent për shuarje të Zjarreve, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal (PREL), ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>Janë marr të gjitha masat enevojshme parandaluese për mbrojtje nga zjarret për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes. Mobilizimi i Ekipeve të Zjarrfikësve kanë qenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur ne resurset reaguese lokale që I kan në disponimdhe po ashtu u janë dal në ndihmë edhe disa vullnetar të fshatrave. |
| 9. | **Info plotësuese** | Informacione të besueshme për gjendjen nga terreni, raporte vlerësuese, raporte përkatëse institucionale, etj.<br>Pas zjarreve të shaktuara për shkak të tmperaturave të larta, në malet e disa fshatrave të komunës se Gllogocit, janë shkaktuar deme të konsiderueshme të masës drunore dhe në disa raste edhe zjarre në grunaja dhe me ketë rast janë dëmtuar pjesërisht mbi 25 Ha male dhe mbi 2 Ha Grunaja. |
| **INCIDENTI-NGJARJA** | | |
| 21 | ,,Butrinti Petrol'' | Komoran | Bujar Zogaj | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 22 | ,,Ip-Petrol '' | Komoran | Visar Lajqi | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 23 | ,,Kastrati Petrol '' | Komoran | Kushtrim Kastrati | Privat | 2x45000 lit n/b |
| 24 | ''Ar Benz,, | Komoran | Milaim Zogu | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1X8000 lit b/p |
| 25 | ,,Kabashi Petrol,, | Çikatovë e Re | Ismet Kabashi | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 26 | ,,Benita Corporation'' | Korroticë e Epërme | Nexhat Kalludra | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 27 | ,,Hib Petrol '' | Llapushnik | Kujtim Bucalia | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |

`

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 28 | ,,Rreze K'' | Polluzhë | | Privat | 2x45000 lit n/b |
| 29 | ,,Exfis'' | Korroticë e Epërme | Lum Muharremi | Privat | 2x15000 lit n/b |
| | | | | | 1x5000 lit b/p |
| 30 | ,,Exfis'' | Llapushnik | Lum Muharremi | Privat | 2x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 31 | ,,Ip Kos Sh.p.k '' | Arllat | | Privat | 3x30000 lit n/b |
| | | | | | Nuk posedon b/p |
| 32 | ,,Petrol Company '' | Arllat | Shkelzen Jusaj | Privat | 2x45000 lit n/b |

**Masat parandaluese:**

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë për pompat e derivateve:

- Komunikimi me përfaqësuesit e bizneseve që merren me këtë veprimtari që ata të jenë vëdijshëm për pasojat e mundshme,në rastë të shpërdhimit të këtyre zjarrëve;
- Kontrollimi i aparateve për mbushje të derivateve;
- Përseritja e atesteve të matjeve të rezistencës të tokëzimit dhe rrufepritësit;
- Mirëmbajtja e pikës matëse të elektriciteti statik;
- Ngritjen e Njësisë se mbrendëshme të Zjarrfikësve nga vet pronaret e objekteve të derivateve të naftës siq parashihet me ligj, dhe trajnimi i tyre;
- Mbajtja e protokoleve të rregullta të mirëmbajtjës siq janë:Atestet e matjeve të valvulave siguruese të rezervuarve të Gasit; Pastrimi i rezervuarve të derivateve të naftes qdo 5 vite dhe mirëmbajtja e sistemeve elektrike;
- Rimbushja dhe servisimi i aparateve për shuarjen e zjarrit qdo 6 muaj;
- Instalimi i hidranteve në Objektet e derivateve të naftës;
- Instalimi I detektorve të gazit dhe zjarrit, të lidhur me sistemet automatike të Alarmit;
- Atestimi i këtyre sistemeve;
- Kontrolli i automjeteve furnizuese për rrjedhje, pastrimi të rregullt dhe respektim të standarteve gjatë ngarkim-shkarkimit;
- Inspektimi nga zyrtari pë hulumtimin e shkaqeve të zjarrit qdo 3 muaj tek objektet e pompave të derivateve,dhe për qdo parregullsi të lëshojë procesverbalet,në rastet që nuk i përmbushin masat për mbrojtje nga zjarri, atëherë pasojnë gjoba.
- Hartimi i raporteve të expertve të zjarrit, për sëcilin objekt të derivateve në naftes dhe Gazit;
- Të gjitha pompat e derivateve duhen të jenë të kompletuara me pajisjet për masat mbrojtëse kunder zjarrit;
- Të vëndosen vendosen tabelat paralajmruese dhe udhëzime të dukshme në të gjitha zonat kritike si ("Ndal Duhanin", "Zonë me rrezik Zjarri").

**Rekomandimet:**

- Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente;
- Krijimin e procedurave standarde operative për reagim emergjent;

- Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për koordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
- Identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioriteteve për menaxhimin e zjarreve;
- Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
- Ngritja e kapaciteteve ( resurseve ) teknike dhe standardizimi i tyre;
- Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret (në pompat e derivateve të naftës) në vlerë valutore Euro;

**Skenari 3 – Zjarret në pompat e derivateve të naftës dhe Gasit**

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit: | Zjarret në pompat e derivateve të naftës dhe Gasit |
| Frekuenca e ndodhjes: | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>**X Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);**<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| **X E papërfillshme (më pak se 10%)** ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐ - Skenari 1; ☐ -Skenari 2; **X -Skenari 3;** | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **x - I vogël ;** ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| | |

KONTEKSTI

| Nr. rend. | Parametrat: | Përmbajtja: |
|---|---|---|

`

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Vendi i ngjarjes<br><br>(lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga Zjarret e mundëshme në pompat e derivateve të naftës dhe gasit, janë pompata që gjindën në rrugën rajonale prej Kroit të Mbretit deri  në Arllat ,pastaj rrugën magjistarle prej Komoranit deri në Polluzhë, dhe ato që gjinden  në rruget lokale të zonave rurale,  ku në komunën e Gllogocit janë gjithësejt **32 pompa (objekte)** të derivateve të naftës:<br><br>Harta me lokacionet e pompave të derivateve në Komunen e Gllogocit<br><br> |
| 2. | Kushtet meteorologjike | Për disa  ditë rresht gjatë muajit korrik, dhe gusht në komunën e Gllogocit, kanë mbizotruar temperatuara të larta (prej 32$^{o}$C-37$^{o}$C), ku si rezulatat  i këtyre temperaturave mundë të shkaktohën zjarre në lokacionet në pompat e derivateve të naftës të paraqitura në institut. |
| 3 | Periudha e vitit: | Gjatë tër vitit |
| 4 | Lloji i ditës: | Çdo ditë ditë pune |
| 5. | Analiza meteorologjike për kohën | -Po , këto zjarre mund të ndodhin nga pakujdesia, ne rastet kur nuk përmbushen kriteret për masat mbrojtse kunder zjarrit, dhe nuk varen shumë nga kushtet meteorologjike, por mund te jenë më të shprehura në muajt e veres , kur temperaturat janë të larta, dhe mund të shfaqen zjarre afër këtyre objekteve. |
| 6. | Popullata | Në rast të zjarreve të mundëshme, me të rrezikuara do të jenë banoret dhe objektet që janë afër tyre. |

| | | |
|---|---|---|
| 7. | Infrastruktura kritike egzistuese | Nuk ka pasur infrastrukturë ekzistuse të rrezikuar drejtpërdrejt, por në mënyrë indirekte ka mundur të rrezikohen shtëpit e banimit që janë afër tyre. |
| 8. | Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | - Gadishmëria e Shërbimit të Reagimit Emergjent si dhe edukimi qytetarë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore ( popullatë rezistente nga FNFT), në këtë rast janë premisa që ndihmojnë në masë të madhe zvogëlimin e rreziqeve përmes kampanjave vetëdijësuese, dhe inspektimeve në pompat e derivative të naftës.<br><br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga zjarret nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes. Mobilizimi i Ekipeve të Zjarrfikësve me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Kryqi i Kuq Komunal (KKK), OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| 9. | Info plotësuese | Kemi marr informacione të besueshme për gjendjen nga terreni, raporte vlerësuese, raporte përkatëse institucionale, etj.<br><br>Inspektoret komunal, kan bërë inspektime të të gjitha pompat e derivateve të naftës, dhe kanë dhënë rekomandimet e tyre , që të gjithë OE të pompave të derivateve të naftes dhe gasit të jenë të pajisura me të gjitha masat e nevojshme për Parandalimin dhe mbrojtje nga zjarri, dhe me këtë rast kanë lëshuar procesverbalet si dëshmi e inspektimeve të kryera. |
| INCIDENTI-NGJARJA | | |
| 10. | Shkaku dhe shkaktari | Si shkatar i mundëshem i zjarreve llogaritet mos zbatimi i masave për mbrojtje nga zjarri, duke përfshirë mungesen e aparateve për shuarje të zjarreve( ose mos rimbushja e tyre sipa afteve ligjore), mungesa e atesteve të matjeve për rezistencen e tokzimit dhe rruferitësit sipas normave ligjore, mungesa e atesteve të ventilave sigurisë të rezervuarve të gasit dhe naftës, dhe temperaturat e larta gjatë periudhes se verës të cilat mund të shkaktojn Zjarre, si rezultat e këtyre mangësive. |
| 11. | Ngjarja kryesore | Nuk kemi shenime nga NJPSHZSH, por ndonjë intervenim direkt nga këto raste, por ekzistojn mundësit që mundë të ketë shpërthime të zjarreve, pasi që këto përdorin lëndë ndezëse, dhe potenciali është I lart për mundësin e këtyre zjarrve. |

`

| | | |
|---|---|---|
| 12. | Pasojat primare dhe efektet anësore | -Pasojat në këto raste do të ishin të mëdha, sepse kemi të bëjm më lëndë djegëse që shkaktojn shpërthime të fuqishme, dhe dëme të mëdha. |
| 13. | Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti | Vështërësi për qarkullim në trafik: nese do të këtë zjarre , sigurisht që do të ketë vështersi në qarkullim për shkak detonimeve dhe të tymit të dendur që mundë të krijohet për shkak të zjarrit;<br><br>Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante: **Jo**<br><br>Kërcënimi për mundësinë e çfaqjes së ndonjë epidemije( si pasojë e kafshëve të ngordhura, zjarret , etj) , **Nuk ka;**<br><br>Pasojat nga këto lloje të zjarreve në aspektin mjedisor do të jenë evidente sepse mundë të ndikojn në ndotje të ajrit në ato vendbanime dhe ato që janë afër tyre. |
| NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES | | |
| 14. | Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet |
| 15. | Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar; | Pasi që nuk kemi raste të zjarrve, nuk kemi pasur edhe përsona ta lënduar. |
| 16 | Mungesë e nevojave elementare | - Nuk ka pasur mungesë të gjerave elementare. |
| 17 | Të evakuuarit | -Nuk ka pasur nevojë për evakuim, sepse nuk ka pasur të lënduar. |
| 18 | Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në aspektin e ambiental dhe ekonomik do të ishin kritike, në raste të zjarreve |
| 19 | Ndikimi në natyrë dhe mjedis | -Do të kishte ndikim mjedisor të theksuar, sepse dëmet në rastet e tilla të zjarreve do të ndikonin në ndotje të theksuar të ambientit. |
| 20 | Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Nuk ka pasur ndërpreje të aktiviteteve në jetën e përgjithëshme. |
| 21 | Humbje në trashëgimi kulturore | Nuk do të kishte objekte të kultit të dëmtuara si pasojë e këtyre zjarrëve pasi që nuk ka objekte fetare afër këtyre objekteve. |

| | | |
|---|---|---|
| 22 | Implikime politike | Nuk ka pakënaqësi nga komuniteti, për shkak të favorizimeve dhe nepotizmit, implikime nga aktet politike opozitar, nuk priten shprehje e paknaqësisë me potencial për trazira dhe revoltë të komunitetit; |
| 23 | Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i nivelit të ulët |
| PROBABILITETI-GJASAT | | |
| 24 | Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin sasior dëshmon që të dhënat e ofruara nga NJPSHZSH,tregonë për një shkallë të pa përfillshme të ngjarjeve të tilla, prandaj probaliteti i ndodhjës i këtyre ngjarjeve është i ulët. |
| 25 | Paralajmërimi i hershëm | -Informimi publik për temperaturat e larta që do të mbretrojnë ka qenë me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të shfaqjeve të zjarreve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br><br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me planin komunal për reagim emergjent(PREL) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, ueb-faqe e Komunes, internetit, etj. |
| 26 | Masat parand. gjatë periudhës së paralajm.<br><br>të hershëm | Janë bërë inspektimet nga Inspektoret e mjedisit nëpër objektet e derivative të naftës, ku u janë dhënë edhe rekomandimet e nevojshme që të jënë të pajirur<br><br>Ngritja e gatishmëris se kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, ku në këtë rata të NJPSHZSH-së; |
| 27 | Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes | -Faza akute e ngjarjes zgjati 1 (një) ditë.<br><br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjës është e gjatë për shkak të dëmtimeve që mundë të shkaktohën nga këto zjarre. |
| 28 | Koordinimi | -Në rastë nevoje do të bëhet koordinimi përmes QOE -112 të AME-së dhe të gjitha strukturave të funksioneve mbeshtetëse (FME), sipas PSO do të njoftohen organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PREL; -Menaxhim dhe koordinim i situatës nga Entitetet Koordinuese dhe menagjuese; |
| 29 | Informata plotësuese | Nuk ka info plotësuese;**Nuk ka** |

`

**Probabiliteti/Gjasat:**

Sipas kritereve në tabelë, ngjarja e zjarreve në pompat e derivateve të naftës, sipas shenimeve të nxjerrura nga NJPSHZSH mund të klasifikohen si:

Si fatkeqësi e papërfillshme, 1 ngjarje në 100 e më shumë, pra probabiliteti i ndodhjes p< 1%.

Treguesit e probabilitetit.

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti /gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar dhe që janë afër këtyre objekteve është relativisht i lartë andaj edhe pasojat për jetën dhe shëndetin e njerëzve mundë të kenë pasoja mesatare.

Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut |
|---|

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

Pasqyrimi i pasojave në ekonomi: përcaktohen në raport me bruto-produktin e brendshëm në Republikën e Kosovës, për zonën e prekur.

-Demonstrimi i pasojave për stabilitetin social/ dëm material ndaj infrastrukturës kritike;

-Dëmet materiale në infrastruktur dhe pajisjet mund të jenë të larta për shkakë të intensitetit të lartë të zjarrëve.

- Pasojat në ekonomi të shkaktuara nga vërshimet, përllogariten në raport me bruto-produktin e GDP-së së Republikës së Kosovës për zonën e prekur.

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

Pasojat ekonomike

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social, dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike

Nuk kemi ndonjë vlerësim të dëmeve, pasi që nuk kemi pasur raste që zjarreve që kana shaktuar dëme matariale. Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike

| Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike | | | |
|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm i objekteve me rëndësi të veqantë:

| Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë: | | | |
|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
| 1 | Të papërfillshme | < 0.5 % GDP | |
| 2 | Të vogla | 0.5 -1 % GDP | |
| 3 | Mesatare | 1 – 3 % GDP | |
| 4 | Kritike | 3 – 5 % GDP | |
| 5 | Katastrofike | > 5 % GDP | |

**Matrica 1:** Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:




**Matrica2:** Rreziku për pasojat në ekonomi:




**Matrica 3a:** Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:

**Matrica 3b:** Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:

**Matrica përmbledhëse: 3a dhe 3b**, pasqyron rrezikun rrezikun për stabilitet shoqëror:




**Matrica 4:** Pasqyron rrezikun e përgjithshëm



# 6.6 TËRMETET

## 6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik

Territori i komunës se Gllogocit është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikro- sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore. Tërmeti pasqyron përplasjen/luhatjen e pllakave të tokës si pasojë e lirimit të energjisë së brendshme të tokës. Nga pikëpamja sizmologjike territori i Komunes sonë paraqet aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet e forta. Territori i Komunës sonë, në të kaluaren është përfshirë nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton, ku si karakteristikë e veqantë mund të themi se janë vatrat e cekëta, të cilat gjenerohen në afërsi të kores së tokës, maksimumi i thellësisë së vatrave mund të jetë 15 - 20 km thellë në nëntokë. Studimet e sizmicitetit varen shumë nga informacioni që disponohet nga plotësia dhe besueshmëria e të dhënave mbi tërmetet që paraqiten në katalogun e tërmeteve. Ngjarjet sizmike tregojnë se brenda 20 viteve të fundit vendi ynë është goditur me tri tërmete me magnitude mesatare, me madhësi 3.1-5.7 , pa viktima njerëzore por me dëme materiale.

## 6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara , numri dhe struktura e banorëve

Sipas të dhënave nga EMC/CSEM, **me 13 maj 2024** u regjistrua një tërmet me magnitudë 2.8-3.1 shkallë Rihter, me epiqender rreth 6 km në jugpërendim të Gllogocit, në një thellësi rreth 15 km.

Edhe pse muk ka pasur tërmete me epiqendër të drejtëpërdrejt në Gllogoc, dridhjet e tërmetit nga Gjilani ( 2002) dhe Istogu (2010) , mund të jenë përceptuar, veqanarisht nga ato me magnitud të moderuar dhe pa pasoja.

## 6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara

Komuna e Gllogocit shtirhet në zones sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS, prandaj edhe nuk kemi Zona shumë të rrezikuara nga termetet.

## 6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve)

Si rezultat i burimeve nga shërbimet sizmologjike në vend dhe rajon, sidomos nga Instituti Sizmologjik i Kosovës, egzistojnë të dhëna më të plota për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës që nga periudha kohore, nga vitet 1900 kurse të dhënat/informacionet e mëhershme janë mjaft të pakta. Këto tërmete që kanë prekur teritorin e kosovës, ku më shumë e ku më pak kanë goditur edhe komunën tonë.. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur vendin tonë ,në 20 vitet e fundit mund të përmendim:

1. Tërmeti i Gjilanit 24.04.2002, **Mag.5.7, intensiteti VIII**
2. Tërmeti i Istogut 10.03.2010, **Mag.5.2, intensiteti VII**

3. Tërmeti i Vushtrrisë 18.11.2013, **Mag.4.8, intensiteti VI**

*Table 61 Disa nga tërmetet më të forta që kanë goditur teritorin e Kosovës ndër vite*

| Location of earth. | Magnitude | Intensity |
|---|---|---|
| Prizreni 1456 | MS=6.1 | VIII1/2 |
| Peja 1662 | MË=6.0 | VIII1/2 |
| Ferizaj-Viti 1921 | M l=6.1 | IX |
| Viti.1921 | Ml = 5.4; | VIII |
| Gjilan 1921 | Ml = 5.0; | VIII |
| Kaçanik-Viti 1921 | Ml = 5.6 | VIII |
| Gjakova 1922 | Ml = 5.3 | VII1/2 |
| Prizren 1945 | Ml = 5.0 | VII |
| Klina 1947 | Ml = 5.2 | VIII |
| Kopaonik 1980 | MË=5.7 | VIII |
| Gjilani 2002 | MË=5.7 | VII-VIII |
| Istog 2010 | Ml = 5.2 | VII |
| Vushtrri 2013 | MI=4.8 | VI |

### *6.6.5.*Pasojat e tërmeteve

Për shkak të shpeshtësis se vogël të tërmeteve dhe magnitudës se ultë që kanë ndodhur në komunën tonë, nuk kemi raporte të vlerësimit të dëmeve të shkatuara nga to.

### Masat parandaluese;

Ndërmarrja e masave parandaluese, me qëllim të zvogëlimit/zbutjes së rrezikut sizmik, janë e vetmja mënyrë efektive për t'u mbrojtur nga tërmetet:

- Rregullat për ndërtime sizmike;
- Ligje dhe rregullore bashkëkohore për ndërtimet sipas Eurokodit 8;

- Mbikqyrjen strikte të zbatimit të rregulloreve;
- Mbikyrja e e projekteve gjatë ndërtimit të objekteve, të cilat kanë marrë leje ndërtimi,
- Kontrollimi dhe revidimi i projekteve zbatuese, në mënyrë që ato në fazen e statikës të jenë të projektuara sipas Eurokodit 8;
- Kontrollet periodike të hartave sizmike;
- Implementimi I studimit të mikro-zonimit për secilin qytet( Zona urbane);

*Figure 21 Hartat seizmike*



*Figure 22 Harta e sizmicitetit për teritorin e Kosovës, Epiqendrat e tërmeteve me magnitudë ≥ 3.5, Periudha 1456-2021*



**Zonat kryesore burimore sizmike:**

1. Zona sizmogjene Prizren-Pejë;
2. Zona sizmogjene Ferizaj-Viti –Gjilan;
3. Zona sizmogjene e Kopaunikut;

*Figure 23 Harta e rrezikut sizmik për teritorin e kosovës, viti 2009*[5]




**Skenari (Tërmeti):** Pasi që nuk kemi pasur raste të Tërmeteve me pasoja në njërzë dhe Dëme të theksuara materiale, atëherë nuk po bejm skenar, përpos që do të mbahet Ushtrime lidhur me mënyrën e reagimit Emergjent, në raste të tilla, dhe gjatë këtyre viteve kemi ber me teper se 3 ushtrime lidhur me tërmetet, e sidomos tek ndërtesat e banimit shumëbanesor.

[5] Harta është marrë nga Instituti Seizmologjik i Kosovës

`

# 6.7. RRËSHQITJET DHE PËRMBYTJEET

## 6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe përmbytjeve

Në Komunën e Gllogocit nuk kemi raste të raportimit të dokumentuar të përmbytjeve të tokës, megjithatë, kjo nuk nënkupton, se nuk ka pasur problemet individulale në teren, por nuk janë evidentuar apo dokumetuar në mënyrë zyrtare.

Pra vlenë të theksohet që nuk kemi kemi përmbytje të krijuara nga natyra, por kemi lokacione që mund të paraqiten përmbytje artificiale/Gropa/ të shkaktuara nga eksploatimet e zhavorit nga gurthyesit, dhe eksploatimet xehes se Feronikelit, por më ligj, kërkohet që pas përfundimit, ata janë të dëtyruar që gropat e krijuara t'i kthejnë në gjendjen e më parshme.

## 6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes;

Kushtet klimatike, ndikojn shumë në shpërfaqjen e pasojave nga përmbytjet artificiale, pra nga gropat ku janë berë eksploatimet e gurit dhe xeheve, sepse si rezultat i shirave, po krijohen liqej artificial, që pastaj, paraqesin rrezik për mbytje të fëmijeve që frekuentojn në ato zona.

## 6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe përmbytjet, numri i banorëve, objekteve, lloji i tyre, pasqyra e lokacioneve kritike;

Sipas shënimeve të marrura nga Drejtoria e Inspeksionit, kemi 6 lokacione ku janë krijuar përmbytje artificiale, dhe për të cilat janë bërë inspektimet nga inspektoret komunal dhe ata Republikan dhe kanë kërkuar që të mirren masa parandaluese.

## 6.7.4. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive);

Zonat ku janë krijuar këto gropa, nuk mund të kenë rreshshqitje aktive, por mundet të kenë rreshqitje pasive për shkak të reshjeve të shiut, por më një intezitet të ulët.

## 6.7.5. Sipërfaqet e përfshira;

Për madhësin e sipërfaqeve të përfshira nga përmbytjet artificiale janë bërë matje të përafërta dhe janë 6 lokacione me siperfaqe prej 200.43Ha, ndersa lokacionet janë të evidentuara në harten e paraqitur me poshtë , ku me ngjyrë të kyqe në hartë janë këto lokacione: Gurthyesi i Qikatovës se Vjeter, Korroticë e Eperme, Gropat tek Feronikeli në Qikatovë të vjeter, Gurthyesi në Baicë.

## 6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet;

Pasojat e mundëshme nga përmbytjet artificiale të krijuara gjatë ekesploatimit të xeheve dhe gurit, do të ishin e nivelit të **Ultë** sa i përket Gjasave ato mund të jenë të **Mundëshme.**

**Masat parandaluese;**

Masat Parandaluese që duhet të mirren nga ana e shfrytëzuesve të këtyre xeheve dhe guroreve janë të përcaktuara edhe me ligjin 04/L-158 për Minierat dhe Mineralet dhe Rregulloreve e Udhëzimeve të KPMM;

- Respektimi i plotë i kushteve dhe kritereve që janë paraparë në Licencë,
- Zbatimi i planit  të Vlerësimit në Mjedis, i hartuar nga expertet e fushës për secilen minierë,
- Rehabilitimi i lokacioneve, në pajtim me Planin e mbylljes se Minierave, ku përfshinë:
  - I. Mbylljen e sipërfaqeve të eksploatuara,
  - II. Mbulimi i sipërfaqeve me dhe ,
  - III. Ripyllzimin  këtyre sipërfaqeve më drunjë,
  - IV. Hartimi i raportit përfundimtar i shfrytzuesit të liqencë

*Figure 24 Harta e rreziqeve*




**Skenari ;**

Pasi që nuk kemi pasur raste nga përmbytjet tek këto raste atëherë dhe nuk kemi nevoj për skenar, pasi që edhe licencat lëshohen nga Ministria dhe KPMM, dhe obligojn OE, që të përmbushin kriteret e parapara me ligj.

## 6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT;

### 6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me  të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave;

Karakteristikat e terenit dhe zonave me më të reshura nga bora, janë kryesisht zona malore dhe rrugë të rrethuara me male, andaj edhe  mundë të paraqiten edhe orteqe dhe ngrica të kohëpaskoshme gjatë sezonit të dimrit, sidomos në  rruget lokale të fshatrave Gradicë, Likoshan, Abri, Terdec, Gjergjicë,Dobroshec etj,

### 6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat  ekstreme;

Po në bazaë të statistikave të marrura nga IHMK, gjat tri viteve të kaluara, temeraturat mesatare e muajit

janar është nga 0⁰C, ndersa ato minimale arrin afër -3.4⁰C, me kohëzgjatje intezive jo me shumë se 5-7 ditë, si dhe reshje të borës me intezitet të ultë, dhe komuana e Gllogocit mesatarisht ka rrethë 26 dit më reshje bore në vit, dhe reshjet e borës në zonat malore mund të arrijn deri 54 cm në vit.

### 6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica

Pasojat nga reshjet e Borës dhe ngricave, mundë të konsiderohet si të nivelit të **ultë**, ndërsa **Gjasat** janë të **Mundëshme.**

Nga statistikat që kemi si DSHPE, pasi që edhe e kemi edhe projektin e Mirëmbajtjes se rrugëve gjat dimrit, kemi një numer të vogel të aksidenteve që kanë ndodhur si pasoj e bores dhe ngricave,e kryesisht si pasoj e mos përfilljes se shpejtësis se ngasëve të automjeteve apo edhe mungesa e pajisjeve dimore( gomat e dimrit. Zingjirve, frenave etj).

#### Masat parandaluese

Komuna e Gllogocit si masa parandaluese për parandalimin e rreziqeve të mundëshme gjatë dimrit ndërmerr këto masa :

- Pastrimin e borës nga rrugët dhe trotuaret;
- Kriposjen dhe rërimin e rrugëve,
- Sinjalizimi me shenja të rrezikut në rrugët malore, ku reshjet e borës janë me të theksuara,
- Koordinimi me Policinë, që të ketë patrollime me të shpeshta të ngasësve të automjeve në respektim të kushteve të shpejtësis dhe pajisjeve dimrore.

*Figura 25 Harta e rreziqe*



# 6.9. BRESHËRI

## 6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri;

Zonat më të prekuara nga Breshëri janë zonat Malore të fshatrave Gradicë, Dobroshec, likoshan, por edhe të fshatrave të tjera, sidomos gjatë muajit qershor dhe Korrik.

## 6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik;

**Gjasat** e paraqitjes se reshjeve të breshërit janë 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme anadaj karakterizohen si **të Mundëshme,** ndërsa **Pasojat** janë të kategorizuara si të **Mesme.**

## 6.9.3. Pasojat nga breshëri;

Pasojat nga bresheri, janë të evidentuara kryesisht si dëme në bujqësi (në kultura bimore por edhe ato frytore), por edhe në objekte banimi dhe në automjete, për cilat dëme , komisioni komunal i cili është formuar me Vendim të kryetarit të komunës, kanë dal në teren dhe kanë bër vlerësimit e dëmeve në 263 raste, si me poshtë:

**I.** Në bujqësi janë vlerësuar gjithësejt 183 raste me vlerë të dëmit prej: **162,794.19€,**
II. Në objekte banimi janë vlerësuar gjithësejt 76 raste me vlerë të dëmit prej: **52,510.68€,**
**III.** Në automjete( vetura) janë vlerësuar gjithësejt 4 raste me vlerë të dëmit prej:**15,594.19€**

*Figure 26 Harta e rreziqeve*



**Masat parandaluese**

Komuna e Gllogocit si masa parandaluese për parandalimin e rreziqeve të mundëshme gjatë reshjeve të breshërit, propozon:

- Informimi dhe paralajmrimi me kohë, duke bër instalimin e sistemeve të paralajmrimit të hershëm , përmesë aplikacioneve të motit, radarë dhe alarme locale;
- Fushata vetdijesuese për fermer;
- Vendosja e sistemit të mbrojtjes se pemëve me rrejta plastike , kopshte dhe plantacione të pemëve, vreshtave, ose kultura të tjera;
- Sigurimi i të mbjellave nga dëmtimet klimatike (breshërit) përmesë skemave të sigurimit bujqësor.

**Skenari:**

Nuk kemi hartuar skenarë për këtë lloj rreziku sepse është vlerësuar si rrezik me gjasta të **mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme) ,** me pasoja të mesme.

## 6.10. ORTEKËT

### 6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga ortekët;

Karakteristikat e terenit dhe zonave me më të reshura nga bora dhe krijimi i ortekëve, janë kryesisht zona malore dhe rrugë të rrethuara me male, mirëpo munësia e paraqitjës së tyre është minimale, pothuajse e papërfillshme sepse nuk janë paraqitur orteke të mirëfillta por ekziston munësia e krijimit të smeteve të borës dhe ngrica të kohëpaskoshëme gjatë sezonit të dimrit, sidomos në rrugët lokale të fshatrave Gradicë, Likoshan, Abri, Terdec, Gjergjicë, Dobroshec etj

### 6.10.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;.

Po si vendbanime që mund të paraqiten dhe krijohen smetet e borës janë rrugët lokale të fshatrave malore në Gradic, Abri dhe Terdec, por këto smete janë të vogla dhe nuk paraqesin ndonjë pasoj në njerëz dhe ndërprerje më kohëzgjatje të madhe të levizjes së banorve të atyre fshatrave, sepse do të reagojnë menjehere opertaorët ekonomik që janë të kontraktuar për pastrimin e rrugëve.

### 6.10.3. Treguesit statistikor të pasojave nga smetet e borës;

Statistikat që janë nxjerrë nga menaxheret e projektit për projektin e Mirëmbatjës se rrugëve gjatë dimrit, tregojnë se janë raste të rralla dhe me intenzitet të ultë.

**Masat parandaluese;**

- Pastrimin e borës nga rrugët, duke i pasë prioritet rrugët ku mund të paraqiten smetet e borës;
- Kriposjen dhe rërimit e rrugëve,
- Sinjalizimi me shenja të rrezikut në rrugët malore, ku reshjet e borës dhe krijimi i mundëshem i smetve të bores janë me të theksuara,

- Koordinimi me Policinë, që të ketë patrollime me të shpeshta të ngasësve të automjeve në respektim të kushteve të shpejtësis dhe pajisjeve dimrore.

*Figure 27 Harta e rreziqeve nga Ortekët*




**Skenari:**

Nuk kemi hartuar skenar për këtëë lloj rreziku për faktin se gjasat e ndodhjes janë të mundshme (gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme), andaj edhe nuk kemi hartuar skenar.

## 6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË

Komuna e Gllogocit nuk njihet si zonë e cila atakohet me Erëra dhe stuhi të fuqishme, dhe nuk kemi raste të shpeshta të dokumentuara lidhur me to.

Kanë ndodhur disa raste sporadike me erëra, të cilat kanë shkaktuar dëme të vogla në kopshte sidomos në sera, ku kanë bërë dëmtimitn e mbulojave të serave, e ka ndodhë që kanë dëmtuar pjesërisht edhe ndonjë kulm të objekteve të banimit.

### 6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale;

Kemi raste sporadike të ndodhjes se erërave, por nuk ka zona specifike që mund të përmendim dhe që janë të dokumetuara për raste të erërave të fuqishme.

## 6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;

Si Vendbanime specifikisht që mund të dokumentojm që kanë ndodhur erëra  por jo stuhi të fuqishme, por si vendbanime që kanë ndodhur është fshati Damanek, Krajkovë, Qikatovë e Re, dhe një pjesë e qytetit të Gllogocit  që janë afer maleve të Kosmaqit, por këto zgjatin në përiudha të shkurtëra kohore, dhe janë me perioda të përseritura në  stinen e vjeshtës dhe fillim të pranveres.

## 6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë ;

Statistikat tregojn se erërat dhe stuhit në Gllogoc janë të rralla, andaj edhe dëmet e krijuara nga erërat janë minimale, dhe nga shenimet që disponojm nga DSHPE-ja, kemi një rast  në muajin nëntor  të vitit 2015, ku janë paraqitur erëra të cilata kanë shkaktuar dëme në objekte banimi (në kulmet e shtëpive), andaj komisioni komunal për vlerësimin e dëmëve kanë dal në teren dhe kanë bërë vlerësimin e këtyre dëmëve,  dhe nga ky raport vlen të  theksohet se kemi pasur **36** kërkesa për vlerësim të dëmeve në objekte banimi, dhe vlera e dëmeve të vlerësuara është  **35, 523 .00€.**

*Figure 28 Raport i komisionit për vlerësimin e demeve*



**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA E DRENASIT**
**DREJTORIA PËR SHËRBIME**
**PUBLIKE DHE EMERGJENC**
**Nr.** 13-400-66801
**03/12/2015**

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente në bazë të kompetencave të saj, dhe në bazë të Aktvendimit me nr.553-1764  për Vlerësimin e dëmëve të shkaktuar nga fatkqësitë natyrore , nxjerrë këtë:

**RAPORT**
**I KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMËVE**

Komisioni i caktuar nga DSHPE, prej dt.23/11/2015 deri me dt. 01/12/2015  ka pranuar gjithësej 36 kërkesa nga qytetarët për dëmët e shkaktuar  nga fatkeqësitë natyrore me dt.21/11/2015.

Komisioni pas përfundimit të punës në teren ka hartuar raportet për secilin pronar të objektit të dëmtuar.

Të dëmtuara kanë qenë objekte banimi , kulma të institucioneve shkollore dhe objekte tjera ( shtalla , pleme,garazha  etj. ) .

Vlera e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësit natyre  është gjithësej 35,523,00 € (me fjalë tridhjetë e pesmijë e pesqindë e njëzet e tri euro).

Vlenë të ceket se gjatë vizitës në teren kemi hasur në katër familje të cilat janë të dëmtuara dhe të rrezikuara për ekzistencën. Këto katër familje e kanë veshtirë t'i përballojnë ditëve të ftohta  të dimrit, pasi që shtepitë e tyre janë  të vjetra dhe të dëmtuara nga erërat  dhe shiu.

Pronarët e këtyre shtëpive janë:
Agron Podrimçaku nga fsh. Krajkovë,
Izet Lladrovci nga fsh.Gllanasellë dhe
Milaim Bajrami nga Fushtica e Epërme
Salih Bytyqi nga Çikatova e Re

Ndërsa , familjet tjera nuk janë në rrezik dhe kanë mundësi të bëjnë riparimet e kulmeve të shtepive.

Komisioni :
1. Ragip Nishori________
2. Shpend Bogiqi ________
3. Sejdi Kozhani ________

### Masat parandaluese;

Si komision për hartimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikut, kemi propozuar këto masa parandaluese për erërat;

I. Informimi me kohë nga IHMK- lidhur me erërat  dhe stuhit e mundëshme,
II. Kufizimi  i levizjes në kohën  e ndodhjes se tyre, sepse mund të pësojn aksidente,

III. Mos qendrimi afër pullazeve të objekteve të vjetra dhe vendeve/rrugëve/ ku ka bimë dekorative, sepse ato mund të rrezohen dhe shkaktojn pasoja në njerëz dhe në objekte.

## 6.12. THATËSIRAT

### 6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike;

Tri vitet e fundit në Komunën e Gllogocit, gjatë muajve të veres (qershor, korrik, gusht), ka mbretruar një mot i thatë dhe me pak të reshura atmosferike të shiut, dhe temepratuara mestare rreth 35$^{o}$C, të cilat kanë shkatuar thatësira, dhe munges të ujit në disa fshatra.

### 6.12.2. Dëmet dhe pasojat;

Dëmet nga pasojat e thatësis, janë kryesisht në buqësi, sidomos në ato zona/vendbanime/ ku nuk janë nën sistemin e ujitjes, kryesisht në të mbjellat me misër, lulediell i, fasule , sera , pemishte, etj. Por nuk kemi të dokumentuara raporte konkrete për sasin e dëmeve, pasi që nuk kemi pasur kërkesa nga ana e fermerve të zonave.

### 6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;

Kemi disa fshatra që si pasoj e mungeses së reshjeve gjatë muajve të verës, kanë munges të ujit të pijës, sidomos disa familje në fshatin Polluzhë (Lagja lstogu), Abri, Vërboc.
Në drejtorin e DSHPE-së kemi pranuar disa kërkesa nga banoret për furnizim me ujë hixhenik, dhe NJPSHZSH, kohë pas kohe ka bërë furnizimin me ujë për këto familje.

### 6.12.4.Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore)

Në komunën e Gllogocit, burimet e ujit janë të ndara në dy kategori kryesore: Ujëra nëntokësorë dhe ujëra sipërfaqësorë. Këto burime janë të rëndësishme për furnizimin me ujë të popullsisë dhe për bujqësinë, por ato përballen me sfida të ndryshme, përfshirë ndotjen dhe menaxhimin e pasigurt.

Komuna e Gllogocit ka të ndërtuar sistemin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit i cili është realizuar përmes investimeve nga donatorët e ndryshëm, nga komuna si dhe me kontribut të qytetarëve. Sistemi i ujësjellësit në komunën e Gllogocit menaxhohet nga njësia operative e kompanisë regjionale për ujë dhe kanalizim KRU "Prishtina". Vendbanimet me ujësjellës janë gjithsej 15 dhe ato janë: Gllogoc, Shtrubullovë, Gllobar, Tërstenik I, Çikatovë e Vjetër, Poklek, Korroticë e Ulët, Korroticë e Epërme , Komoran, Krajkovë, Çikatovë e Re, Zabel i Epërm, Shtuticë, Verboc dhe Zabel i Ulët. Pjeserisht kanë ujësjellës 3 vendbanime: Gllanasellë, Dobroshec dhe Llapushnik. Si dhe plotësishtë pa ujësjellës janë 16 vendbanime: Abri e Epërme, Arllat, Baicë, Domanek, Fushticë e Ulët, Godanc, Gradicë, Kishnarekë, Likoshan, Negroc, Nekoc, Polluzhë, Sankoc, Tërdec, Vasilevë dhe Vuçak. Për nga numri i banorëve ne këto vendbanime, rezulton qe rrjeti i ujësjellës shpërndahet dhe i shërben 29,480 banorë (apo 61.31%), pjesërisht kane qasje 6,481 banore (apo 13.47%), ndërsa pa furnizim me ujësjellës janë 12,118 banore (apo 25.20%). Furnizimi me ujë bëhet nga fabrika për punimin e ujit e cila gjendet në fshatin Çikatova e Vjetër që është e dizajnuar dhe ndërtuar për të furnizuar me ujë industrial dhe me ujë për pije kompleksin industrial të Feronikelit. Për shkak të mungesës së ujit për pije në këtë rajon, është dashur që nga kjo fabrikë si i vetmi burim i

furnizimit me ujë të pijes të furnizohet qyteti i Gllogocit dhe disa fshatra përreth. Për furnizim me ujë të fabrikës shfrytëzohet uji nga liqeni artificial i Ujmanit i cili gjindet në pjesën veriore të Kosovës.

**Në vitin 2023, 2024 dhe në vitin 2025, janë kryer punime në shtrirjen e rrjetiti të ujësjellësit edhe për 19 fshatra, dhe është ndërtuar edhe objekti komplet me kaptazhen e ujit në Qikatovë të vjeter dhe janë vendosur dy pompa të ujit , të cilat do të furnizojn dy rezervuar të ujit që janë të ndërtuar në Gllobar( tek pishat)me kapacitet deri në 1500m$^3$ dhe nga aty do të shpërndahet uji nëpër këto fshatra, andaj ky projekt do të finalizohet komplet deri vitin 2026.**
Uji transportohet me anë të një sistem të gjerë të infrastrukturës ujore:
Komuna e Gllogocit ka të ndërtuar edhe kanalin e hapur i Sistemit të Iber Lepencit me gjatësi prej 35 km (Ujman-Bivolak) – i cili bënë furnizimin e bazeneve për ujë të pijës që janë të vendosur afer fabrikës se feronikelit.

Po ashtu Komuna e Gllogocit ka disa burime të ujërave sipërfaqësorë, përfshirë lumenj dhe liqene. Një nga liqenet më të njohura është Liqeni i Vasilevës, i cili ndodhet në kufi me Komunën e Fushë kosovës. Po ashtu Komunë e Gllogocit e përshkton edhe lumi Drenica dhe Vërbica, me gjatësi rrethë 35 km. Ku ujrat e këtyre lumenjeve derdhen në Pellgun e lumit Ibër.

### Masat parandaluese

Si komision për hartimin e PVRR, kemi rekomanduar disa masa për thatësira:

- Kryerja e studimeve të detajuara hidrogjeologjike për të vlerësuar rezervat e ujërave nëntokësorë;
- Zgjerimi dhe shtirja e rrjetit të ujësjellësit në ato vendbanime që ende nuk kanë rrjet;
- Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të parandaluar ndotjen e burimeve;
- Zhvillimi i politikave dhe strategjive për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, duke përfshirë përdorimin efikas dhe ruajtjen e cilësisë së ujit.
- Shtrirja dhe zgjerimi i sistemit të ujitës Iber-Lepencë, edhe në disa zona/fshatra/ të komunës se Gllogocit.

*Figure 29 Harta e rreziqeve nga thatësirat*




### Skenari

Pasi që pasojat nga thatësirat nuk janë shumë të theksuara, atëherë edhe **Gjasat** janë të **mundëshme 1 herë në 10 vjet**, atëherë edhe nuk është e nevojshme hartimi i skenarit të lidhur me thatësirat.

## 6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË

### 6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale;

Po në tërsi jo vetem komuna e Gllogocit, por edhe i terë teritori i Kosovës kanë qenë të përfshira nga virusi COVID-19, SARS I dhe SARS II, e cila u shpall nga OBSH, si Pandemi.

Përpos pandemisë në komunë tonë janë preznet edhe Epidemit, si gripi sezonal, infeksionet e ndryshme, por janë të menaxhueshme nga institucionet shëndetësore të nivelit parësor,

### 6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;

Nga Pandemia e COVID-19, kanë qenë të rrezikuara të gjitha vendbanimet e komunës se Gllogocit, ndërsa nga Epidemit sezonale gjithashtu janë të prekura po thuaj se të gjitha venbanimet.

Nga Pandemia në komunë e Gllogocit janë prekur gjithësej 3420 raste, prej tyre janë shëruar 3334 raste.

`

### 6.13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë;

Shkaktari i Pandemisë ka qenë virusi COVID-19, SARS I , SARS II, ndërsa shkaktari i Epidiemisë , janë viruset sezonal.

### 6.13.4. Sëmundjet ngjitëse;

Ka pasur edhe Sëmundje ngjitëse, ky konsiderohet virus sezonal, që më të shprehur kanë qenë të diagnostifukuar me diagnozen **Diahorea et gastrenterisits** (A09), me gjithësejt **2393** raste**, sëmundje infektive**(A02-04-05-07-09), 291 raste, pastaj **variola herpes zoster** (B01-02), me **253** raste, dhe semundje të tjera, gjatë viti 2023, ndërsa gjatë vitit 2024 janë regjistruar ky numet i këtyre sëmundjeve, me diagnozen **Diahorea et gastrenterisits** (A09), me gjithësejt 262 raste**, sëmundje infective** (A02-04-05-07-09), 10 raste, pastaj **variola herpes zoster** (B01-02),me 34 raste.

Nga këto statistika të marrura nga raporti i QKMF-së, po shihet se rastet me Epidemi në vitin 2024 kanë rënë ndiheshem, krahasuar me vitin 2023.

### 6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ;

Pasojat nga Pandima kanë qenë shumnë të rnda ku ka pasur raste me mortalitet në **89 raste**, ndërsa na Epidemitë, kemi vetëm raste që janë paraqitur tek mjeku pa pasoja në mortalitet.

### 6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë/vlerësimet e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente;

### 6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese;

Bartës kryesor dhe përgjegjes për nivelin parësor është Drejtorati për Shendësi dhe Mirëqenje Sociale, që është në kuadër të Komunës, si dhe Qendra kryesore e Mjekësis Familjare, QKM-të, dhe AMF-të.

Për Pandemi kanë qenë të caktuara masat parandaluese nga Instituti Kombëtar i Shendëtësis Publike të Kosovës, të cilat masa janë zbatur edhe nga nivelet lokale, dhe po i përmendim disa prej tyre:

- Fushata të Informimit rreth simptomave të virusit dhe mënyrat e mbrojtjes,
- Qëndrimi në shtëpi në rast të simptomave,
- Vaksionimi,
- Kufizimet e tubimeve publike,( mbajtja e distancës, vendosja e maskave, larja e duarve etj)
- Mbyllja graduale e Institicionve shkollore,
- Rritja e kapaciteteve spitalore të QKMF-ve, QKM-vem AMF-ve,
- Testimet për diganostifikim të virusit.

**Masat parandaluese nga Epidemitë, janë veprime dhe strategji që ndërmirren për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive në komunën e Gllogocit.**

- Masa Hixheno-sanitare,
- Izolimi dhe karantinimi i rasteve të gripit sezonal,
- Vaksionimi kundër gripit sezonal,
- Kontrolli i burimeve të infeksionit (kontrolli i insekteve që transmetojn sëmundje, si mushkonjat

për Malarien)

- Sigurimi i ujit të pastërt,
- Përgaditja dhe reagimi i Institucioneve ( sigurimi i furnizimeve mjeksore, ilaqe, pajisje të tjera mjeksore).

## Skenari 1 – Epidemitë dhe Pandemitë

| Emri i skenarit: | **Epidemitë dhe Pandemitë** |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| **X Shumë e mundëshme** (gjasat 100% në vitin e ardhshëm ); **për Epidemit**, ndërsa për Pandemit mund të ndodhin 1 herë në 20 vjet<br>☐ E mundëshme ( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X E kufizuar( 10 deri 25%)**<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| **X- Skenari 1;** ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ - I vogël ; **x I mesëm ;** ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: **2021-2024** | |

### KONTEKSTI

| Nr. rend. | **Parametrat:** | Përmbajtja: |
|---|---|---|
| 1. | **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Lokacionet e paraqitjes **të Endemive dhe Pandemisë**, kanë përfshir të gjithë teritorin e komunës se Gllogocit, e sidomos Pandemia e Sarsë COVID-19, e cila ka shkaktuar vdekje të përsonave, dhe ka lënë pasoja në shëndet.<br>Po ashtu ekzistojn edhe rastet e paraqitjeve të Endemive dhe Epidemive , ku sipas shënimeve të QKMF, këto raste paraqiten po thuajse çdo stinë të vitit, por pa pasoja në mortalitet. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. | **Kushtet meteorologjike** | Kushtet metorolgjike që mbretrojn në teritorin e komunës se Gllogocit, janë kushte me temperatura të ulta gjatë dimrit dhe temperatura të larta gjatë veres dhe fillimit të vjeshtës |
| | **Periudha e vitit:** | Gjatë gjithë vitit |
| | **Lloji i ditës:** | Ditë pune |
| 3. | **Analiza meteorologjike për kohën** | Ka ndyshime të kilimës dhe motit gjatë të gjitha sitnëve, analizat e sakta i bënë IHMK, |
| 4. | **Popullata** | Komuna e Gllogocit , si të gjitha komunat e tjera, ka qenë e përfshirë nga Pendemia prej virusit **SARS COVID-19**, e cila ka shkaktuar pasoja si në shendetin e populates dhe ekonomisë, ku me këtë rast (të pandemisë) ka pasur edhe raste të vdekshmërisë, ku po i paraqesim në formë tabelare: |

| | | |
|---|---|---|
| **Situata Epidemiologjike në Komunën e Gllogoc-it lidhur me Pandeminë COVID-19,** | | |
| **Nga Marsi 2020, deri në Shtator /2021** | | |
| **Gjithësej raste: Test Pozitiv SARS-COV-2** | **3423** | **100.00%** |
| **Gjithësej raste: Aktiv SARS-COV-2** | **32** | **0.93%** |
| **Gjithësej raste: Të Shëruar** | **3302** | **96.47%** |
| **&EX& Mortalitet** | **89** | **2.60%** |

*Grafiku i rasteve të përsonave të infektur, rasteve aktive, rasteve të shëruara dhe rastet e vdekshmerisë*



**Epidemiologjia me Test Pozitiv në SARS-CoV2 sipas grup moshave 2020-2021 Gllogoc**

| Deri 20 vjeç | | 21 deri 40 vjeç | | 41 deri 60 vjeç | | 61 deri 80 vjeç | | mbi 80 vjeç | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 138 | 116 | 674 | 667 | 600 | 558 | 288 | 308 | 48 | 26 |
| **254** | | **1341** | | **1158** | | **596** | | **74** | |
| **Gjithësej: 3423** | | | | | | | | | |

***Grafika e rasteve Test Pozitiv me SARS-CoV2 sipas grup moshave 2020-2021 Gllogoc***




Ndërsa rastet nga Epidemitë gjatë vitit 2023 dhe 2024, kanë qenë prezente edhe në komunën e Gllogocit:

Gjatë vitit 2023, në bazë të të dhënave/raporteve/ nga QKMF[6], duke filluar nga Diagnozat A00- T95, ku hynë smundjet Infektive, ngjitese, tumorale dhe të tjera të përcaktuara në udhëzimet përkatëse, kemi pasur **73,010 raste prej tyre 39,908 Femra dhe 33,102 Meshkuj;**

Gjatë vitit 2024, në bazë të të dhënave/raporteve/ nga QKMF[7], duke filluar nga Diagnozat A00- T95, ku hyn smundjet Infektive, ngjitese,tumorale dhe të tjera të përcaktuara në udhëzimet përkatëse, kemi **pasur 68,244 raste prej tyre 40,713 Femra dhe 27,531 Meshkuj;**

| | | |
|---|---|---|
| 5. | Infrastruktura kritike egzistuese | Nuk ka pasur rrezikim të infrastrukturs kritike, përpos që ka pasur levizje të kufizuara të popullatës dhe automjeteve, sepse janë nxjerrur urdhëresat nga MSHMS dhe IKSHP, lidhur me menaxhimin e Pandemisë |

[6] Të dhënat janë marrë nga raporte të QKMF-së në Drenas
[7] Të dhënat janë marrë nga raporte të QKMF-së në Drenas

| | | |
|---|---|---|
| 6. | **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | Gatishmëria e Institucioneve shëndetësore ka qenë në nivelin me të lartë të mundëshem, ku është punuar 24/7 h, pa ndërprerje të ekipeve mjeksore, ku për të rritur efikasitetin e hapsirave për kontrolla mjeksore, Komuna e Gllogocit ka dhënë në shfrytëzim edhe Objektin i cili është dedikuar për integrimin e grave të dalura nga lufta.<br>QKMF-ja në Gllogoc dhe QMF-ja në Komoran kanë qenë në gjendje gatishmërie 24/7, me krejt ekipet e nevojsme dhe me vullnetar që ju janë bashkangjitur këtyre ekipeve.<br>Masat parandaluese janë ndërrmar konform protokolit të lëshuar nga MSHMS, përkatësisht IKSHP-së në kudër të Qeverisë.<br>Po ashtu është ndarë buxhet nga komuna për menaxhimin me të suksesshem të kësaj Pandemie duke bërë furnizim me ushqime, në këtë aksion janë bashkuar edhe bizneset për dhenjën e ndihmave ushqimore për kategoritë në asistencë sociale, duke mos përjashtuar edhe raste të tjera të të prekurve me virusin COVID-SARAS-I dhe II. |
| 7. | **Info plotësuese** | Si informata plotësuese kemi raportet QKMF, si për rastin e Pandemis COVID-SARAS-I dhe II (2020-2021) dhe Epidemive gjatë viteve 2023 dhe 2024, ku edhe janë marrë këto të dhëna, qe i kemi paraqitur me lartë. |
| | **INCIDENTI-NGJARJA** | |
| 8. | **Shkaku dhe shkaktari** | Shkaku i kryesor i paraqitjes se Pandemisë, ka qenë virusi i COVID-it SARS I dhe SARS II, ku ka përfshirë të gjitha shtetet e Botës, ku për këtë qëllim OBSH (Organizata botërore e Shëndetësisë), ka shapllur këtë gjendje si PANDEMI për shkak të ashpersisë ku ka rezultuar me një numer të madhë të të vdekurve, dhe ka kërkuar që të ndërrmiren të gjitha masat parandaluese për sëcilin shtet.<br><br>Për parandalimin e kësaj Pandemie, është zbuluar Vaksina AntiCovid. Më të cilen janë vaksionuar miljona njerzë, po ashtu edhe në Republikën e Kosovës, e cila ka izoluar këtë virus dhe ka parandaluar vdekjet e mëtejme të njerëzve.<br><br>Komuna e Gllogocit, si edhe çdo komunë tjeter ballafaqohet edhe me EPIDEMITË e natyrave të ndryshme, ku si shkaktatar të saj janë llojet e ndryshme të viruseve sezonal, ku janë menaxhuar me sukses dhe janë duke u menaxhuar sipas protokoleve mjeksore. |
| 9. | **Ngjarja kryesore** | Ngjarja kryesore ishte Pandemia me virusin COVID -19-SARS- I dhe II, gjatë vitit 2020-2021 e cila pos pasojave në jetën dhe shendetin e njerëzve ka lënë pasoja edhe në mentalitetin e njerzëve, për shkak të ashpërsis se tij. Si rezulatat i këtij virusi ka pasur edhe raste të mortalitetit ku në komunën e Gllogocit kemi pasur 89 raste. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Por në muajin Prill/2021, u zbulua edhe vaksina Anticovid, ku nga ky muaj deri në fund të muaji dhjetor, u vaksionuan me vaksina rreth **52584**, përsona (***shenime të marrura nga raporti i QKMF***).<br>Nuk kanë munguar edhe Epidemitë, siç janë gripet sezonale, sëmundjet infektive dhe sëmundje të tjera, ku sipas shenimeve të marrura nga QKMF-ja, gjatë vitit 2023 janë prekur rreth **73,010** përsona ndërsa në 2024 , janë prekur **68,244. Të gjitha këto raste të epidemisë janë pa pasoja në mortalitet.** |
| 10. | **Pasojat primare dhe efektet anësore** | Po pasojat primare nga Pandemia e COVID-19, SARS –I dhe SARS-II, kanë qenë humbja e jetëve të njërëzve dhe pasoja anësore në shendetit e njerëzve.<br>Pasoja ka pasur edhe nga Epidemitë gjatë viteve 2023—2024, të cilat po ashtu kanë lënë pasoja anësore tek popullata, por Epidemitë janë të menaxhushme, fal përkushtimit të Drejtorisë për SHMS dhe stafit të QKMF-së |
| 11. | **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | Po ashtu Pandemia ka shkatuar edhe pasoja sekondare, ku ka mbretruar një izolim i plot i levizjës se lirë të popullatës dhe e cila ka lënë pasoja në psikologjin e tyre, ndërsa EPIDEMITË, kanë lenë si pasoja sekondare, shpenzimet financiare dhe ato psikologjike. |
| | | **NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES** |
| 12 | **Rastet me fatalitet** | **Po, si rezultat i PANDEMISË -** ka pasur me raste me fatalitet dhe gjatë përiudhës se zgjatjës se Pandemisë **janë 89** raste që kanë përfunduar me Mortalitet. |
| 13 | **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | Nga COVID-19 SARS I DHE SARS II, kanë qenë të infektuar me këtë virus **3423** përsona, prej tyre të shëruar **3302** përsona dhe 32 raste me virus aktiv, ku të gjithë kan qenë të rrezikuar, por fal trajtimit mjeksor janë shpëtuar.<br>Poshtu edhe si pasoj e Epidemive sezonale ka pasur shumë raste që janë paraqitur tek mjeku për shkak të gripeve sezonale dhe infesioneve të ndryshme. |
| 14 | **Mungesë e nevojave elementare** | Sidomos si pasojë e virusit COVID-19, u paraqit mungesë e Miellit dhe gjërave të tjera elementare, për shkak të kufizimeve në levizje të lirë të tregut të hapur, dhe si pasoja e panikut të krijuar tek popullata.<br>Ishte krijuar një situate e rënd sidomos në muajt e parë të paraqitjës, në të gjitha aspektet e jetës. |
| 15 | **Të evakuuarit** | Si rezultat i COVID-it,në përgjithësi në terë teritorin e kosovës, kishte edhe të evakuuar, sidomos përsonat që vinin nga diaspora, ku ka pasuar edhe banorë nga komuna e Gllogocit, ata janë evakuuar ne Qendren e studentve, për disa muaj. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Po marrë në përgjithësi në një form e gjitha polullata ishin të evakuuar në shtëpit e tyre për shkak të masave të lansuara nga MSHMS-IKSHPK, lidhur me rastin e Pandemisë COVID-19. |
| 16 | **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | Pandemia , ka pasur edhe pasoja në ekonomi, për shkak të kufizimit të levizjes se lirë të mallrave në treg. |
| 17 | **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | Nuk ka pasur ndonjë ndikim në mjedis dhe në natyrë. |
| 18 | **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | Ka pasur ndërpreje sporadike të furnizimeve me ushqime bazike, sidomos në muajt e paraqitjes se COVID-it, mirëpo më vonë u tejkaluan. |
| 19 | **Humbje në trashëgimi kulturore** | JO |
| 20 | **Implikime politike** | Ka  pasur pakënaqësi nga komuniteti, për shkak të kufizimeve në levizje të lirë, por jo të përmasave për tu theksuar |
| 21 | **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i nivelit Kritik (Pandemia) |
| **PROBABILITETI-GJASAT** | | |
| 22 | **Probabiliteti** | Ngjarja COVID-it e përshkruar në aspektin shendetësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit kritik, duke marrë për bazë të dhënat vlerësuese preliminare |
| 23 | **Paralajmërimi i hershëm** | Po pas paraqitjës se virusit COVID-19, ka pasur paralajmrime nga Instituti kombëtar i shëndetësisë Publike, lidhur me masat që duhet të ndërrmirren në këtë rast dhe këto masa duhet respektuar strikt. |
| 24 | **Masat parand. gjatë periudhës së paralajm. të hershëm** | Si masa parandaluese ka qenë në mënyrë obligative vendosja e maskës, mbajtja e distancës në mes të njerëzve rreth 2 metra, vaksionimi i detyruar dhe masa të tjera detyruese, me qëllim të parandalimit të përhapjës së këtij virusi vdekjeprurës. |
| 25 | **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | Gati dy vite (2020-2021) |
| 26 | **Koordinimi** | Koordinimi për tejkalimin e kësaj Pandemie, ka qenë më të gjitha strukturat e sigurisë dhe ministrit e tjera relevante (shendetësis, ekonomisë, tregtisë dhe industrisë).<br>Janë aktivizuar të gjitha Shtabet emergjente lokale, dhe të njëjtat janë koordinuar me Shtabin Emergjent komunal, dhe janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për tejkalimit e kësaj Pandemie. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Shtabi Komunal ka qënë i koordinuar me Qendren e situatave në nivel nacional ku kanë raportuar në kohë reale dhe ditore për gjendjen në teren) |

**Probabiliteti/Gjasat:**

Sipas kritereve në tabelë, PANDEMIA e COVID-19-SARS I dhe SARS II, në vitin 2020 dhe 2021 mund të klasifikohet si fatkeqësi mesatare. PANDEMIA ka ndodhur nga fillimi i muajit, me një periudhë kthimi nga viti 2021, prej T =2 vjet, pra probabiliteti i ndodhjes **p=6- 50%.**

***Treguesit e probabilitetit***

***Probabiliteti / frekuenca***

| *Kategorizimi* | *Cilësia* | *Probabiliteti/gjasat* | *Frekuenca* | *Përcaktimi* |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | **Mesatare/ E mundur** | **6-50 %** | **1 ngjarje në 2 deri 20 vjet** | |
| 4 | E madhe / Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga QKMF-ja, gjatë PANDEMISË **ka viktima,** dhe shumë të infektuar dhe mund të lasifikohet si rrezik **të nivelit mesatar**

-Ndërsa nga Epidemitë ka pasur shum të prekur nga virusët sezonal por me pasoja të vogla të mortalitetit.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| **Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut** | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | ✓ |

`

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Kritike | 501-1500 |
| 5 | Katastrofike | > 500 |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi** : përcaktohen në raport me bruto-produktin e brendshëm në Republikën e Kosovës, për zonën e prekur.

-Ka pasur edhe pasoja në nivel vendi edhe nga aspekti ekonomik për shak të embargos se krijuar nga Virusi COVID-19/

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | ✓ |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social, dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:**

| ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike*** | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | ✓ |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm i objekteve me rëndësi të veqantë:***

| ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë:*** | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| 1 | Të papërfillshme | < 0.5 % GDP | ✓ |
| 2 | Të vogla | 0.5 -1 % GDP | |
| 3 | Mesatare | 1 – 3 % GDP | |
| 4 | Kritike | 3 – 5 % GDP | |
| 5 | Katastrofike | > 5 % GDP | |

**Matrica 1:** *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica 2:** *Rreziku për pasojat në ekonomi*




**Matrica 3a**: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*

**Matrica 3b**: Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale  në infrastrukturën kritike:

**Matrica përmbledhëse**: ***3a dhe 3b,*** *pasqyron rrezikun  rrezikun për stabilitet shoqëror:*




**Matirca 4:** *Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm:*



# 7. FATKEQËSITË TJERA

## 7.1. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;

Komuna e Gllogocit sa i përketë cenueshmerisë se trafikut rrugor dhe atij hekurudhor, atakohet me një numer të konsiderushem të aksidenteve në teritorin e komunës se Gllogocit, konkretishtë në rrugën Rajonale Prishtinë-Pejë, rrugën magjistrale Komoran –Gllogoc, ndërsa sa i përket aksidenteve në vendkalimet e hekurudheve me rruget magjistrale dhe ato lokale , kemi aksidente, të cilat janë të evidentuara nga ana e raportit të marrur nga policia e Kosovës , njësia në Gllogoc.

*Table 62 Numri i aksidenteve në vendkalimet e hekurudhave*

| **Aksidente fatale** | | | **Persona të vdekur** | | | **Aksidente me lëndime** | | | **Persona të lënduar** | | | **Aksidente me dëme materiale** | | | **Gjithësej:** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % |
| 6 | 6 | 0 | 8 | 6 | **-25.0** | 223 | 279 | **25.1** | 522 | 576 | **10.35** | 262 | 308 | **17.56** | 491 | 593 | **20.7** |

Nga kjo tabelë shihet se gjatë vitit 2022 dhe 2023 kemi pasur 6 aksidente me fatalitet dhe rastet kanë qënë të njejta në të dy vitet, dmth skemi pasur zvoglim të rasteve, ndërsa numri i përsonave të vdekur në vitin 2023 është me i vogël për 25%. Numri i aksidenteve me lendime në vitin 2022 jan evidentuar 223 raste, ndërsa në vitin 2023 janë evidentuara 279 raste, më një rritje prej 25.11%. Në krahasim më numrin e të lenduarve kemi një rritje të lënduarve për 10.35% në krahasim me vitin 2022 dhe 2023. Aksidente me dëme matariale, duke krahasuar vitin 2022 dhe 2023, kemi një rritje prej 17.56%.

Po ashtu në bazë të shenimeve të marrura nga intervenimet NJPSHZHS, për vitin 2024 NJPSHZHS ka intervenuar ne 53 raste aksidente ne komunikacion, ku si pasoj kishte nëntë të lenduar dhe një i vdekur, ndersa deri në muajn korrik për vitin 2025 janë 3 raste.

Ndërsa nuk është në kompetencë të komunave për të evidëntuar aksidentët ajrore, andaj nuk kemi shënime.

Nga tabela po vërehet se në komunen e Gllogocit në disa vendbanime po ndodhin aksidente të shpeshta dhe me fatalitet, siç është rruga rajonale Prishtinë-Pejë, konkretisht, në Arllat dhe Llapushnik, si dhe rruga magjistrale Komoran-Gllogoc, në Zabel të Ultë, ndërsa më të rralla janë aksidentet në vendkalimet e rrugëve me hekurudha, sepse të gjitha këto vendkalime janë të pajisura me shenjëzim vertikal, ndërsa në tri pikë kalime prej gjithësejt 14 kalimeve, janë të vendosuara edhe laurat nga ana e Infrakosit.

`

**Masat parandaluese;**

Si masa parandaluese, komisioni ka propozuar 4 masa kryesore :

1. **Masa Edukative dhe Ndërgjegjësuese, ku hynë:**

- Fushata vetëdijesuese publike për sigurinë në trafik përmes mediave sociale në shkolla dhe institucione tjera;
- Edukimi i femijëve dhe nxënësve për rregullat bazë të trafikut që në moshat e hershme;
- Trajnimet e rregullta nga Ministria përkatëse për shoferët profesionist dhe ata amator për rregullat e reja të qarkullimit.

2. **Masat për drejtuesit e automjeteve;**

- Respektimi i kufijeve të shpejtësisë sidomos, në zonat urbane, afër shkollave dhe në kthesa të rrezikshme;
- Ndalimi i drejtimit të automjeteve nga ana e policisë për ngasesit e automjeteve të cilët janë nën ndikimin e alkoolit dhe substancave tjera narkotike;
- Përdorimi i obligushëm i rripit të sigurisë për çdo shofer dhe udhtarë;
- Mos përdorimi i telefonit celular gjatë vozitjës, përveq nëse përdoret me paisje adekuate;
- Kontrollimi teknik i rregullt i automjetit, goma, drita, frena etj.

3. **Masat infrastrukturore;**

- Vendosja e sinjalistikës adekuate rrugore( sinjalizimi vertikak dhe horizontal) ,me shenja të qarta dhe në vende të duhura.
- Vendosja e ndriqimit publik në ato rrugë dhe kamerave të sigurisë;
- Ndërtimi i mbikalimeve dhe nënkalimeve për këmbësor në zonat më frekuencë të lartë të levizjës;
- Mirëmbajtja e rregullt e rrugëve gjatë dimrit dhe renovimi i gropave në rrugët e asfaltuara ose eliminimi i pengesave që mund të shkaktojnë aksidente;

4. **Masat ligjore dhe Zbatimi i ligjit;**

- Zbatimi i rrept i ligjeve të trafikut, me ndëshkime të drejta dhe të shpejta për shkelësit;
- Patrollime të rregullta të policis së Trafikut, sidomos gjatë natës dhe fundjavëve;
- Testime të rastësishme të ngasësve të automjeteve që përdorën alkool dhe substanca tjera;
- Përdorimi i radarve mobil dhe i veturave mobile për të monitoruar shpejtësinë e automjeteve.

Mos respektimi i këtyre masave parandaluese do të paraqet rrezik përmanent për aksidente me fatalitet dhe të lënduar, andaj edhe i kemi përfshirë në këtë plan të rrezikut.

*Figure 30 Harta e Rrugëve në Komunën e Gllogovcit*




## 7.2.VLERËSIMI PËR PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE

Në komunën e Gllogocit ekzistojnë objekte të infrastrukturës kritike duke përfshirë objektet administrative komunale (Shkollore, Shendëtsore, Kulturore), Objektet e sigurisë (Stacioni i Policisë, Gjykata, Zjarrfikësve), Objektet e telekomunikacionit dhe Energjisë (Posta, Qendra e shpërndarjës së Enërgjisë në Gllogoc dhe Gllanasellë), Largpërçuesit me kapacitet (**400kv, 220kv, 110kv, 35kv, dhe 10kv**), Objektet Bankare, Objektet e Qendrave tregtare në Gllogoc, objektet me rendësi në Parkun e Biznesit, Fabrika e Feronikelit, Objektet e furnizimit më ujë, Mullinjët, Stadioni (Bejt Regjepi), Stacioni i Autobusve, Stacioni i Trenit, Urat, Rrugët dhe Tunelet.

Të gjitha këto Objekte që janë në komunën tonë duhet kushtuar një rëndësi të veçant të vlerësimit të rrezikut sepse nëse ndodhin fatëkeqësitë natyrore dhe fatëkeqësit tjera, mund të jënë të rrezikuara dhe më pasoja në njerzë dhe dëme materiale.

`

## Masat parandaluse në infrastrukturën kritike;

Masat parandaluse në komunën e Gllogocit janë thelbësore për të siguruar funksionimin normal të shërbimeve bazike edhe gjatë krizave dhe fatëkeqsive natyrore dhe fatëkeqsive tjera, apo kercimeve të mundëshme terroriste.

Këto masa fokusohen në mbrojtjen e aseteve të objekteve të rëndësisë së veçant që janë cekur më lart në teritorin e komunës së Gllogocit.

## Masat parandaluese në infrastrukturën kritike në Komunën e Gllogocit përfshinë 5 masa të rëndësishme:

1. **Vlerësimi dhe identifikimi i gjithë infrastrukturës kritike.**
   - Hartimi i listës së infrastruturës kritike qe kemi cekur më lart;
   - Vlerësimi i rrezikut për sëcilin aset;
2. **Fuqëzimi i sigurisë fizike dhe digjitale:**
   - Vendosja e kamerave të sigurisë në objektet kritike;
   - Vendosja e sistemit të alarmimit dhe koordinimit dhe kontrolli i qasjes në qendrat e menaxhimit të ujit dhe energjisë etj;
   - Sigurimi i objekteve të cilet posedojnë të dhëna të infrastrukturës digjitale nga sulmet kibernetike përmes softverve adekuat dhe trajnimeve të ekspertve të IT.
3. **Mirëmbajtja e rregullt dhe investimeve moderne në objektet e rendësise së veqantë:**
   - Inspektimet e rregullta dhe periodike të infrastrukturës kritike (Sistemi i Ujësjellësit, Sistemi i rrjetit Elektroenergjetikë, Sistemi i rrjetit të rrugëve etj.);
   - Zëvëndësimi i pajisjeve të vjetëruara me ato të reja për tu shmangur defekteve teknike;
4. **Bashkpunimi me institucione tjera ;**
   - Koordinimi efikas me të gjitha strukturat e sigurisë që përfshinë Agjencinë për Menagjimin Emergjent( AME), Policinë e Kosovës, FSK-në, AKI-në,
   - Koordinimi me Operatoret publik dhe privat ( ***KEDS, KRU "Prishtina", KRM "Pastrimi", Operatoret Mobil, Vala dhe Ipko***),
   - Organizimi i Ushtrimeve për mbrojtje civile dhe Emergjenca nga NJPSHZSH dhe strukturave të tjera të sigurisë.
5. **Përdorimi i teknologjisë për montitorim dhe parandalim:**
   - Instalimi i kamerave në objektet e veqanta të sigurisë;
   - Vendosja e sënsorve në lartëpërqquesit elektrik të cilët paralajmrojnë me kohë defektët në rrjetin elektrik;
   - Vendosja e platformës digjitale në institucionet e rëndësis së veqant për të mundësuar njoftime të shpeshta për qytetaret në rast të krizave dhe fatkeqësive natyrore dhe fatëkeqësive tjera.

## 7.3. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË /SMSHN

### 7.3.1. Kategorizimi i SMSHN-ve,

**Njësitë e SMSHN-ve janë themeluar sipas qëllimit si në vijim:**
**Njesitë për Intervenime të specializuara janë përgjegjësi e nivelit qendror, por që të dihet se cilat janë këto njësi dhe pergjegjësitë e tyre, që duhet të jenë në Plan të Vlerësimit të Rrezikut, ne po i listojmë si më poshtë:**

- **Njësitë për intervenime të specializuara** (janë themeluar nga niveli qendror), sepse komunat nuk kanë kapacitete për këto lloje të intervenimeve), por vetem po i permendim, që janë njësi të nevojshme për reagime,
- Njësitë e specializuara (për vërshime të mëdha, për tërmete, akte të terrorizmit), (kryhen nga niveli qendror);
- Njësitë për intervenime të përgjithshme (Intervenime në shuarje të zjarreve, Vërshime të intezitetit të ultë, aksidente rrugore, evakuim të popullatës, hapje të rrugëve nga rrenojat), kryhen nga Njësit Profesionale të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të komunës se Gllogocit dhe Kompanit që i ka të kontraktuara Komuna për intervenime emergjente)
- Njësia e reagimit për emergjenca në kuadër të QKMF-së (fron ndihmën e parë mjeksore në vendin e ngjarjës);
- Njësit e Policisë Lokale/Njësia e komunitetit (Ofron siguri dhe ndihmon evakuime dhe kontroll të rendit publik gjatë emergjencave);
- Komuna e Gllogocit ka të formuar edhe Shtabin/Komitetin për Mbrojtje dhe Shpetim, të cilen e kryeson Kryetari i komunës, dhe aktivizohet në rastet kur kemi Emergjenca të nivelit të mesem dhe të lartë dhe bënë koordinimin e të gjitha institucioneve lokale për menaxhimin e emergjencave.

**Në nivel lokal janë të organizuara edhe njësit shtesë siç janë:**

- Kryqi Kuq i Kosovës ( njësia në Gllogoc)- ofron ndihma humanitare dhe logjistike,
- Organizatat Jovertitare (OJQ dhe Vullnetaret në Gllogoc) - ndihmojn në logjistikë, shpërndarje ndihmash dhe përkrahje për komunitetin.

**Po ashtu ka edhe struktura të tjera në nivelin qendror ku koordinohen me nivelin lokal ku sipas kategorive të tyre ndahen në:**

- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga **rrënojat** - **KSHU**,( Njësit e nivelit lokal dhe Njësit e nivelit qendror)
- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga **ujërat**-( Njësit e nivelit lokal dhe Njësit e nivelit qendror);
- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga **lëndët kimike, biologjike,radiologjike dhe nukleare** – KBRN,( niveli qendror, sepse si komunë nuk kemi kapacitete dhe pajisje për inetervenime të këtij lloji);
- Njësia **për logjistikë**-( Kjo njësi mund të organizohet nga komuna në koordimim nivelin qendror).

Siq po shihet komunat në përgjithësi , kanë kapacitete të vogla të njësive të reagimeve emergjente

`

për rastet e përmasave të mëdha, kundrejt nevojave, sepse mungojn edhe resuret humane dhe ato buxhetore).

Shenim: Të gjitha këto njësi të lartëshenuara mund të aktivizohen vetëm nga niveli qendror me kërkesë të Komunës në rastet kur nuk mund të menaxhohen fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për shkak të rrezikshmerisë së lartë dhe mungesës së kapaciteteve.

## 8. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE

Bazuar në historikun e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komuna e Gllogocit iu është ekspozuar rreziqeve të nivelit të mesem dhe të ultë, ndërsa për FNFT me përmasave të mëdha nuk iu është ekspozuar, por kjo nuk nënkupton që në të ardhmen e afërt Komuna nuk do të përballet me fatkeqësi të natyrave të tilla, marrë për bazë ndryshimet klimatike në botë dhe zhvillimin e hovshëm tekniko-teknologjik, të cilat mund të jenë indikator të rreziqeve dhe kërcënimeve të shumëllojshme. Aktivitetet e përbashkëta dhe të koordinuara të institucioneve përgjegjëse në fushën e menaxhimit dhe reagimit në raste fatkeqësish, pastaj personave juridik dhe fizik, nga niveli Qendror deri te ai lokal, do të jenë garanci për sigurinë tonë kombëtare. Kapacitetet ekzistuese në komunën e Gllogocit ( resurset humane dhe teknike ) si forcë reaguese për Mbrojtje dhe Shpëtim ende nuk e kemi arritur nivelin e dëshirueshëm, prandaj kërkohet:

- ***Ngritje më e lartë profesionale me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të tyre reagues, përmes trajnimeve profesionale,***
- ***Rritjen e buxhetit për pajisjeve ( automjete për fikje të zjarrit, Qanta shpinore, Ajërfryësese Portative, pajisje të tjera të nevoshme për intervenime në vërshime, aksidente);***
- ***Rritjen e numrit të pjesëtarve/stafit/ të NJPSHZSH, sipas kritereve të parapara në ligjet dhe Rregulloret adekuate ( 1500 banorë/1 Zjarrfikës), që nuk është e aplikuar në asnjë Komunë të Kosovës;***
- ***Testimeve të nivelit të gatishmërisë me anë të ushtrimeve të ndryshme si dhe***
- ***Bashkëpunimit Ndërqeveritar dhe Ndërkomunal;***

  ***Ky dokument i Vlerësimit të Rreziqeve do të shërbejë si pikë referente për hartimin e Planit të Reagimit Emergjent Komunal (PREK), hartimin e PZHK, dhe Hartave Zonale , Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, në të ardhemn, etj.***

Me qëllim të integrimit të akterëve të ndryshëm në menaxhimin emergjent duhet realizuar një sërë prioritetesh dhe detyra si:

- ***Implementimi i Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe konsolidimi me resurse njerëzore, materiale dhe financiare, në mënyrë që të fuqizohen kapacitetet e duhura operative për reagim emergjent efikas;***
- ***Harmonizimi i ligjeve tona dhe arritja e kompatibilitetit në fushën e Menaxhimit Emergjent me ato BE -së, të strukturave për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë, në aspektin teknik, operativ dhe strategjik, në mënyrë që të jenë të gatshme të veprojnë në çdo lloj të Emergjencave;***
- ***Zbatimi i masave parandaluese në planifikimin hapësinor me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve, si dhe pasojave të rreziqeve nga fatkeqësitë;***

- ***Aplikimi i praktikave më të mira në masat për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës të njerëzve;***
- ***Ruajtjen e ambientit për gjeneratat e ardhshme;***
- ***Hartimi, zhvillimi dhe aplikimi i programeve aftësuese për koordinim dhe drejtim i të gjitha forcave operative për mbrojtje dhe shpëtim në nivel lokal.***

## 8.1. Vlerësimet përfundimtare;

Vlerësimet përfundimtare po i cekim shkurtimisht për secilën masë të mbrojtjes, duke bërë edhe përllogaritjen e kostos financiare ;

**1. Masat mbrojtëse nga vërshimet;**

Në kuadër të masave mbrojtëse nga vërshimet Komuna e Gllogocit ka ndërmarrë këto masa:

- Pastrimi i shtratit të lumit Drenica dhe Verbica ;
- Ndalimi i hudhjës së mbeturinave;
- Ndërtimi i Urave dhe Tumbinave;
- Planifikimi urban i kontrolluar dhe mos ndërtimit në zonat e rrezikuar nga përmbytjet;

**2. Masat mbrojtëse nga zjarrët fushore dhe malore ;**

- Fushatë vetdijesuese dhe informuese për banorët lokal, në shkolla, mbi rrezikun e zjarreve;
- Pastrimi i barishtave te thata dhe shkurreve ;
- Mos ndezja e zjarreve në hamullore gjatë verës
- Ndalimi i hedhjës së mbeturinave( Qelqit dhe materialeve tjera vezulluse) në male dhe kullosa;
- Instalimi i sistemeve të paralajmrimit dhe instalimi i hidrandve në ato fshatra/zona/ ku ekziston sistemi i rrjetit të ujsjellsit;
- Zbatimi i masave rigoroze për ata që bëjnë zjarrvenje të qëllimshme;

**3. Masat mbrojtëse në objektët industriale dhe prodhuese**

- Komunikimi me përfaqësuesit e bizneseve që merren me këtë veprimtari që ata të jenë vëdijshëm për pasojat e mundshme,në rastë të shpërdhimit të këtyre zjarrëve;
- Kontrollimi i aparateve për mbushje të derivateve;
- Përseritja e atesteve të matjeve të rezistencës të tokëzimit dhe rrufepritsit;
- Masat parandaluese për shuarje të zjarrve;
- Ngritjen e Njësisë se mbrendeshme të Zjarrfikësve nga vet pronaret e objekteve prodhuese siq parashihet me ligj, dhe trajnimi i tyre;
- Rimbushja dhe servisimi i aparateve për shuarjen e zjarrit qdo 6 muaj;
- Instalimi i hidranteve në Objektet e prodhuese;
- Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimit automatik;
- Atestimi i këtyre sistemeve.

**4. Masat mbrojtëse në pompat e derivateve të naftës;**

- Kontrollimi i aparateve për mbushje të derivateve;
- Përseritja e atesteve të matjeve të rezistencës të tokëzimit dhe rrufepritsit;
- Mirëmbajtja e pikës matëse të elektriciteti statik;
- Ngritjen e Njësisë se mbrendeshme të Zjarrfikësve nga vet pronaret e objekteve të derivateve të naftës siq parashihet me ligj, dhe trajnimi i tyre;
- Përsertij e atesteve të matjeve të valvulave siguruese të rezervuarve të Gasit;
- Pastrimi i rezervuarve të derivateve të naftës qdo 5 vite;
- Rimbushja dhe servisimi i aparateve për shuarjen e zjarrit qdo 6 muaj;
- Instalimi i hidranteve në Objektet e derivateve të naftës;
- Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimi automatik;

Të gjitha këto masa mbrojtëse që janë të planifikuara për sëcilin rrezik, për të cilet janë bërë edhe skenerat, kanë kosto financiare, te cilat do t'i paraqesim tëk paragrafi i kostove financare.

## 8.1.1. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent

Për vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent , trajnimin dhe aftësimin e tyre, përcaktimin e resurseve materiale të nevojshme, prioriteteve dhe drejtimeve të zhvillimit, si dhe definimin e procedurave standarde të operimit dhe monitorimit, janë bërë analiza të rreziqeve, për incidentet që kanë ndodhë, dhë në bazë të kësaj analize kemi bërë vlerësimet për strukturen dhe madhësin e forcave të reagimit emergjent, dhe të cilat janë të instaluara në komunën e Gllogocit po i listojm si me poshtë;

**Njësia Profesionale e Shërbimit të zjarrfkikësve dhe Shpëtimit**, është si forca kryesore e reagimit emergjent e cila është një formacion i përbër nga **16 zjarrfikës dhe komandati i njësis**, e përgaditur dhe e trajnuar në mënyrë profesionale në **Qendren e Trajnimit në Vushtrri**, dhe me një përvoj mesatare mbi 18 vite. Zjarrfikësit janë kalitur me lloj lloj intervenimesh të ndryshme, dhe janë një ndër njëstit me të përgadituara profesionlisht në Kosovë dhe e pajisur me pajisje dhe me një flotë të automjeteve si me poshtë:

*Table 5: Resurset materiale: pajimet dhe pajisjet zjarrfikëse*

| Resurset materiale: pajimet dhe pajisjet zjarrfikëse | **Automjete të NJPZSH-së** | **Nr .Sasia** | **Kapaciteti** |
|---|---|---|---|
| | Automjet Komandues | 1 | $3.4m^3$ |
| | Automjet Sulmues | 1 | 4560 lit. |
| | Automjet Furnizues (Auto Cisternë) | 0 | 0 |
| | Automjet Teknik | 2 | Paisje për shpetim |
| | Automjet me shkallë hidraulike | 0 | 0 |
| | Automjet fushor-malor | 1 | 800 lit. |
| | Automjet tjetër | 0 | 0 |
| | Gjenerator | 4 | 12,5,3kë |
| | Pompë uji | 3 | Ø 110,Ø75,Ø52 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Barkë për shpëtim në ujë | 0 | 0 |
| | Paisje për zhytje | 0 | 0 |

**Njësia e reagimit emergjent mjeksor, në kuadër të QKMF**-së, është një srukturë e përbër nga 1 mjek për reagime emergjente dhe dy infermier, dhe me një automjet të ndihmës se shpejt i pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme ( **Oksigjenoterapia komplet me pajisje, Defibrilator, Monitori i parametrave jetësor,Pajisje për imobilizm dhe transport, deska spinale, Jakë qafe, splinta, dhe medikamente te tjera për dhenjen e ndihmes se parë – serume , infuzione , termometer, pulsoksimeter, glykomete**r etj).

**Njësit e Policisë Lokale/Njësia e komunitetit**( Ofron siguri dhe ndihmon evakuime dhe kontroll të rendit publik gjatë emergjencave), ku stafi i tyre përcaktohet varësisht nga lloji, inteziteti i Incidentit dhe nevoja në teren.

**Kryqi Kuq i Kosovës** ( njësia në Gllogoc) ;

- **Kapacitetet Njerëzore**

Në kuadër të kapaciteteve për përballimin e fatkeqësive, Kryqi i Kuq i Kosovës – dega në Gllogoc, disponon burime njerëzore dhe kapacitete të trajnuara si më poshtë:

Stafi bazë përbëhet nga 2 persona:
• Sekretari i degës
• Koordinatori

- Kryesia e degës ka 7 anëtarë, dhe Komisioni Financiar përbëhet nga 3 persona
- **4 instruktorë të licencuar për Ndihmën e Parë.**
- **3 vullnetarë të trajnuar për Përkrahje Psikosociale**
- **2 vullnetarë të trajnuar për Reagim në Fatkeqësi dhe Menaxhim Kampi .**

Totali i vullnetarëve është rreth 30 persona, prej të cilëve 15 janë aktivë dhe të trajnuar në fusha të ndryshme si : Ndihmë te Parë, Përkrahje Psikosociale, Menagjim te Kampit, Reagim në Fatkeqësi, etj. Po ashtu trajnimet e vullnetarëve për reagim në fatkeqësi do të vazhdojnë edhe ne të ardhmen.

**Asetet Logjistike:**
- Veturë xhip Land Cruiser 4x4 me të cilin mund të bartën deri 12 persona.
- 3 qanta të ndihmës së parë të kompletuara me mjetet e nevojshme,
- 1 lese për bartjen e të lënduarve,
- 10 lopata,
- 1 kazmë,
- 3 grabuja,
- 2 laptopë,
- 1 tablet,

**Organizata Jovertitare** (OJQ dhe Vullnetaret në Gllogoc) - ndihmojn në logjistikë, shpërndarje ndihmash dhe përkrahje për komunitetin.

# 8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT;

## 8.2.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT;

Janë identifikuar dhe analizuar të gjitha llojet e rreziqeve që mund të ndodhin në komunë e Gllogocit dhe të gjitha janë trajtuar me kujdes në kapituj e PVRR-ut

## 8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike;

I kemi identifikuar të gjitha nevojat dhe resurest humane dhe teknike të Njësive të reagimit emergjent për të cilat nevojitet plotësimi me automjete dhe pajisje për reagim Emergjent;

Nevoja kryesore është blerja e **një automjeti për shuarje të zjarrit** për NJPSHZSH e cila kushton rrethë **180mi**j euro, **Automjet me shkallë levizëse-hidaulike në lartësi deri 20m-1 copë(150,000€)**, Ajrëfryerse portative- **5 copë(4,000 €**), Qanta shpinore **10 copë( 2,000 €),** Bark gome që nevojitët për intervenime në vërshime- **1 copë(10,000€), Rroba zjarrduruese për Zjarrfikës -17 palë(17,500€), Dyshekë për lëshime nga lartësia –1 copë(5,000€)** si dhe pajisje të tjera të nevojshme për intervenime( gypa, fiskaja, shkallë,- **10,000€** etj),

Po ashtu NJPSHZSH, ka nevojë për rritje të numrit të zjarrfikësve të pakten **edhe 12 Zjarrfikës, dhe Ndërtimin e një Nënstacioni në Komoran-( kostoja e ndërtimit -120,000€),**

Pra vlera totale e nevojshme për investime është**: 498,500.00€,**

Komuna e Gllogocit në planifikimet buxhetore për vitin 2026-2028, ka ndarë buxhet edhe për nevoja të tjera për realizimin e masave parandaluese të cekura ne kapitutllin 8.1.2, konkretishtë:

- Rregullimin e tombinave, për parandalimin e vërshimeve : **50,000 €** në vitin 2026 dhe **350,000€** në vitin 2027;
- Rregullimi dhe hapja e shtratit të lumit Drenica dhe Vërbica: **35,000€** në vitin 2026 dhe **30,000€** - 2027;
- Hapja e kanaleve kulluse pran rrugëve locale: **50,000€-**2026 dhe **60,000€** -2027;
- Rehabilitim e gropve në rruget e afaltuara( parandalimin dhe zvoglimin e aksidenteve rrugore): **30,000€-**2026 dhe **30,000€** -2027;
- Shenjëzimi horizontal dhe vertikal ( parandalimin dhe zvoglimin e aksidenteve rrugore): **40,000€-**2026 dhe **40,000€-**2027;
- Për Intervenime Emegjente : **10,000€-**2026 dhe **10,000€-**2027;
- Zgjerimi dhe instalimi i Ndrimit publik: **370,000**- 2026,( për rritjen e sigurisë);
- Zgjerimi i kamerave (për rritjen e sigurisë): **10,000€** -2026 dhe **10,000€-**2027.

## 8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional;

Njësia profesionale e Shërbimit të zjarrfikësve dhe Shpëtimit, ka nevoj për trajnime shtesë, sidomos për trajnime ***për reagime në lartësi( për automjetin me shkallë levizëse, trajnime për reagime në Vërshime, reagime në tërmete, kërkim shpetim ,*** etj)

### 8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre;

Duhet të zbatohen me përpikëmeri ligjet aktet nën ligjore ( Rregulloret dhe Udhëzimet) që kanë bëjn më Mbrojtjen e jetës se njërzëve dhe të mirave materiale dhe organizimin e Njësive të reagimit Emergjent: konkretishtë:

1. LIGJIN NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA;
2. LIGJIN NR. 08/L-261 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI,
3. LIGJIN NR. 04/L-049 PËR ZJARRËFIKJE DHE SHPËTIM,
4. RREGULLOREN NR. 25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË,
5. RREGULLORE Nr. 25/2012 PËR NORMAT TEKNIKE TË MBROJTJES NGA ZJARRI NË NDËRTIMIN E IMPIANTEVE PËR LËNGJET E NDEZSHME, DEPONIMIN DHE TOÇITJEN E TYRES,
6. RREGULLORE Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA,
7. RREGULLORE (QRK) - NR. 18/2015 PËR ORGANIZIMIN E NJËSIVE TË STRUKTURAVE PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË
8. STATUTIN E KOMUNËS SË GLLOGOCIT;

### 8.2.5.Hartimi i skenarit dhe ushtrimi;

Do të të hartohen tre skenar për Ushtrime në : Zjarre në objekte të Pompave të derivateve të naftës, Tërmete (intervenim për evakuim), Vërshime dhe aksidente në komunikacion rrugor.

## 9. Rekomandime

***<u>Në kuadër të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT për komunën e Gllogocit , grupi punues rekomandon, që:</u>***

1. ***<u>Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut të merret në konsideratë dhe për bazë gjatë hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi;</u>***
2. ***<u>Hartojë programin (edukimin, trajnimin dhe vetëdijësimin qytetar) si dhe masat parandaluese për tri vitet e ardhshme;</u>***
3. ***<u>Merret si bazë për analizimin e nevojave dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese;</u>***
4. ***<u>Të hartojë skenarët dhe ushtrimin e tyre me qëllim të testimit të kapaciteteve reaguese humane dhe teknike;</u>***
5. ***<u>Ndajë një fond për reagim emergjent bazuar në historikun e fatkeqësive për komunën e Gllogocit dhe vlerësimin e dëmeve dhe sanimin e pasojave.</u>***

## 10. Dispozitat përfundimtare

Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr. 25/2022 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit të rrezikut për komunën e Gllogocit të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike, dhe sipas nevojës mund edhe më herët dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha strukturat përgjegjëse dhe palet e intersuara në territorin e komunës se Gllogocit.

Zbatimi efektiv i planit kërkon bashkëpunim ndërinstitucional, sipas parimit të koordinimit vertikal dhe horizontal ndërmjet strukturave që veprojn në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.